

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА



FAKULTETI DREJTËSISË
FACULTY OF LAW
ЕВРОПА ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

STUDIME PASDIPLOMIKE –CIKLI I DYTË
DREJTIMI PENAL

TEZA:

“PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROÇESIN PENAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË- ANALIZË
KRAHASUESE”

KANDIDAT: Fatbardha Krashi

MENTORI: Prof.Dr. Ismail Zejneli

TETOVË, 2023

PËRMBAJTJE

KAPITULLI I PARË

1. Rëndësia e provave si insitut i të drejtes proçeduriale.....6
2. Kuptimi i provës, kushtet për vlefshmerinë e saj.....7

KAPITULLI I DYTË

Aspekti historik i zhvillimit të proçesit të të provuarit në proçesin penal(veshtrim krahasimor)

1. Trajtimi i zhvillimit të provave sipas kanunit të Leke Dukagjinit.....12
2. Periudha e pushtimit otoman.....14
3. Periudha e pavaresisë 1912-1953.....16
4. Mbretëria shqiptare.....16
5. Analizë krahasuese e kodit aktual të proçedurës penale të Republikës së Shqipërisë me kodin e vitit 1953.....16

KAPITULLI I TRETË

Llojet e provave të percaktuara në mënyrë eksplicite nga kodi ynë:

1. Dëshmia si provë në proçesin penal:29
 - 1.1. Rregulla për marrjen e dëshmise.....25
 - 1.2. Subjektet që mund të japin dëshmi31
 - 1.3. Detyrimet e dëshmitarit.....34
 - 1.4. Nënpunësit diplomatike si dëshmitarë.....35
 - 1.5. Parashikimet e të drejtes europianë në lidhje me dëshminë.....36
 - 1.5.1. Rasti i dëshmitarëve të zakonshëm sipas të drejtes europianë.....39
 - 1.5.2. Rasti i dëshmitarëve anonime sipas të drejtes europianë.....40
 - 1.6. I mituri si dëshmitar në një proçes penal.....42
 - 1.7. Dëshmitari dhe bashkëpunëtori i drejtesisë, roli i tyre në marrjen e provës..44
2. Pyetja e të pandehurit dhe të paditurit civil si provë në proçesin penal.....45
3. Pyetja e palëve private.....51

4. Ballafaqimi.....	51
5. Njohja.....	53
6. Eksperimenti si provë.....	55
7. Ekspertimi vlera provuese në proçesin penal	57
7.1. Dallimi i ekspertimit me keqyrjen e vendit të ngjarjes.....	57
7.2. A mund të ekuivalentojme termin specialist me termin ekspert.....	58
7.3. Llojet e ekspertimeve.....	59
7.3.1. Ekspertimi daktiloskopik.....	59
7.3.2. Ekspertimi kriminalistik (ekzaminimi i veglave të thyerjes).....	61
7.3.3. Ekspertimi autoteknik.....	61
7.3.4. Ekspertimi balistik	62
7.3.5. Ekzaminimi i dokumentave.....	63
7.3.6. Ekspertimi biologjik.....	65
7.3.7. Ekspertimi mjekoligjor.....	66
7.3.8. Ekspertimi kimik e toksikologjik.....	67
7.4. Ekspertimi i detyrueshëm	67
7.5. Të drejtat e ekspertit.....	72
7.6. Struktura dhe forma e mendimit të ekspertit.....	72
7.7. Mendimi i ekspertit, kategorik apo probabël.....	74
8. Provat materiale dhe dokumentet në proçesin penal.....	75
8.1. Njohuri të përgjithshme.....	76
8.2. "Destinacioni" i provave materiale pasi ceshtja perfundon.....	77

KAPITULLI I KATËRT

Prova të tjera

1. Rezultatet e përgjimit, vlera e tyre provuese.....	81
1.1. Subjektet nën "shënjestren" e përgjimit.....	81
1.2. Përdorimi si provë i rezultateve të përgjimit.....	81
1.3. Rastet kur rezultatet e përgjimit nuk mund të përdoren si provë.....	83
2. Regjistrimi i fshehtë i bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishëmve, vlera e tyre provuese dhe raporti me përgjimin.....	84
2.1. Ndryshimi midis regjistrimit të fshehtë të bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve përgjimin.....	85
2.2. Ligjshmeria e marrjes si provë në proçesin penal e regjistrimit të fshehtë të bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve.....	86

2.3. Qëndrimi që mban KEDNJ për këtë lloj provë, raporti me nenin 8 të konventes.....	87
--	-----------

KAPITULLI I PESË

Analizë krahasimore me Kodin e Proçedurës Penale të Italise.....	90
---	-----------

PËRFUNDIME.....	103
------------------------	------------

BIBLIOGRAFIA.....	109
--------------------------	------------

HYRJE

Gjatë procesit të përgatitjes së kësaj teme është hulumtuar (gjurmuar) dokumentacioni perkates, duke u përmbledhur i gjithë informacioni shkencor, pjesëza të materialeve të ndryshme, elemente të ndryshëm duke u ndertuar kështu i gjithë punimi shkencor.

Dokumentacioni është nxjerrë nga burime të ndryshme shkencore, duke i rregulluar dhe sistemuar ato si dhe nga përvojat personale, duke grumbulluar fakte të ndryshme, ide dhe argumente, duke i analizuar ato në mënyrë të gjithanshme, duke pasqyruar përvoja dhe përjetime konkrete, duke i kombinuar ato me përvojat shkencore të vendit dhe të huaja dokumentacion i cili është sistemuar në mënyrë solide, është tubuar me një vëmendje të posaçme duke arritur në konkluzione konkrete dhe të mirëpercaktuara, të vlefshme në praktiken procedurale penale.

Në përgatitjen e temës janë shfrytëzuar burime të drejtperdrejta (paresore) si dhe burime dytesore duke i pare ato të kombinuara ndërmjet tyre dhe me veprime të ndryshme metodologjike e teknike që kanë ndihmuar në zbulimin e dokumenteve relevante për temën konkrete, duke treguar një kembengulje të madhe në kërkimin e burimeve të informatave shkencore, duke shfrytëzuar të gjitha burimet e ndryshme të informacioneve.

Në përgatitjen e kësaj teme është zhvilluar një analizë e thellë krahasuese e pasqyrimin të provave në procesin penal në kendveshtrimin e trajtimit të tyre nga Kodet e Proçedurës Penale të disa vendeve si dhe duke ju referuar edhe të Drejtes Zakonore duke shfrytëzuar pasqyrimin e tyre në Kanunin e Leke Dukagjinit , trajtimin e tyre në periudhën e pushtimit Otoman, në periudhën e Pavaresisë dhe Mbreterise Shqiptare si dhe një analizë krahasuese të Kodit aktual të Proçedurës Penale të Republikës së Shqipërisë me Kodin e vitit 1953.

Tema është rezultat i pasqyrimin të percaktimeve shkencore të kryera nga eksperte me të dalluar në fushat perkatese shkencore, duke kontrolluar të gjitha bibliografite e ndryshme, të vendit dhe të huaja, të përgjithshme dhe të vecanta, retrospektive dhe rrjedhese, duke shërbyer si instrumente të rëndësishme në grumbullimin e informacionit, duke shpresuar që kemi kontribuar sadopak në përgatitjen e një teme të vlefshme në fushën e provave, kuptimit dhe llojeve të tyre në procesin penal.

KAPITULLI I PARË

Rëndësia e provave si insitut i të drejtes proceduriale.

Nga tërsia e çështjeve që trajton e drejta procedurale penale, pa dashur të zbeh rëndësinë e çdo insituti tjetër, ne kete punim vend te veçantë merr insituti i provave si një insitut i pazëvendësueshëm dhe substancial për mbarëvajtjen dhe ecurinë e procesit gjyqësor. Ky insitut funksionon si garant i një parimi kushtetues sikurse është ai i prezumimit të pafajësisë. Parimi i prezumimit të pafajësisë gjen mbështetje edhe në nenin 4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë (të cilit do ti referohem gjatë gjithë këtij punimi) si dhe në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut neni 6 paragrafi 2. Sipas këtij parimi i pandehuri konsiderohet i pafajshëm derisa nuk është vërtetuar fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë-çdo person i akuzuar konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. Ky parim është garantuar nga e drejta e të pandehurit për një proces të rregullt gjyqësor, në këtë pikë vlen të theksohet se gjykimi i drejtë i një personi si dhe zhvillimi i një procesi të rregullt ligjor bazohet në një varg parimesh të cilat kanë të bëjnë me:

1. Gjykimin në bazë të ligjit dhe provave- Jo të pakta janë rastet kur vendimet e një gjykate shpallen të pavlefshme nga një gjykatë me e lartë për shkak se nuk janë të bazuara në prova. Po e konkretizoj rëndësinë e provave me ¹vendimin me nr 9 të datës 16.01.2008 në të cilin kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se: vendimi i Gjykatës së Apelit Vlore është marrë në kundërshtim me dispozitat e K.Pr.P. dhe si i tille duhet të priset.

Gjykata e apelit nuk arsyeton në vendimin e saj, në këtë mënyrë, në kundërshtim me dispoziten e nenit 425 të K.Pr.P. konstatohet se gjykata e apelit nuk ka shqyrtuar me kujdes materialet e dosjes gjyqësore me qëllim analizimin e pretendimeve të të gjykuarit dhe marrjen e një vendimi të mbështetur në prova e në ligj.

Sikurse kërkon dhe neni 383 i K.Pr.P. ka qenë detyrim i gjykatës që ka gjykuar çështjen që në vendimin e saj, përveçse të parashtronte rrethanat e faktit të arsyetonte ekzistencën e këtyre elementeve të figures së veprës penale të parashikuar nga neni 141/a i K.Pr.P., mbështetur në provat e administruara në gjykim.

¹ Vendimi Nr 9, Datë 16.01.2008 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

1. papërdorshmerinë e provave të marra në kundërshtim me ligjin
2. krijimi i bindjes së brendshme të gjykatës mbi bazën e provave të shqyrtuara në seance.

Fillimi i një procedimi penal behet kur ka dyshim se është kryer vepra penale. Pra prova është themeli i vendosjes se një individ i përpara përgjegjësisë për shkeljen e një dispozite ligjore. I gjithë procesi gjyqësor zhvillohet për të administruar gjale seances gjyqësore provat që subjektet procedural, organi i akuzës dhe i pandehuri kanë siguruar për të ngritur apo për të hedhur poshte akuzat (respektivisht). Në fund të procesit gjyqësor gjyqtari apo trupi gjykues kur kemi të bëjmë me një të tillë merr vendim bazuar vetëm mbi provat e administruara gjatë seances gjyqësore. Kjo tregon edhe njëherë rëndësinë substanciale që kanë provat në një proces gjyqësor si dhe në dënimin e statusit fajtor ose i pafajshëm të të pandehurit. Prova është dhe do të jetë gjithmonë një çështje themelore e të drejtës procedurale

2. Kuptimi i provës, kushtet për vlefshmerinë e saj

Për të nisur gjithcka aty ku duhet, me duhet të saktësoj se ç'është prova pra ç'konsideron provë legjislacioni penal shqiptar. Për këtë më lejoni t'i referohem nenit 149 të kodit procedural penal sipas të cilit provat janë:²

"Njoftime mbi faktet e rrethana që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij".

Pra vete ligji në perkufizimin që jep për provat kërkon si kusht që faktet e rrethanat që synon autoriteti procedues të evidentojë (nga tërësia e indicjeve dhe njoftimeve) të kenë lidhje me veprën penale. Mund të ndodhë për shëmbull që një person të japë dëshmi për një fakt i cili nuk ka asnjë lidhje me një veprë penale konkrete atëherë duke u bazuar në kodin procedural penal pamvaresisht se dëshmia mund të plotësojë të gjitha kushtet e tjera që do të përmend më poshte për t'u konsideruar provë, ajo nuk mund të ketë cilësinë e provës për veprën penale në fjale, por nuk përjashtohet mundësia që kjo e dënimin mund të

² Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009, neni 149

sherbeje si provë për një veper tjeter me të cilen fakti ka lidhje. Po të bëja një interpretim të nenit do të thoja që kushtet e mesiperme nuk konkurrojnë por duhet të plotësohen të gjitha në mënyrë absolute që të dhënat të fitojnë vlerën ligjore të provës. Kemi të bëjmë me kushte kumulative. Tri kushtet e tjera janë:

1. Njoftimet mbi faktet e provat të merren prej burimeve të parashikuara në kodin procedural penal.
2. Të merren në perputhje me rregullat e percaktuara prej kodit. Provat mund të merren vetëm në bazë të mjeteve të kërkimit të provës të percaktuara në ligj. Megjithatë në këtë pike ligji nuk është taksativ pasi ai i le hapësirë paleve dhe u lejon atyre që në raste përjashtimore të marrin prova të cilat edhe pse nuk kanë një rregullim ligjor janë të domosdoshme për hetimin. Por cili do jurist nuk duhet t'a interpretojë frazën e mesiperme, veçse me një interpretim *lato sensu*. Përjashtimi i mesiperme vlen përse kohë provat e marra jo në mënyrën e percaktuar në ligj të mos cenojnë të drejtat dhe liritë thelbësore të njeriut nder të cilat është edhe e drejta për një proces të rregullt ligjor. Edhe ligji e parashikon në mënyrë eksplicite në nenin ³515 të tij se: "Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund të marrë në qoftese ajo vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnëtit të personit". Gjykata vendos për marrjen e provës pasi degjon palet për mënyrën e marrjes se saj.
3. Provat të ekzistojnë për një qëllim pra ato të kenë një funksion, të shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit, dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.

⁴Përjashtohet nga e drejta e provës (që është mundësia që kanë palet në proces për të provuar atë që pretendojnë, nëpërmjet elementeve që cilësohen nga kodi si provues):

1. Provat që nuk kanë lidhje me faktet objekt akuze.
2. Përjashtimi i provave të paligjshme. ⁵Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është sanksionuar se askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.
3. Përjashtimi i provave të nevojshme po të cilat në fakt i referohen të dhënave të provuara me perpara.

³ Po aty, neni 151

⁴ Imeraj Elizabeta, "Provat në procesin penal", Tiranë 2008

⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2008

4. Nuk mund të përdoren provat që nuk kanë lidhje me ngjarjen.

Gjykata nuk mund të përdore prova për të cilat del në mënyrë të qarte rruga e marrjes se tyre dhe e vërtetesisë se këtyre provave . Kështu në vendimin e kolegjit penal të gjykatës se lartë nr 777 të datës 20.12.2006 ⁶në vendim argumentohet se "Gjykata në dhenien e vendimit bazohet vetëm në provat e marra të verifikuara dhe të shqyrtuara gjatë zhvillimit të séances dhe jo cdo dokument i huaj merr fuqinë e provës. Në këtë vendim behet fjale për një vendim që ishte marrë me pare nga gjykata e shkallës se pare dhe ajo e apelit për zgjidhjen perfundimtare të çështjes duke u bazuar në dokumentat të huaja të cila janë adrninistruar në fashikullin e gjykimit. Por në bazë të nenit⁷ 509 të kodit të proçedurës keto dokumenta marrin vleren e provës vetëm pasi gjykata apo prokuroria ka derguar në ministrinë e drejtesisë leterporosite për njoftimet dhe marrjen e provave , për ti nisur ato drejt shtetit tjetër.

⁸Janë objekt provë faktet që kanë lidhje me akuzën, fajesinë e të pandehurit, caktirnin e masave të sigurimit, denimin dhe përgjegjësinë civile, si dhe faktet nga të cilat varet zbatimi i normave proçedurale.Objekti i të provuarit ka një rëndësi të veçantë pasi percakton materialin provues, pra në një fare mënyrë vendos limitet mbrenda të cilave duhet të kërkojme provat.

Proçesi i formimit të provës rruund të trajtohet i ndare në tre momente individualizimi ,mbledhja dhe vleresimi i provave. Nëse do të me duhej të permendja një klasifikim të provave do të permendja kategorizimin e tyre në: prova të përgjithëshme dhe prova specifike, prova direkte e indirekte, prova të plota e jo të plota, prova personale e materiale, prova jo të plota dhe prova të plota, prova origjinale dhe prova të prejardhura.

⁹Prova e përgjithëshme është cilësuar ajo që ka të beje me qartësimin e faktit vetëm në nivel objektiv, ndersa prova specifike është cilësuar vetëm ajo që ka të beje me qartësimin e faktit në nivel subjektiv pra me individualizimi e autorit të veprës penale.

Prova të plota e jo të plota.¹⁰ Ky klasifikim bazohet në rëndësinë dhe peshen që ka prova për të zbuluar të vërteten, prova e plotë e provon në tërësi të vërteten e të pa vërteten ndersa prova jo e plotë e bën këtë vetëm pjesërisht.

⁶ Vendimi Nr 777, Datë 20.12.2006 Kolegji Penal i Gjykatës se Lartë

⁷ Kodi i Proçedurës Penale i Republikës se Shqipërise, Botim i QPZ, Tiranë 2009, neni 509

⁸ Po aty

⁹ Imeraj Elizabeta, "Provat në proçesin penal", Tiranë 2008

¹⁰ Sahiti Ejup "Argumentimi në proçeduren penale", Prishtinë 1999, faqe 120

Provë origjinale është ajo provë e cila merret drejteperdrejt nga burimi i saj ndersa prova e prejardhur është prova për të cilen organi procedues merr dijeni terthorazi nga një burim tjetër dhe jo nga burimi i saj i drejteperdrejte.¹¹ Provat e prejardhura nuk mund të zëvendësojnë provat origjinale por ndihmojnë në zbulimin e tyre.

Provë personale janë njohurite e drejteperdrejta ose të terthorta të individit ndersa provë materiale janë sendet ose dokumentet.¹²

Kur flasim për procedimin penal e shikojme atë të lidhur ngushtazi nga dy "etapat" që e karakterizojnë atë procesi hetimor, dhe procesi gjyqësor.¹³ Në fazën e hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të percaktuara në këtë kod në nenin 151 të tij por edhe i pandehuri nuk përjashtohet në mënyrë absolute nga mundësia e tij për të marrë prova që në këtë fazë, ndërsa në gjykim provat merren me kërkesën e paleve. Duhet të theksojmë se tipike e një sistemi akuzator është se drejta e provës dhe e drejta për të marrë prova, është një e drejtë që ligji ua njeh ekskluzivisht vetëm paleve dhe jo gjykatës. Një qëndrim totalisht të kundërt veme re në sistemin inkuizitor ku gjykata është tepër aktive në procesin e marrjes së provave duke i'u kundërvënë rolit të arbitrit që ajo ka në sistemin akuzator. Duke u nisur nga një analizë e sistemit tonë ligjor jam e mendimit, që është një sistem i cili nuk mund të cilësohet si sistem tërësisht akuzator apo inkuizitor por ka ndërthurje të karakteristikave të të dy sistemeve të përmendura më sipër, pra le të themi që është një sistem "hibrid". Jam tërësisht e bindur kur shpreh një gjë të tillë për vetë faktin që roli i gjykatës në sistemin tonë ligjor nuk është as tërësisht aktiv si në sistemin inkuizitor por nuk është as një rol tërësisht pasiv si në sistemin akuzator. Në sistemin tonë rolin thelbësor dhe të drejtën ekskluzive në marrjen e provave e kanë palet por edhe gjykatës i rezervohet një e drejtë e tillë kur një gjë e tillë është në dobi të një gjykimi të rregullt dhe të paanshëm. Në këtë pikë skeptiket do të shtronin pyetjen se a është kjo një e drejtë që në vetevetë çënon imazhin e gjykatës si të paanshme dhe jo paragjykyese. Në opinionin tim përgjigja do të ishte jo, sepse kur lexon këtë frazë të duket sikur gjykata perpiqet të mbledhë prova që synojnë të fajësojnë apo të nxjerrin të pandehurin jo fajtor pra të shkarkojnë atë nga përgjegjësia kur në të vërtetë qëllimi i vetëm i gjykatës është zgjidhja e drejtë e çështjes duke u bazuar në faktet dhe të dhënat e garantuara nga

¹¹ Sahiti Ejup "Argumentimi në procedurën penale", Prishtinë 1999, faqe 120

¹² Po aty

¹³ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009

mbledhja e provave, si dhe permisimi i imazhit të sistemit të drejtësisë si një sistem efektiv dhe që funksionon realisht në mënyrë aktive. Gjykata vendos me urdhër duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë haptazi të panevojshme. Provat që janë të përjashtuara nga gjykata i permenda në mënyrë me të detajuar edhe në fillim të ketij punimi. Mund të ndodhe që një provë pasi është marrë të konsiderohet nga gjykata si një provë haptazi e panevojshme.

Ligji shprehet edhe në lidhje me këtë situatë duke saktësuar se ¹⁴disponimet mbi marrjen e provave mund të revokohen në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor. (neni 151) Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren.

KAPITULLI I DYTË

Historik, llojet e provave në legjislacionin shqiptar në periudha kohore të ndryshme

¹⁴ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009, neni 151

Proçesi i të provuarit ¹⁵ ka njohur zhvillime të ndryshme si faktor i ndryshimeve që kanë pesuar marrëdhëniet shoqerore, kushtet politike apo kushtet ekonomike të vendit tonë. Prova si një nga insitutet me të rëndësishme të procedurës penale mendohet se janë parashikuar për here të pare nga romaket e lashte në vitin 149 para eres se re me ligjet Lex Carpunia, Lex Julia.¹⁶

1. Provat e parashikuara në kanunin e Leke Dukagjinit

Në vendin tonë trajtimin e zhvillimit të provave po e nis me kanunin e Leke Dukagjinit, i cili perfaqeson me se miri të drejten zakonore në vendin tonë .Të njëjtin trajtim sikurse ky kanun bën edhe kanuni i Laberise.Sipas kanunit të Leke Dukagjinit organi gjyqësor në këtë periudhë do të ishte keshilli i pleqve që perbehej nga kreret e fiseve si dhe nga njërez të tjere(gjithsej 12 anëtare të ndershem të asaj zonë).¹⁷ Në keshillin e pleqeve merrnin pjese vetëm burra në moshe madhore. Pleqesia kishte karakter patriarkal. Ajo gjykonte si çështjet me karakter civil ashtu edhe ato me karakter penal.¹⁸

Gjykimi që bente pleqesia kishte karakter akuzator. Proçesi ishte një proçes jo formal, që zhvillohej jo mbi bazën e rregullave. Ishte një proçes verbal ku cdo vendim jepej verbalisht vetëm me goje, e nuk dokumentohej me shkrim.Në këtë periudhë vepronte parimi "be mbi be dhe gjygj mbi gjygj nuk ka" që nënkuptonte faktin që ishin të ndaluara gjykimi dy here për të njëjtën veper bazuar në prova materiale dhe indirekte të njëjta.

E drejta për të hetuar në këtë periudhë sipas kanuni, i njihej pleqesisë të akuzuarit dhe vete kapucarit. Kapucari është personi që zhvillon hetime, zbulon e merr prova rreth akuzës se ngritur. Sikurse edhe në sistemin e sotem ligjor, barren e provës e kishte subjekti që ngre akuzën apo bën padinë. Në këtë kanun parashikoheshin keto lloj provash: Pohimi i të akuzuarit, dëshmia e dëshmitarit, kapja në flagrancë, mendimi i ekspertit njohja e sendeve sendet e shkresat.

Pohimi i të pandehurit konsiderohej si provë nga ana e pleqesisë, por nuk verifikon saktësinë e pohimit. ¹⁹ Në momentin që i akuzuari deklaronte se ishte fajtor, ai shpallej i tille, me përjashtim të rastit kur nga provat e tjera rezultonte se fajtor ishte një person

¹⁵ Elezi Ferdinand, "Provat penale" Tiranë 2008

¹⁶ Sahiti Ejup "Argumentimi në proceduren penale, Prishtinë 1999, faqe 71-74

¹⁷ Po aty

¹⁸ Elezi Ferdinand, "Provat penale" Tiranë 2008

¹⁹ Elezi Ferdinand, "Provat penale" Tiranë 2008

tjetër. Vetëm në një rast të tillë pohimi i të pandehurit merrej parasysh nga pleqesia me rezerva. Sikurse edhe sot në kanun përcaktohej se për të marrë pohimin e të akuzuarit nuk mund të përdorej asnjë mjet shtrengimi.²⁰ Në të vërtetë natyra e organizimit dhe e funksionimit të pleqnise në rastin e zgjidhjes së konflikteve ndërmjet paleve është e atillë që nuk e aplikon torturen për të marrë me dhunë pohimin.

²¹Dëshmia . Në këtë periudhë në ndryshim nga parashikimi që bënte KPrP aktual konsiderohej dëshmi vetëm thëniet e meshkujve në moshe madhore.

Nuk mund të ishin dëshmitarë:

- femrat
- personat me të meta psikike e fizike
- personat të cilët keshin humbur nderin publik

Dëshmia si provë në këtë periudhë përdorej më tepër si mjet i mbrojtjes për delinkuentin sesa si provë akuzuese.

Dëshmitari në ndryshim nga parashikimi i sotëm ligjor, nuk kishte detyrimin për të dëshmuar po nëse ai pranonte të dëshmonte, sikurse kodi aktual i procedurës penale, kanuni përcaktonte sanksionë në rast se dëshmitari bente dëshmi të rreme. Dëshmitari duhet të betohej mbi fjalën e tij të nderit.²² Kanuni po ashtu si KPrP i sotëm parashikonte mundësinë që nëse dëshmitari e kishte të pamundur të shfaqej përpara pleqesisë, duhej të shkonte ajo në vendin ku ndodhej dëshmitari për të marrë dëshminë.

Kapja në flagrancë është një lloj provë të cilën kodi ynë nuk e përcakton shprehimisht

në kreun për provat por një e dhenë e tillë patjetër që shërben si provë për të venë personin përpara përgjegjësisë penale.²³ Kanuni i Leke Dukagjinit është i vetmi që e përcakton ekskluzivisht si provë. Kapja në flagrancë parashikohej si provë e plotë nga pleqesia. Flagranca nënkuptonte rastin kur autori i veprës kapej gjatë kryerjes së veprës ose menjëherë pas saj.

Mendimi i ekspertit ishte një provë që kishte rëndësi kur duhej të përcaktohej vlera e dëmit që ishte shkaktuar nga vepra penale, për të përcaktuar demshperblimet.²⁴ Dëmi i

²⁰ Sahiti Ejup "Argumentimi në procedurën penale, Prishtinë 1999, faqe 81

²¹ Po aty, faqe 82

²² Elezi Ferdinand, "Provat penale" Tiranë 2008

²³ Elezi Ferdinand, "Provat penale" Tiranë 2008

²⁴ Sahiti Ejup "Argumentimi në procedurën penale, Prishtinë 1999, faqe 84

shkaktuar nga vepra penale ishte dy llojesh, material dhe dëmi i cili shkaktonte demtime trupore . Ekspertet e percaktonin demin në bazë të eksperiences dhe shkathtesisë që kishin për të kryer këtë detyrë. ²⁵Eksperti nuk ishte i detyruar ta kryente këtë detyrë.

Njohja e sendit përdorej si provë dhe shërbente për të vërtetuar pronësinë e sendit ²⁶.

Sendet dhe shkresat.Persa i perket sendeve përdoreshin si provë dhe shërbenin për të percaktuar:

- faktin që autori ishte autor i veprës penale
- faktin që personi ndodhej në vendngjarje

Sa për dokumentat përdorimi i tyre si provë ishte shume i rrallë për arsye se në këtë periudhë veprimet kryheshin në mënyrë jo formale nuk fiksoheshin në dokumenta, shkak për të cilin ka qenë edhe prania në këtë periudhë e fenomenit të analfabetizmit.

2. Periudha e pushtimit otoman

Pohimi i të pandehurit - ikrar ishte një provë e cila pranohej si e tillë vetëm nëse personi që do të deklaronte do të ishte madhor dhe të mos ishte i semure mendore. ²⁷ Sipas të drejtes se sheriatit ishte e ndaluar të përdorej dhunë për nxjerrjen e pohimit të të akuzuarit. Sikurse edhe sot e drejta nuk i jepte kësaj provë epersi në krahasim me provat e tjera, por kërkonte që kjo provë të çmohej në raport me provat e tjera.

Dëshmia-shehade ka qenë prova që përdorej me shpesh në këtë periudhë, ajo ze gati një vend dominant .Dhenia e një dëshmie nënkupton deklarimin e një personi para kadiut në prezence të paleve me qëllim të argumentimit të të drejtes se dikujt. ²⁸ Dëshmia jepej në bazë të perceptimeve personale të dëshmitarit e jo sipas hamendjes. Në periudhën e pushtimit otoman kemi një pozite procedurale të re të dëshmitarit (e njëjtë me pozitën e sotme procedurale),në krahasim me atë që percaktohej në kanunin e Leke Dukagjinit. Dëshmitari e kishte detyrim ligjor të deshmonte. Por në ndryshim nga sot pranohej dëshmia e drejteperdrejte pra ajo e bazuar në të dhëna të perceptuara nga vete dëshmitari. Ndersa deshrnia që jepej në bazë të të dhënave që një person kishte degjuar nga deshrnitari

²⁵ Elezi Ferdinand, "Provat penale" Tiranë 2008

²⁶ Po aty

²⁷ Sahiti Ejup "Argumentimi në proceduren penale,Prishtinë 1999, faqe 50

²⁸ Sahiti Ejup "Argumentimi në proceduren penale,Prishtinë 1999, faqe 50-52

original (dëshmia indirekte) si rregull nuk pranohej, një dëshmi e tille pranohej vetëm në rastin kur dëshmitari original ka vdekur ose ka udhëtuar larg.

Dëshmitari duhet të deshrnonte edhe për raportin që kishte me personin e akuzuar, nëse kishte marrëdhënie miqesore apo jo miqesore . Nuk mund të deshmonin femrat dhe jo myslymanët.²⁹ Si dëshmitar në këtë periudhë mund të pyetej edhe personi i demtuar nga vepra penale. E veçanta e këtij sistemi ishte që vendoste "kuota" mbi numrin e dëshmitarëve që duhet të deshmonin për të provuar fajesinë e të akuzuarit për një veper penale në përgjithësi, dhe për vepra me karakter moral në veçanti. Numri i dëshmitarëve duhej të ishte perkatesisht jo me pak se dy dhe jo me pak se kater.³⁰ Se dyti në të drejten e sheriatit hasim një insitut specifik sikurse është ai i quajtur tezkije i cili ka të beje me tubimin e të dhënave për verifikimin e personalitetit të dëshmitarit perpara se kadiu të marrë dëshminë e tij.

Dëshmitari perpara se të depononte duhet të betohej.³¹ Kapja në flagrancë parashikohej në kodin turk të proçedurës penale sikurse edhe në kanunin e Leke dukagjinit. Sendet dhe shkresat të parat perbenin dëshmi nëse gjendeshin në vendngjarje apo lidheshin me kryerjen e veprës penale, ndersa shkresat në këtë periudhë pothuaj ishin të papërdoshme në proçesin gjyqësor për shkak të pranise se analfabetizrnit.

Mendimi i ekspertit-sahibul mesail sikurse në periudhën e mëpareshme percaktohej si provë kur një gje e tille ishte e nevojshme për të percaktuar vleren e dëmit të ardhur nga vepra penale. Caktohej si ekspert individi që kishte njohuri kryesisht rnjëkesore dhe ekonomike.

3.³² Periudha e pavaresisë 1912-1953

Në këtë periudhë në vendin tonë edhe pse pati perpjekje fillimisht të qeverise se Vlores dhe me pas të qeverive të tjera për të adoptuar një legjislacion shqiptar me akte dhe ligje të nxjerra nga autoritet shqiptare, vijoi të zbatohej deri në periudhën e mbreterise shqiptare legjislacioni turk. Ky legjislacion zbatohej si për organizimin e sistemit gjyqësor, ashtu edhe për aspekte të tjera proçedurale.

²⁹ Elezi Ferdinand, "Provat penale" Tiranë 2008

³⁰ Sahiti Ejup "Argumentimi në proçeduren penale, Prishtinë 1999, faqe 52

³¹ Elezi Ferdinand, "Provat penale" Tiranë 2008

³² Elezi Ferdinand, "Provat penale" Tiranë 2008

4. ³³Mbretënia shqiptare

Në periudhën e mbretënise u hatuan një sere aktesh sikur ishte statuti themeltar i mbretënise shqiptare, kodi penal, kodi mbi aplikimin e kodit penal, kodi civil etj. Hetimet i drejtonin prokuroret e shtetit të cilet ishin në varesi të kryeprokurorit.

Por parashikohej edhe mundësia e kryerjes se hetimeve nga gjyqtari hetues, koncept i cili nuk ekziston me. Vërtet në kodin aktual të proçedurës penale në nenin 367 të tij sanksionohet se pas marrjes se provave të kërkuara, gjykata, në qofte se është e nevojshme, mund të beje pyetje shtese dhe të disponoje, edhe kryesisht, marrjen e provave të reja. Por ky rol i gjykatës nuk duhet kurrësi të barazohet me atë të gjyqtarit hetues i cili ka një rol tepër aktiv në marrjen e provave. Sot gjyqtari procedon vetëm për marrjen e provave plotësuese ose të reja të cilat nuk janë marrë nga palet. Kodi aktual percakton qarte që rol paresor në marrjen e provave i takon paleve dhe në sistemin akuzator gjykata nuk është me pale por thjesht një arbiter.

Në aspektin proçedural nuk pati dispozita ligjore të vecanta dhe për këtë arsye procedohej si më parë.

5. ³⁴Analizë krahasuese ndërmjet kodit proçedural penal të vitit 1953 dhe kodit që është sot në fuqi.

KPrP i 1953 u hartua në perputhje me ligjin nr 1650 i dates 30.03.1953 dhe hyri në fuqi në datë 1.06.1953 perbehej nga 364 nene. Kode të tjera proçedurale penale pati disa por ky ishte kodi i pare që trajtonte çështjet e proçedurës penale. Ky kod ishte perfaqesues tipik i sistemit inkuizitor gje që nënkupton se bazohej në parime të ndryshme në krahasim me ato të kodit aktual.

Në kod percaktohej se ndjekja penale drejtohej nga prokurori i cili kishte të drejtë të kryente vete hetime. Prokurori në këtë detyrë ndihmohej edhe nga organe të tjera të hetimit e gjurmimit por në këtë kod parashikohej se e drejta për të ushtruar ndjekjen penale mund të ushtrohet edhe nga gjykata (nenin 67).

Kodi trajtonte me hollësi të gjitha insitutet e proçedurës penale por për të qenë korrekte me objektin e temës unë do të perqendrohem në kreun mbi llojet e provave.

³³ Po aty

³⁴ Po aty

Llojet e provave percaktohen në nenet 60-85 si provë në bazë të ketyre dispozitave shërbenin:

1. Thëniet e dëshmitarit
2. Thëniet e të pandehurit
3. Mendimi i ekspertit
4. Prova materiale e dokumentet me shkrim
5. Proçesverbalet e veprimeve hetimore e gjyqesore.

Në një veshtrim të shpejtë do të dilnim në konkluzionin që përgjithësisht kodi i 1953 percakton si prova ato lloje që percaktohen edhe nga kodi i tanishëm, me përjashtim të ballafaqimit dhe eksperimentit (të cilin nuk e parashikon). Kjo është një e dhenë që pritej pasi vete fakti që kemi të bëjmë me vitet 1953 na bën të mendojme se në Shqipëri në këtë periudhë nuk mund të flasim për zhvillime teknike të tilla që të japin mundësinë të riprodhosh gjendje të caktuara në laboratore.

Dëshmia është një provë që trajtohet nga kodi në nenet 64-68. Në ndryshim nga kodi i sotem dëshmitarit nuk i njihet mundësia për të mos deshmuar për shkak të lidhjeve që kishte me të pandehurin ose për shkak të detyrës për të ruajtur sekretet profesionale. Dy shkaqe keto të cilat kodi i sotem i proçedurës penale i trajton në dy dispozita të vecanta, si shkaqe të cilat cojnë në përjashtimin nga detyrimi për të deshmuar.

Një risi e këtij kodit të 1953 ishte edhe thirrja si dëshmitar e mbrojtësit të të akuzuarit në raste kur ky i fundit dyshohej për krime kunder shtetit.

Thëniet e të pandehurve

I pandehuri pyetej pasi i ishte njoftuar akuza . Një risi e kodit të 1953 ishte fakti që ai lejonte pyetjen e të miturit pa praninë e mbrojtësit.

KPrP i 1953 njësor si kodi i sotem i njihet të drejten për të qenë prezent në pyetjen e të miturit, arsimtarit ose një personi tjetër. Thëniet e të pandehurit kanë të njëjten vlerë provuese sikurse provat e tjera.

Kodi i 1953-shit nuk percakton të drejten e të pandehurit për të mos u përgjigjur. Kjo është një e drejtë që i njihet të pandehurit dhe është sanksionuar në kodin proçedural penal që është një fuqi.

Kodi i vitit 1953 i jepte një rëndësi të veçantë rastit kur mund të lejohej të përdorej si provë leximi i thënieve të pandehurit apo të dëshmitarit. Percaktonte tri raste (neni 42):

- Kur i pandehuri gjykonte në mungesë ose nuk jepte shpjegime para gjykatës.

- Dëshmitari banonte larg vendit të gjykimit
- Kur ishte vendosur largimi i të pandehurit apo dëshmitarit nga salla e gjykimit. Kodi aktual e trajton me me detaje leximin e lejueshëm duke parashikuar dy dispozita specifike vetëm për këtë. Keto dispozita do t'i trajtoj në mënyrë specifike në vijim.

Ekspertimi

Sikurse sot:

- Ekspert mund të percaktohet personi që zoteron njohuri teknike e shkencore.
- Ekspertet duhet ta jepnin mendimin e tyre me shkrim.
- Parashikohej detyrimi për të njoftuar të pandehurin mbi caktimin e ekspertit.
- I pandehuri kishte të drejtë të kërkonte përjashtimin e tij.

³⁵K.PrP e 1953 sjell një risi për sa i perket ekspertimit të detyrueshëm. Edhe pse ishte kodi i pare që merrej me rregullimin e çështjeve procedurale duket se në këtë pike është mjaft koherent . Në nenin 70 të tij percaktohen rastet kur ekspertimi duhet të jetë i detyrueshëm(raste të cilat aplikohen edhe sot në të njëjtën mënyrë) Janë të detyrueshme për t'u kryer:

- Ekspertimi për të percaktuar shkaqet e vdekjes si dhe realizimin e plageve.Ky lloj ekspertimi njihet ndryshe me emrin autopsi. ³⁶Autopsia është e detyrueshme kur ka dyshim se viktimë është vrare helmuar e ka pesuar vdekjen jo për shkaqe natyrore.
- Ekspertimi që vlen për të percaktuar moshën e vogël të të pandehurit kur një e dhenë e tillë konsiderohet e pamundur për t'u evidentuar.
- Ekspertimi që shërben për të percaktuar gjendjen psikike të të pandehurit kur lindin dyshime për përgjegjësinë e tij.
- Ekspertimi që shërben për të konstatuar pjekurinë seksuale në rastin e krimeve që lidhen me marrëdhëniet seksuale.

KPrP që është sot në fuqi nuk e perfshin një dispozite të tillë

Provat materiale dhe dokumentet

³⁵ Tartale Fatmir, "Ekspertimi në të drejten procedurale penale në R.Sh", Tiranë 1999

³⁶ Ligji nr. 7830 datë 25.06.1994 "Për autopsinë" në R.SH

Përgjithësisht trajtimi që bën kodi i 1953 është i njëjtë me kodin e sotëm. Edhe kodi i 1953 percakton dispozite të veçantë në lidhje me fatin e sendeve pas perfundimit të çështjes , si dhe detyrimin ligjor të organit procedues për perkthimin e dokumenteve të huaja.

Ballafaqimi

Sot ballafaqimi është percaktuar në mënyrë eksplicite në kodin e procedurës penale madje është trajtuar hollësisht ,ndersa në kodin e vitit 1953 nuk është percaktuar në mënyrë të shprehur ballafaqimi si lloj provë. Megjithate në nenin 81 të ketij kodi trajtohej e drejta e gjyqtarit apo hetuesit për të ballafaquar dëshmitarët, të pandehurit apo dëshmitarin me të pandehurin ,kur thëniet ishin të kunderta.

KAPITULLI I TRETË

LLOJET E PROVAVE TË CILAT PERCAKTOHEN NË MËNYRË EKSPLOCITE NË KOD RREGULLAT PËR MARRJEN E TYRE

1. DËSHMIA

Provat janë nga me të larmishmet, një larshmeri që percaktohet në kodin e procedurës penale të Republikës së Shqipërisë në nene të vecanta të tij. Në fakt kodi nuk percakton në një nën të vetëm të gjitha llojet e provave por doktrina ka bërë një klasifikim të llojeve të provave në dy kategori:

1. Provat që parashikohen në mënyrë të drejteperdrejte në kod të cilat renditen në kod në seksionë të vecanta si me poshte:

- Dëshmia
- Pyetja e të pandehurit dhe pyetja e paleve private
- Ballafaqimi
- Njohja
- Eksperimenti
- Ekspertimi
- Provat materiale
- Dokumentat

Për çdo provë kodi parashikon një seksion të veçantë duke i kushtuar secilës prej tyre një numer dispozitash , të cilat detajojnë për çdo provë kuptimin e saj rastet kur mund të merret, rastet kur nuk është e lejueshme marrja e provave të tilla, personal nga mund të sigurohen këto prova etj...

2. ³⁷Provat që nuk kanë një rregullim ligjor po për të cilat gjykata jep autorizimin për marrjen e tyre (në nenin 151 të KPrP parashikohet se kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund të marrë në qoftese ajo vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnëtit të personit). Në kategorinë e ketyre provave përfshihen fotografimet, filmimet, deklaratimet e provokatorit apo të infiltruarit në krimet kundër trafikimit të narkotikeve.

Dëshmia është prova e parë që do të trajtoj në këtë punim. Dëshmia është prova me e vjetër e cila nuk mungon asnjëherë në percaktimet që kodet proceduriale të periudhave të ndryshme bëjnë për llojet e provave në procesin penal. Është një provë që synon transmetimin e të dhënave nga personi që ka parë ngjarjen apo ka dijeni për të, tek personi që do të vendosë e gjykojë çështjen. Zgjedhja për ta trajtuar të parën nuk lidhet me faktin se dëshmia mund të jetë prova që ka një vlerë me të rëndësishme se provat e tjera për zgjidhjen e drejtë të çështjes, pasi për këtë në mënyrë ekzakte kodi shpreh se dëshmia si

³⁷ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009

provë është një provë që nuk ka vlere të paracaktuar por vleresohet në unitet me provat e tjera dhe ligji në këtë mënyrë i jep asaj të njëjtën vlere si provat e tjera. Zgjedhja ime për ta trajtuar të paren në radhen e provave vjen si rezultat i respektimit të faktit që është prova me e vjeter gjithashtu edhe për të respektuar kodin aktual të procedurës penale i cili ka bere të njëjtin trajtim. Kodi nuk ka një dispozite ku të percaktohet se ç'kuptohet me dëshmi por nga një interpretim i dispozitave të tij në seksionin mbi dëshminë do ta perkufizojë dëshminë si thënie apo njoftime për fakte apo rrethana që perbejnë objekt provë në një procedim penal, të cilat jepen nga një person që ka dijeni mbi keto të dhëna si pasoje e perceptimit të drejteperdrejte dhe individual të tyre. Ky do të ishte perkufizimi i dëshmise direkte.

Thënie apo njoftime për fakte apo rrethana që perbejnë objekt provë në një procedim penal, të cilat jepen nga një person që ka dijeni mbi keto të dhëna jo si rezultat i perceptimit të drejteperdrejte mbi keto fakte por si pasoje e të dhënave që të tjeret i kanë dhenë për ngjarjen në fjale. Ky do të ishte perkufizimi i dëshmise indirekte të parashikuar në ³⁸nenin 154 të kodit i cili parashikon si vijon:

Nëse dëshmitari shprehet se faktet i njeh si rezultat i kontaktit që ka pasur me persona të trete atehere me kërkesë të pales por edhe kryesisht gjykata urdheron që edhe keta të thirren për të dëshmuar. Nëse një kërkesë e tille nuk respektohet atehere janë të pavlefshme të gjitha thëniet mbi faktet të cilat ai i ka mesuar nga persona të tjere. Me përjashtim të rastit kur ata janë të pamundur për t'u pyetur për shkak se kanë vdekur janë të semure rëndë ose nuk gjenden. Dëshmitari nuk mund të pyetet për faktet që i ka mesuar nga persona që janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional apo shteteror me përjashtim të rastit kur keta persona kanë deklaruar për të njëjti fakt me perpare ose i kanë perhapur ato me ndonjë mënyrë tjeter.

Nuk mund të përdoret dëshmia e atij që refuzon ose që nuk është në gjendje të tregoj personin ose burimin nga të cilet ka marrë dijeni për fakte që pyetet. Në lidhje me dëshminë indirekte vlen të permendim ³⁹vendimin me nr 62 të kolegjit penal të gjykatës se lartë ku dëshmitari R.L ishte venë në dijeni nga persona të tjere se vellanë e tij e kishin vrare "Gjokutajt" por ai nuk pranoi të jepte burimin e informacionit në këtë rast trupi gjykues vendosi që prova të ishte e papërdorshme.

³⁸ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009

³⁹ Vendimi Nr 62, Datë 14.02.07 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

Një pike mjaft e rëndësishme është detyrimi që kanë dëshmitarët për të ruajtur sekretin profesional dhe shtetëror në bazë të neneve 59 dhe 160 të KPrP.⁴⁰ Neni 59 përfshin kategorinë e personave që nuk mund të pyeten për shkak të profesionit me përjashtim të rastit kur janë të detyruar të referojnë veprën penale autoriteteve procedurale. Pra duhet të ruajnë sekretin profesional:

1. Perfaqesuesit e besimeve fetare statutet e të cilit nuk janë në kundërshtim me rendin juridik shqiptar
2. avokatet, perfaqesuesit, noteret
3. mjeket, kirurge, farmacistet, obstetret dhe kushdo që ushton një profesion shëndetësor
4. ata që ushtrojnë profesionë të tjera që ligji ua njeh të drejtën të mos dëshmojnë për ato çështje që lidhen me sekretin profesional

Por procesi i përjashtimit të këtyre personave nga detyrimi për të dhënë dëshmi nuk është një proces për të cilin ligji është vakant dhe e le në dorë të vete këtyre personave. Gjykata ka të drejtë që të urdherojë edhe të behen verifikimet e duhura në rast se ajo vete ka dyshime të arsyeshme se keta persona nuk kanë baza për të pretenduar shmangien e dhenies së dëshmive. Ajo mund të urdherojë marrjen e dëshmive nga keta persona nëse sipas verifikimeve rezulton se shmangia është pa baza. Në këtë rast pra prevalon interesi për të marrë një dëshmi që ka vlerë thelbësore si provë për një çështje të caktuar në krahasim me interesin për të ruajtur sekretin profesional. Po e konkretizoj gjithë çfarë thashe me siper me një shëmbull. Rasti kur kemi të bëjmë me një nga veprat me të rrezikshme për shoqërinë e sotme janë veprat që kanë lidhje me prodhimin, fabrikimin dhe trafikimin e lendeve narkotike e psikotrope sikurse janë drogat me përbajtje opiumi drogat halucinogjene dhe substancat depresive vepra të cilat parashikohen në nenet 283- 286 të kodit tonë penal. Të gjithë jemi në dijeni të faktit që këto substanca mbahen e ruhen për nevojën të ndihmës urgjente e profesionale nga persona fizike e juridike të caktuar sikurse janë objekte shëndetësore (farmacite, farmacie të spitaleve shtetërore apo private, depo shtetërore apo private të barnave, mjeket kirurgët apo veterinarët e autorizuar për të dhënë barna etj.

⁴¹Ekzistojnë tri metoda kryesore nëpërmjet të cilave sigurohen narkotiket:

1. Me anë të vjedhjeve në pikat e mesipërme

⁴⁰ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009

⁴¹ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina" Tiranë 2007

2. Me anë të falsifikimit të recetave mjekesore
3. Me anë të trafikut të lendeve narkotike nga bandat kriminale

Në rastin e parashikuar në piken e dyte pavaresisht detyrimit që ka mjeku të mos beje publike informacione që konsiderohen sekrete profesionale pershëmbull të publikoje të dhënat në emer të personave për të cilat është leshuar receta ,apo në rastin e një farmacisti të jape emrin e mjekeve që leshojnë receta për përdorimin e ketyre substancave keta të fundit janë të detyruar të bashkëpunojnë me organin procedues nëse leshimi i ketyre recetave është i pa bazë.

Detyrimin për të ruajtur sekretin profesional e kanë edhe gazetaret për emrat e personave nga të cilet ata kanë marrë të dhëna duke vepruar në cilësinë e gazetarit.⁴² Megjithate ketu ligji bën një leshim i cili ka qëllim ti jap prioritet intëresit publik. Gjykata ka diskrecionin që të detyroj një gazetar të tregoj burimin e informacionit të tij nëse të dhënat janë të domosdoshme për të provuar veprën penale dhe fakti që keto të dhëna janë të vërteta mund të sigurohet vetëm nëse behet publik burimi.

Neni 160 i kodit të proçedurës penale ka një rëndësi të veçantë .Ai shpreh qarte detyrimin që kanë nënpunësit shteteror ata publike si dhe detyrimin që kanë të ngarkuarit me një sherbim publik për faktet që janë sekret shteteror.

Kur dëshmitari pretendon se fakti perben sekret shteteror, organi procedues kërkon konfirmimin me shkrim të organit kompetent shteteror. Nëse sekreti konfirmohet neni parashikon 2 raste:

Rasti i pare është rasti kur prova nuk është thelbesore për zgjidhjen e çështjes dhe zgjidhja është e thjeshtë dëshmitari nuk pyetet.

Në rastin e dyte prova është thelbesore për zgjidhjen e çështjes në këtë rast organi procedues pezullon çështjen derisa të jape përgjigje organi me i lartë i administrates shteterore.

Kodi parashikon një afat proçedural prej 30 ditesh nga njoftimi i kërkeses mbrenda të cilit organi kompetent shteteror duhet të jap konfirmimin që një fakt i caktuar perben sekret shteteror nëse autoriteti kompetent nuk i permbahet afatit që ka percaktuar ligji atehere dëshmitarit i kërkohet të deshmoje.

⁴² Kodi i Proçedurës Penale i Republikës se Shqipërise, Botim i QPZ, Tiranë 2009

Ka një kategori të dhënash që nuk klasifikohen si sekret shteteror dhe keto janë të dhënat apo dokumentat që lidhen me vepra penale të cilat kanë si synim permbysjen e rendit kushtetues. Në gjykimin tim ligji në këtë rast sanksionon detyrimin që ka organi procedues për të marrë dëshminë nga subjektet e të drejtes penale qofte edhe nga persona të siperpermendur në cdo rast që has me një veper penale të llojit të sipercituar.

Për marrjen e një dëshmie procesi kalon në tri etapa. Fillimisht organi procedues kryen veprimet pergatitore percakton radhen e pyetjes se dëshmitarëve⁴³ pyeten në fillim:

1. Dëshmitari që ka perceptuar me mirë ngjarjen për këtë mund të këtë ndihmuar edhe prirje e tij profesionale.
2. Dëshmitarët që japin të dhëna për personalitetin e të pandehurit.
3. Kur janë në rrethana të njëjta dëshmitarët që japin informacione që flasin për rrethana të vjetra të ngjarjes.
4. Prioritet në pyetje u jepet edhe dëshmitarëve që i nënshtrohen lehtësisht vullnëtit të pandehurit.

Organi procedues vërteton identitetin e të pandehurit që do të pyetet ose të dëshmitarit Në fazen e dyte e njofton personin që do të merret në pyetje të deshmije për të dhënat që ka dijeni . Dëshmitari pyetet për faktet që perbejnë objekt provë, për fakte që kanë të bejnë me veprën penale (për çdo gje që lidhet me të provuarin e veprës) Në këtë faze organi procedues është shume i kujdesshëm të mos e nderprese tregimin e lire.

Faza e tretë ka të beje me berjen e pyetjeve. - Pyetja është një proces hetimor e gjyqësor me anë të se cilës organi procedues merr drejtepersedrejt thënie që kanë rëndësi për zgjidhjen e drejtë të çështjes nga dëshmitari i demtuari, i pandehuri etj. Nëse gjatë tregimit të lire dëshmitari i ka dhenë të gjitha informacionet dhe nuk ka nevojë për pyetje plotësuese kjo faze eliminohet.

1.1 Rregulla taktike e proçedurale për marrjen e dëshmise

Në lidhje me proçesin e marrjes se dëshmise pra të pyetjes se dëshmitarit duhet të veme theksin në një sere rregullash taktike dhe proçedurale që organi procedues duhet t'i respektoj për marrjen e një dëshmie të plotë dhe të sakte. Kur flasim për provat nuk

⁴³Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 421-425

mundem kurrresi të kufizohern në dispozitat që parashikon kodi për to. Të referohesh vetëm në kod do të thote të flasësh vetëm në një kuptim scruto sensu për to. Pra është një shpjegim mjaft i kufizuar .Është pikerisht kjo arsyeja që me bën ta shtjelloj edhe pak me shume këtë çështje duke i'u referuar edhe taktikes kriminalistike të pyetjes .Cilido që mund të lexojë këtë teme ndoshta dote jetë pak skeptik ndaj kësaj zgjedhjeje madje mund ta quajë këtë gje një anashkalim të temës. Personalisht gjykoj se është një gje e pamundur ta studiosh taktiken kriminalistike të ndare vecmas nga rregullat që sanksionohen në kodin e procedurës . Vërtet rregullat taktike të manjës në pyetje të pandehurit apo dëshmitarit nuk janë konkretizuar në një ligj të veçantë dhe me to është marrë me tepër doktrina por ato janë thelbësore sepse duke zbatuar ato rezultati që merret është me produktiv dhe me i shpejtë. Në procesin e marrjes se dëshmise duhet të respektohen rregullat e meposhtme një pjese e të cilave janë rregulla proceduriale të parashikuara në kod ndersa pjesa tjeter janë rregulla të cilat i studion shkenca e kriminalistikes.

1. Dëshmitari pyetet për faktet objekt akuze.⁴⁴ Dëshmitari pyetet për faktet që perbejnë objekt provë.⁴⁵ Në vendet që aplikojnë sistemin common law cilësohet se dëshmitari duhet të dëshmojë vetëm për faktet për të cilat ka njohuri personale dhe që perbejnë objekt të akuzës. Behel fjale për rregullin 602.
2. Ai nuk mund të dëshmojë për qëndrimin moral të të pandehurit përveçse kur çështja ka të bëjë me fakte që vlejnë për percaktimin e personalitetit të tij në lidhje me veprën penale dhe me rrezikshmerinë shoqerore.⁴⁶
3. ⁴⁷Dëshmitari pyetet për mardhenien që ka me të pandehurin apo persona të tjere të permendur gjatë dëshmise. Në bazë të nenit 153 të KPrP pyetja e dëshmitarit mund të shtrihet edhe në marrëdhëniet e farefisnise dhe të interesave që ekzistojnë ndërmjet dëshmitarit dhe paleve apo dëshmitarëve të tjere si dhe mbi rrethanat, vërtetimi i të cilave është i nevojshëm për vlerësimin e besueshmerise se tij . Organi procedues për të zbardhur raportet mes këtyre subjekteve duhet të bazohet jo vetëm në thëniet e dëshmitarit por edhe në ato që thanë miqte, fqinjët, personat e aferm apo të tjere që e njohin atë.Kjo pike ka një rëndësi shume të madhe pasi dëshmitari që ka një mardhenie armiqesie me të

⁴⁴ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009

⁴⁵ Federal rules of evidence(For united states courts), West publishing company, St Paul 1993

⁴⁶ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009

⁴⁷ Po aty

pandehurin mund të beje një dëshmi të rreme dhe të deponojë për fakte që e fajesojnë të pandehurin.

4. Dëshmia mbi faktet që shërbejnë për të percaktuar personalitetin e të demtuarit nga vepra penale pranohet vetëm kur akuza e të pandehurit duhet të cmohet në raport me sjelljen e të demtuarit.⁴⁸
5. Dëshmitari pyetet për fakte të caktuara, ai nuk mund të deshmtojë për çfarë flitet në publik dhe as të shprehe vleresime personale me përjashtim të rasteve kur ato nuk mund të ndahen nga dëshmia për faktet.⁴⁹
6. Një element shume i rëndësishëm gjatë pyetjes se dëshmitari është manja e të dhënave mbi personalitetin e tij. Ky rregull i cili është një rregull taktik ka rëndësi për organin procedues për dy arsye:

Se pari marrja e të dhënave mbi personalitetin e tij ka një rëndësi të veçantë për vendosjen e kontaktit të duhur mes organit procedues dhe dëshmitarit.⁵⁰ Me vendosje të kontaktit psikologjik kuptohet krijimi i një mjedisi të mirë të qete dhe dashamirës për pyetjen e dëshmitarit. Sa me korrekt dhe i qete të jetë mjedisi aq me pranë të vërtetës do të jetë dëshmia. Kjo shërben për marrjen e një dëshmie që do të jetë me efektive në zbardhjen e të vërtetës. Ky është një rregull që vlen edhe për pyetjen e të pandehurit.

Së dyti marrja e të dhënave mbi personalitetin e të pandehurit organin procedues i shërben për të bere dallimin që qendron midis një dëshmie të rreme apo jo të plotë që dëshmitari e jep me vullnëtin e tij të plotë (në këtë rast ai mban përgjegjësi sipas dispozitave të kodit për një dëshmi jo të plotë apo të rreme) dhe asaj që ai e jep si rezultat i perceptimit të gabuar të faktit apo dukurise (perceptim që ndikohet edhe nga temperamentin e individit që jep dëshmi). Formimi i dëshmise apo thënieve që merren nga subjektet e tjera kalon në tri faza:

⁵¹Perceptimi i cili është procesi i pasqyrit në vetedijen tonë i sendit objektit apo dukurise në tërësi të cilat kanë një kontakt të drejteperdrejte me shqisat..Duhet të kemi parasysh që gjatë pyetjes të mbajme mend faktin që jo të gjithë njerëzit perceptojnë njëllë një dukuri. Perceptimi është një proces fiziologjik i cili varet edhe nga faktore të tjere sikurse është vëmendja dhe emocionët.Organi procedues duhet të jetë në dijeni të këtij fakti

⁴⁸ Po aty- neni 153

⁴⁹ Po aty

⁵⁰ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 415

⁵¹ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 405

sidomos nëse paraqitet perpara mundesisë për nisjen e një procedimi penal ndaj individeve që mendohet se kanë dhënë dëshmi të rreme apo kontradiktore Organi procedues në këtë rast duhet të vërtetojë që shkak i një dëshmie apo thënie të rreme nuk është ana subjektive pra vullnëti i individit për të deponuar një thënie të rreme, por është perceptimi i gabuar si rezultat i emocionit që mund të ketë pasur ky subjekt në momentin që ka perceptuar dukurinë apo në momentin që ka riprodhuar atë. Nëse do të duhet të zbatohet nenin 165 të kodit të procedurës autoriteti kompetent duhet të jetë i informuar për rregullat taktike. Të njëjtat fakte do të perserisja edhe për

Në literature trajtohen 4 lloje temperamentesh të cilat në fakt i trajton gjerësisht shkenca e psikologjisë (me vijim do të bëj një pershkrim të shkurtër të tyre gjithmonë në funksion të temës dhe mbrenda limiteve që më vendos ajo). Do të trajtoj llojet e temperamenteve si dhe predispozitat që ka një dëshmitar me një lloj të caktuar temperamentit për të dhënë një dëshmi sa më afër të vërtetës) pra sa ndikim ka temperamentit në perceptimin apo riprodhimin e faktit.

⁵²Temperamenti është një veti dhe cilësi me rëndësi psikike për individin, e cila manifestohet në reagimin e tij ndaj ngacmimeve dhe nxitjeve të ndryshme, të jashtme. Disa autore theksojnë se temperamentit është një veti psikike e personalitetit e cila ka të bëjë me reagimet e tij emocionale. Temperamenti nuk paraqet vetëm menyrat e reagimit psikik, ai nënkupton shpejtësinë dhe zgjatjen e reaksioneve të individit ndaj ngjarjeve dhe ngacmimeve, të ambientit. Përmenden disa klasifikime apo ndarje të tipave të ndryshëm të temperamentit. Klasifikimi më i njohur dhe më i vjetër i tipave të temperamentit është ajo e Hipokratit.

Temperamenti kolerik, si tip i individit, manifestohet me ndjenja dhe emocione intesive, me vendosjen e lartë për të ndermarrë aktivitet apo veprim. Ky tip i personalitetit shqetesohet shpejt, për gjëra të imta dhe të vogla bie në konflikt me individë dhe persona të tjerë.⁵³ Gjithashtu, këta tipa zemerohen dhe hidherohen shpejt. Crregullimi emocional të atë është i fuqishëm dhe zgjat shumë. Duke u nisur nga të dhënat mbi këtë personalitet jam e mendimit se ky tip dëshmitari nuk është i saktë në dënimin e dëshmise duke pasur parasysh faktin që këta persona janë të terhequr rezultati është që ata të mos i kushtojnë rëndësi asaj

⁵² Halili Ragip, Kriminologjia, "Universiteti i Prishtinës" Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2002

⁵³ Halili Ragip, Kriminologjia, "Universiteti i Prishtinës" Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2002

që ndodh perreth tyre rrjedhimisht nuk i perceptojnë mirë faktet.⁵⁴Temperamentet na intereson ti trajtojmë në kuadrin e marrjes së dëshmise nga dëshmitari apo të thënieve nga i pandehuri por edhe për një arsye tjetër. Duke parë temperamentin e subjektit që do të pyetet organi procedues nxjerre edhe konkluzione mbi faktin se sa është ndikuar gjatë deponimit të fakteve nga persona të tjera ky subjekt . Për shëmbull një individ me karakter flegamtik është me i prirur për të dhënë një dëshmi të vërtetë pa u ndikuar nga personat me të cilët ka kontakt.⁵⁵Pra e thënë ndryshe një dëshmitar me një prirje të tillë është me i vështirë për tu manipuluar.

7. ⁵⁶Ndaj dëshmitarit nuk mund të përdoren metoda e mjete që prekin lirinë e vullnëtit ose aftësinë e kujtesës për vlerësimin e fakteve si dhe nuk mund ti nënshtrohet torturës, denimit apo trajtimit cnjërezor.Kjo është një e drejtë kushtetuese që vlen për çdo qenie njerëzore dhe parashikohet shprehimisht nga neni 25 i kushtetutes.⁵⁷Në lidhje me ndalimin e dhunës Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ka aprovuar Konventën kundër torturës dhe veprimeve të tjera mizore, jo humanë dhe poshtëruese në vitin 1984.

⁵⁸Sado që vërtetimi i gjendjes faktike ka një rëndësi shumë të madhe kjo nuk mund të arrihet me çdo mjet provë. Përdorimi i mjeteve teknike për zbulimin e veprave penale duhet të jetë human, të mos vëre në pikepyetje dinjitetin njerëzor as integritetin e njeriut edhe nëse çmimi është të mos zbulohet e vërteta. Kërkohej një kujdes mjaft i madh përdorimin e narkoanalizës që synon të zbulojë reagime intime psikologjike të dëshmitarit apo përdorimi i mjeteve që shërbejnë për zbulimin e reagimeve biologjike sikurse është "lie detector".

8. ⁵⁹Dëshmitari nuk mundet të detyrohet të dëshmojë për fakte që mund të lindin përgjegjësi penale për të. Edhe kjo është një e drejtë kushtetuese. Neni 32 i Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë shprehet qartë që askush nuk mund të dëshmojë kundër vetvetes apo familjes së vet dhe as të detyrohet të pranojë fajësinë.⁶⁰Është vetëm gjykata ajo që vendos që dëshmitari të mos përgjigjet për pyetje

⁵⁴ Po aty

⁵⁵ Po aty

⁵⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998, Tiranë 2008, neni 25

⁵⁷ Dr. Sahiti Ejup "Argumentimi në procedurën penale, Prishtinë 1999

⁵⁸ Sahiti Ejup "Argumentimi në procedurën penale, Prishtinë 1999

⁵⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998, Tiranë 2008, neni 32

⁶⁰ Ibi Sokol, "Për provat", Revista nr.64 "Tribuna juridike" Fondacioni për kulturë juridike, Tiranë 2007

të caktuara nga përgjigja e të cilave për dëshmitarin mund të iniciohet përgjegjësia penale.

9. Dëshmitari merret në pyetje fillimisht nga pala që e ka kërkuar. Bazuar në nenin 359 të kodit të procedurës penale hetimi gjyqësor fillon me marrjen e provave të kërkuara nga prokurori ose i demtuari akuzues dhe vazhdon me marrjen e atyre që kërkohen nga i pandehuri, mbrojtësi dhe palet e tjera. Kjo në fakt është një dispozite e përgjithëshme e cila flet për radhën e marrjes së provave në tërësi është neni 361 ai që edhe me specifik në lidhje me dëshminë si provë. Neni 361 i kodit saktëson se pyetja e dëshmitarëve behet fillimisht nga prokurori ose nga mbrojtësi a perfaqësuesi që ka kërkuar pyeljen. Me pas pyetja vazhdon nga palet, sipas radhës. Kush ka kërkuar pyetjen mund të beje pyetje edhe mbasi mbarojnë palet e tjera.

10. ⁶¹Ndalohen pyetje që ndikojnë në paanësinë e dëshmitarit

11. ⁶²Ndalohen pyetjet që synojnë sygjërimin e përgjigjeve, pyetje me karakter sygjestionues, të cilat kanë një efekt negativ të dëshmitari sepse e venë atë në një pozite të vështirë emocionale, madje ndikojnë në mënyrë indirekte në psikologjinë e tij.

⁶³Keto pyetje ndonjëherë synojnë të hutojnë dëshmitarin.(rrjedhimisht efektet e mesiperme mund të sjellin edhe ndryshim të realitetit)Përgjigjet që perfitohen nga pyetjet sygjestionuese sipas Lipmanit ndahen në tri grupe:

- Në grupin e parë janë përgjigje që nuk burojnë perkunder dijes për faktet.
- Në grupin e dytë janë përgjigje që vijnë si rezultat i qëndrimeve të ashpra të pyetesit
- Në grupin e tretë janë përgjigjet e cilat kanë sjelle protesta të brendshme dhe kundervenie me thëniet e veta ndaj pyetesit.

Për mënyrën se si mund të ndikoj një pyetje sygjestionuese në shtremberimin e fakteve dhe ndryshimin e realitetit po jap një shëmbull konkret. Një dëshmitar ka parë të kryente një veper penale një person pa flokë. Organi procedues i bën një pyetje të tillë: "personi që ju pate i kishte floket me ngjyre të verdhe apo të zeze?" Në këtë rast kemi të bëjmë me një pyetje me karakter sygjestionues pasi dëshmitari mund nga gjendja emocionale e krijuar të pranoje një nga të dhënat e mesiperme të cilat ndryshojnë në një mënyrë 360 grade nga realiteti pasi personi që ka parë ai nuk kishte fare floke.

⁶¹ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009, neni 361 pika 3

⁶² Po aty

⁶³ Sahiti Ejup "Argumentimi në procedurën penale, Prishtinë 1999, faqe 130-131

12. Nëse dëshmitari për shkaqe të ndryshme nuk mund të paraqitet në vendin që është percaktuar në ftesën për pyetje atëherë gjykata mund të vendosë që pyetja e dëshmitarit të bëhet në vendin ku ndodhet ai, vetëm nga një anëtar i trupit gjykues, në prani të paleve. Procesi i pyetjes zhvillohet në prani të paleve. Një rast i tillë është rasti kur dëshmitari është i shtruar në spital dhe me urdher të mjekut nuk mund të levizë nga shtrati. Në këtë rast organi procedues do të zhvillojë pyetjet në ambjentet spitalore por duke respektuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për pyetjen e tij

13.⁶⁴ Kur dëshmitari pyetet në seance gjyqësore roli i gjykatës nuk është tërësisht pasiv në pyetjen e tij megjithëse me siper sqaruar që e drejta e provës i rezervohet paleve. Ky rol aktiv evidentohet në faktin që gjatë pyetjes së dëshmitarit kryetari mund të bëjë pyetje dhe, kur është rasti, nderhyn për të siguruar radhën e pyetjeve, vërtetësinë e përgjigjeve, saktësinë e pyetjeve dhe të kundërshtimeve, si dhe garanton respektimin e personit.

14. Palet mund të përdorin thëniet e bera me pare nga dëshmitari para prokurorit ose policisë gjyqësore

- për të kundërshtuar, tërësisht ose pjesërisht, përmbajtjen e dëshmive ose,
- kur refuzon të dëshmojë.

Kushti i vetëm që të përdoren thëniet e mëparshme në rastet e mësipërme është që në deklaratimet e mëparshme dëshmitari të këtë deponuar për faktet që kundërshtohen. Thëniet që dëshmitari ka deponuar përpara prokurorit apo oficerit të policisë gjyqësore nuk përbejnë provë në vetvete për faktet që pohohen në to, por ato mund të vlerësohen nga gjykata për të percaktuar nëse dëshmitari është i besueshëm apo jo.

Por ligji është tolerant në këtë pikë ai i jep mundësinë organit procedues t' i përdorë keto thënie si provë,

- Nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre. Deklarimet e mëparshme, të përfshira në fashikullin e gjykimit, sipas pikës 2 të këtij neni, cmohen si prova
- Kur rezulton se dëshmitari qofte edhe gjatë pyetjes në seance i nënshtrohet dhunës, kanosjes, premtimit për t' i dhënë para ose përfitime të tjera, me qëllim që të mos dëshmojë ose të bëjë dëshmi të rreme,

⁶⁴ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009, neni 361 pika 6

- Kur rezultojnë rrethana të tjera që kanë demtuar sinqeritetin e përgjigjeve të tij. Mund të shërbejnë si provë edhe leximet e deklarimeve të bera në fazën e hetimeve paraprake nëse dëshmitari për shkaqe objektive e ka të pamundur të paraqitet.

1.2 Cilet janë subjektet që mund të pyeten si dëshmitarë?

⁶⁵ Është vete kodi ai që ka bërë një përcaktim në nenin 155 të tij . Në bazë të këtij neni cdo person ka zotësi për të dëshmuar me përjashtim të atyre që për shkak të të metave mendore ose fizike nuk janë në gjendje të dëshmojnë.

Kur për vlerësimin e thënieve është i nevojshëm verifikimi i aftësive fizike ose mendore për të bërë dëshmi gjykata edhe kryesisht mund të urdherojë verifikimet perkatese.

Por sic mund të shikohet dispozita në këtë rast është shumë e përgjithshme ajo shprehet pa përcaktuar taksativisht personat që mund të dëshmojnë. Prandaj për të kuptuar me mirë rrethin e personave që mund të japin një dëshmi do të bazohem në një prej rregullave logjike me eficente sikurse është induksioni (kalimi nga e vecanta në të përgjithshmen) .E thënë ndryshe do të nisem nga një trajtim që ndryshon tërësisht me atë që bën kodi. Kodi trajton me përpara në kohë rrethin e personave të cilet kanë aftësi për të dëshmuar e që duhet të dëshmojnë. Në gjykimin tim duhet të nisemi nga trajtimi i personave të cilet nuk mund të pyeten si dëshmitarë (të cilat ligji parashikon qarte në nenin 156) pastaj në bazë të rregullave logjike cdo person i cili nuk përmendet nga ky nën mund të pyetet si dëshmitarë . Personat që do të përmend me poshtë janë të papajtueshëm me detyrën e dëshmitarit. ⁶⁶Aftësia për të dëshmuar e trajtuar nga neni 155 dhe papajtueshmëria me detyrën e dëshmitarit që trajtohet nga neni 156 përbejnë atë që quhet profili subjektiv i dëshmisë.

⁶⁷Nuk mund të pyeten dëshmitarë:

1. Personat që, për shkak të metash fizike apo psikike , nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt
2. Të pandehurit në një veper penale të përbashkët ose në një procedim të lidhur edhe kur ndaj tyre është dhënë vendimi i mosfillimit të çështjes, i pafajësisë ose denimit me

⁶⁵ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009, nenet 155,156,158

⁶⁶ Imeraj Elizabeta,"Provat në procesin penal", Tiranë 2008

⁶⁷ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009, nenet 156

përrjashtim të rastit kur vendimi i pafajesisë ka marrë formë të prerë.⁶⁸Në një vendim të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë ajo argumenton se, procesverbalet e procedimeve të mbajtura gjatë shqyrtimit të procedimeve të tjera(të cilat kanë përfunduar) përbejnë provë, si të gjithë provat e tjera, për një procedim tjetër të mëpasem, qoftë ai edhe procedim i lidhur me të parin. Kështu që, gjatë rigjyqimit të çështjes, gjykata duhet të administrojë si prova, duke i vlerësuar në unitet me provat e tjera, si procesverbalet e seancave gjyqësore të mbajtura gjatë shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë dhe të apelit.

3. Ata që në të njëjtin, procedim kryejnë ose kanë kryer funksionin e gjyqtarit apo prokurorit.⁶⁹Në ligjet federale të shba-ve në rregullin 605 theksohet se Gjyqtari që merr pjesë në një gjykim nuk mund të dëshmojë si dëshmitarë në po atë gjykim. Nuk lejohet asnjë përrjashtim nga ky rregull.

4. I padituri civil

Por në kod parashikohet dhe një grup i trete individesh të cilët janë persona që kanë zotësi për të dëshmuar pra mund të pyeten si dëshmitarë por nuk e kanë një detyrim ligjor një gjë të tillë .Nuk mund të detyrohen të dëshmojnë në bazë të neni I 58 të kodit:

- Gjinia ose krushqia e afert e të pandehurit sipas përcaktimeve të nenit me përrjashtim të rasteve kur kanë bërë kalëzim apo ankim apo kur njëri nga ata apo një i afërm i tyre janë të demtuar nga vepra penale.⁷⁰E drejta e shëriatit shkon me tej duke e cilësuar si tradhëti dëshminë e dhënë për një person të afërt.⁷¹Këta persona nuk e kanë një detyrim të tillë ligjor dhe kjo mbështët në arsyet humanë ndaj ndjenjave të personave të afërme. Me një zgjidhje të kësille synohet të mënjanohet situata e rëndë psikologjike që krijohet të dëshmitari i afërm i të pandehurit.
- Nuk mund të detyrohet të dëshmojë bashkëshorti për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë gjithë jetës bashkëshortore
- Bashkëshorti i ndarë nga i pandehuri
- Ai që edhe pse nuk është bashkëshort i të pandehurit ka bashkëjetuar apo bashkëjeton me atë.
- Ai që është lidhur me të pandehurin me një marrëdhënie biësimi.

⁶⁸ Vendimi Nr 52, Datë 25.01.2006 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

⁶⁹ Federal rules of evidence(For united states courts), West publishing company, St Paul 1993

⁷⁰ Sahiti Ejup "Argumentimi në proçeduren penale, Prishtinë 1999, faqe 82

⁷¹ Sahiti Ejup "Dëshmia e dëshmitarit si provë në proçesin penal", Prishtinë 1993, faqe 83

Në këtë rast legjislatori është treguar i kujdesshëm dhe ju a le në dorë vete personave të mesiperm të pranojnë ose jo të pyeten. Pra ata nuk kanë detyrim ligjor të japin dëshmi dhe për njëdhije mbi ta nuk rendon sanksioni që ka parashikuar ligji ynë për personat që refuzojnë të deshmojnë. Këtë të drejtë që kanë keto subjekte e parashikon edhe ligji në nenin 158 pika 2 sipas të cilit gjykata u bën të njohur personave të mesiperm të drejten për të mos deshmuar dhe i pyet ata nëse duan të perfitojnë nga kjo e drejtë. Kodi ynë parashikon në mënyrë eksplicite nëse gjykata i pyet keta persona pa i venë atyre në dijeni faktin që nuk janë të detyruar të deshmojnë, dëshmia që ata japin nuk është e vlefshme.

⁷²Si dëshmitarë mund të pyeten edhe punonjësit e infiltruar të policisë.

Në lidhje me mundësinë e punonjësve të infiltruar të policisë për të deshmuar ⁷³GJEDNJ në çështjen Taixera kunder Portugalise është shprehur se përdorimi i agjenteve sekrete duhet të kufizohet dhe duhet të krijohen garancite e duhura megjithëse mund të kemi të bëjmë me luftën kunder drogës. Interësi publik i luftës kunder trafikut të drogës nuk mund të justifikojë përdorimin e provave të perfituara si rezultat i provokimeve të punonjësve të infiltruar të policisë. Policet nuk u kufizuan në hetimin e kapacitetit kriminal të kërkuesve në mënyrë pasive por ushtruan influencën e tyre për kryerjen e veprës penale. Pra në këtë rast deklaratimet e dy policëve s'mund të shërbejnë si provë rrjedhimisht vendimi i gjykatës se Portugalise ka shkelur neni 6 të KEDNJ.

Po të bëjmë një analizë të ligjeve federale të SHBA-se mund të them se sistemi common law nuk është kaq i perpiktë në subjektet që përjashtohen nga detyrimi për të deshmuar. ⁷⁴Edhe në ligjet federale të Shba-ve theksohet se cdo person ka kompetencën për të qenë dëshmitarë me përjashtim të personave që vete ligji i ndalon. Behet fjale për nenin me numer 601, janë të përjashtuar nga aftësia për të deshmuar personat e denuar, ata që kanë braktisur besimin fetar dhe ata që kanë një interes në konflikt ose bashkëshorte të personit të interesuar, por nuk mund të jenë dëshmitarë edhe persona të paafte menderisht.

1.3 Cilat janë detyrimet e dëshmitarit në bazë të kodit të procedurës penale

⁷² Ligji nr. 7830 datë 25.06.1994 "Për autopsinë" në R.SH

⁷³ Ibi Sokol, "Për provat", Revista nr.64 "Tribuna juridike" Fondacioni për kulturë juridike, Tiranë 2007, fq 49-55

⁷⁴ Federal rules of evidence(For united states courts), West publishing company, St Paul 1993, faqe 60

Dëshmitari është i detyruar të:

⁷⁵1-paraqitet në gjykatë si dëshmitar për këtë gjykata i dergon një fletethirrje ku përcakton vendin, orën, ditën e sakte të paraqitjes .Si rregull dëshmitari duhet të paraqitet në vendin ditën, dhe orën e caktuar(organi procedues në bazë të nenit 164 të KPrP mund të urdherojë shoqërimin e detyrueshëm të dëshmitarit, shoqërimi i cili nuk mund të zgjase me tepër se 24 ore.

Nga një interpretim i nenit të mësipërm rezulton që dëshmitari duhet të pyetet në një vend që e përcakton vete organi procedues por nga rregulli gjithmonë ka dhe përjashtime të cilat sanksionohen në nenin 162 dhe 163 të Kodit të Proçedurës Penale. Në dispozitat e mesiperme cilësohet që në rastin e dëshmise se presidentit të vendit ajo merret atje ku presidenti ushtron detyren si kryetar shteti.Totalisht ndryshe paraqitet situata për kryetarin e kuvendit , kryetari keshillit të ministrave dhe kryetarin të gjykatës kushtetuese dhe të gjykatës së lartë, keta të fundit mund të kërkojnë të pyeten në selinë ku ushtrojnë detyren. Pra si rregull për ta aplikohet pyetja në vendin që cakton organi procedues vetëm me kërkesën e tyre ata mund të pyeten në selinë ku ushtrojnë funksionin (pra do ta konsideroja një privilegj që nuk ekziston automatikisht nga cilësia e tyre si funksionare të lartë por është një privilegj që keta të fundit e gëzojnë vetëm me kërkesën e tyre)

⁷⁶2- Të deshmojë pra ka detyrimin t'u përbahet urdherave të gjykatës.

3- Të thotë të vërtetën. Ligji federal i SHBA-ve ka përcaktuar se ⁷⁷perpara se të deshmojë dëshmitari duhet të deklarojë se do të deklarojë vetëm të vërtetën nën betim. Si garanci të pikes se trete kodi përcakton në një dispozite me vete të tij sanksionin në rast se dëshmitari nuk thotë të vërtetë . Në kod parashikohet se pasi bën identifikimin e dëshmitarit sekretari i gjykatës lexon deklaratën e betimit të dëshmitarit:" Betohem se do të them të vërtetën,të gjithë të vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë.dëshmi Pas kësaj dëshmitari deklaron "betohem" dhe tregon gjenëralitetin e tij.Sikur është përmendur dhe pak më sipër në mbështetje të nenit ⁷⁸165 të KPrP: "Në rast se bën dëshmi që përmban thënie kontradiktore, jo të plota ose që janë në kundërshtim me provat e marra, ose nëse kundërshton të deshmojë dëshmitari mban përgjegjësi".

⁷⁵ Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009, nenet 162,163

⁷⁶ Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009

⁷⁷ Federal rules of evidence(For united states courts), West publishing company, St Paul 1993, faqe 63

⁷⁸ Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009, neni 165

1.4 Nënpunësit diplomatike si dëshmitarë

Është specifik dhe i rëndësishëm për t'u evidentuar rasti i nënpunësve diplomatike.⁷⁹ Nënpunësit diplomatike janë funksionare të akredituar në shtetin prites (janë perfaqesues *alter ego* të drejteperdrejte të kryetarit të shtetit dergues dhe të vete shtetit dergues në shtetin, në të cilin vete nënpunësi ka dorezuar letrat kredenciale e është akredituar). E drejta nderkombetare publike në trajtimin që bën për diplomatet i ndan ata në ambasadore dhe legatë të cilet janë perfaqesues të shtetit të tyre në cdo fushe si dhe në konsuj të cilet kryejnë veprimtarinë e tyre kryesisht në fusha tregtare .Çështja e dhenies se dëshmise të ketyre subjekteve është trajtuar nga ⁸⁰konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike sipas se cilës «Agjenti diplomatike nuk është i detyruar të deshmojë » ⁸¹Me nocion agjent diplomatik nënkuptohet shefi i misionit ose antaret e trupit diplomatik të cilet kanë cilësi diplomatike. Për ambasadoret duhet të theksojme që ata kanë imunitet juridik i cili në vetvete perfshin edhe faktin që ata nuk mund të detyrohen të pyeten si dëshmitarë, në rast se ata japin pelqimin për një gje të tillë neni 163 K.PrP kërkon që në këtë rast kërkesa për marrjen në pyetje të kalojë nëpërmjet ministrisë së drejtesisë, organit diplomatik apo konsullor. Në rastin e konsujve për ata ekziston një parashikim ligjor i ndryshëm sepse mund t'iu merren dëshmi por në ftesen që i behet për paraqitje për pyetje në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën përdoret një fjalor i veçantë mirësjelljeje si dhe nuk duhet t'i vihet në dukje përgjegjësia ligjore që do të mbaje ai në mbështetjeje të nenit 165 të KPrP në rast se bën dëshmi që permban thënie kontradiktore, jo të plota ose që janë në kundërshtim me provat e marra, ose nëse kundërshton të deshmojë. ⁸²Konsujt nuk janë të obliguar të deshmojnë për fakte të cilat kanë të bejnë me ushtrimin e funksionëve të tyre

1.5 Parashikimet që percakton e drejta europianë në lidhje me këtë lloj provë

⁸³Sipas nenit 6 të Konventesës Europianë për të Drejtat e Njeriut cdo i akuzuar mund të pyes ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të kërkojë të thirren në

⁷⁹ Puto Arben,"E drejta nderkombetare publike", Botimet Dudaj, Tiranë 2010, faqe 410 dhe 420

⁸⁰ Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike 1963, neni 31/2

⁸¹ Sahiti Ejup "Dëshmia e dëshmitarit si provë në procesin penal" , Prishtinë 1993, faqe 91

⁸² Sahiti Ejup "Dëshmia e dëshmitarit si provë në procesin penal" , Prishtinë 1993, faqe 92

⁸³ Konventa Europianë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07. 1996

kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës dhe dëshmitarët e mbrojtjes. Qëllimi i dispozites është që personi në procedim të jetë në situatë të barabartë me prokurorinë. Në lidhje me këtë çështje mund të themi që legjislacioni ynë me saktë Kodi i Procedurës Penale mban të njëjtin qëndrim që mban edhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ky është një konkluzion në të cilin do të arrihej vetëm duke u bazuar në një llogjikë të thjeshtë që Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut është adoptuar nga sistemi ligjor shqiptar që në vitin 1995. Jo vetëm që është adoptuar nga sistemi ligjor shqiptar por asaj i është rezervuar një vend i veçantë në hierarkinë e normave bazuar në nenin⁸⁴ 116 të kushtetutes. Në bazë të këtij neni Konventa ka të njëjtën hierki me Kushtetutën e Shqipërisë dhe ka epersi ndaj ligjeve, rrjedhimisht të gjitha dispozitat e ligjeve në përgjithësi dhe kodi i procedurës penale në vecanti duhet të jenë në përputhje me dispozitat që sanksionon konventa. Qëndrimi që mban ligji ynë në lidhje me këtë çështje është i pritshëm edhe për vete faktin që për hartimin e kodit të procedurës penale shqiptare kanë shërbyer si model normat juridike e ligji procedural penal Italian i cili rezultonte kodi me i ri i Europës perendimore. Legjislacioni Italian është shumë i kujdesshëm në adoptimin e konventave dhe respektimin e dispozitave që permirësojnë legjislacionin. Jo me kot bera këtë parantezë, por për të theksuar faktin që edhe ligji ynë mban të njëjtin qëndrim persa i perket të drejtës që ka cdo i akuzuar për të pyetur ose të kërkoj të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të kërkoj të thirren në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës dhe dëshmitarët e mbrojtjes. KPrP perkrah nenin 6 të konventes. Për më tepër⁸⁵ ligji ynë perkrah rolin aktiv të të akuzuarit, një rolë shprehet qartë në të drejtat që i garantohen atij. Të drejta që permenden në tri pikat në

- E drejta që ka cdo i akuzuar mund të pyes ose të kërkoj të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të kërkoj të thirren në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës dhe dëshmitarët e mbrojtjes.

E drejta e të pandehurit për të marrë në pyetje dëshmitarët e akuzës është një e drejtë substanciale e cila është perkrahur edhe nga shume vendime të gjykatës europiane të drejtave të njeriut e cila ndodhet në Strasburg⁸⁶. Kështu në një vendim të datës 5 dhjetor 2002 Craxi kunder Italisë gjykata e thekson edhe njëherë rëndësinë që ka e drejta e të akuzuarit që cdo provë materiale kunder tij të shqyrtohet në procedura

⁸⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998, Tiranë 2008

⁸⁵ Imeraj Elizabeta, "Provat në procesin penal", Tiranë 2008

⁸⁶ Bianku Ledi "Jurisprudenca e gjykatës së Strasburgut" Edlora, Tiranë 2005, faqe 400-414

kontradiktorialiteti. Duke u mbështetur në nenin 6 të konventes kërkuesi ankohej për pabarazinë e procedimit penal ndaj tij. Ai pretendonte se nuk kishte patur kohe dhe lehtësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij dhe se nuk kishte qenë në gjendje t'u bente pyetje dëshmitarëve të akuzës ose t'u kunderpërgjigjej atyre. Ai pretendonte gjithashtu se fushata mediatike kundër tij i kishte ndikuar gjyqtaret në percaktimin e akuzave që ishin bërë. I njëjti argumentim i gjykatës është përdorur edhe në një sere çështjesh të tjera sikurse është çështja Van Mechelen dhe të tjera kundër Hollandes, Luca kundër Italisë, Solakov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

- E drejta që ka i akuzuari për të pasur pranë në çdo fazë të procesit gjyqësor avokatin e zgjedhur prej tij ose të caktuar kryesisht
- E drejta që percaktohet në kod për të pandehurin për të pasur të njëjtat mjete që ka pala e akuzës (ketu përfshihet dhe e drejta për të pasur një mbrojtje ligjore profesionale e cila sigurohet nga një avokat).

Mjaft interesante është të trajtojmë dallimin që qendron në perkufizimin që i jep ligji i brendshëm dhe ai që i jep GJEDNJ gjykata europianë e të drejtave të njeriut konceptit "dëshmitar".

⁸⁷Në ligjin nr 9205 datë 15.02.2004 "për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë" të Republikës së Shqipërisë në nenin 2 të ligjit citohet se dëshmitari i drejtësisë është personi ndaj të cilit zbatohen masa të vecanta mbrojtjeje i cili në cilësinë e dëshmitarit apo personit të demtuar bën njoftime apo deshmon për fakte apo rrethana që perbejnë objekt provë në një procedim penal dhe për shkak të ketyre njoftimeve apo thënieve ndodhet në një gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz. Ky është perkufizimi i dëshmitarit të drejtësisë i cili gezon mbrojtje të posaçme. Por jo gjithmonë një dëshmitar gezon statusin e dëshmitarit të drejtësisë. Ky status gezohej vetëm atëherë kur ndjehet prania e një rreziku real, konkret dhe serioz. ⁸⁸Dëshmitari i zakonshëm ose me mirë me lejoni ta quaj dëshmitari i thjeshtë është personi i cili ka marrë dijeni për:

- Veprën e ndodhur ose për autorin e saj
- Për pasojat e ardhura
- Mënyrën e kryerjes së veprës dhe për rrethana të tjera.

⁸⁷ Ligji nr. 9205 datë 15.02.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë", neni 2

⁸⁸ Elezi Ferdinand, "Provat penale" Tiranë 2008

Dëshmitari mund të jetë në dijeni të të dhënave të siperpermendura ose për shkak të perceptimit që i ka bërë vetë ngjarjes ose për shkak të të dhënave që ka marrë nga persona të tjerë.

Ai mund të jetë në dijeni të të dhënave të siperpermendura ose në shkak të perceptimit që i ka bërë vetë ngjarjes kur është ndodhur në vendngjarje në momentin që ka ndodhur vepra.⁸⁹ Prania në vendngjarje mund të jetë për tri faktore:

1. Për shkaqe jetese. Në këtë rast dëshmitari duhet të japë thënie të detajuara për shkak se prezumohet se e njëh mirë zonën ku ka ndodhur vepra penale.
2. Për shkaqe punë në këtë rast organi procedues duhet të përqendrohet në pyetjen e atyre detajeve që dëshmitari mendohet t'i këtë perceptuar me mirë si rezultat i shprehive profesionale.
3. Për shkaqe rastesore

Dëshmitari i thjeshtë është personi që bën njoftime apo deshmon për fakte apo rrethana që perbejnë objekt provë në një procedim penal. Mbi këtë lloj dëshmitari GJEDNJ ka rezervuar një hapsirë me të gjere të personave që do të gëzojnë këtë status.⁹⁰ Gjykata europianë e të drejtave të njeriut e ka interpretuar në mënyrë autonome nga legjislacionët e mbrendshme konceptin dëshmitar. Gjykata është shprehur se kur përdoret termi dëshmitar nuk bëhet fjale vetëm për personin që bën njoftime apo deshmon për fakte apo rrethana që perbejnë objekt provë në një procedim penal, persona që relatojnë përpara policisë apo drejtësisë atë që kanë parë apo degjuar. Për GJEDNJ "dëshmitar" mund të jenë edhe personi i infiltruar në një strukturë trafikantesh droge, eksperti, vetë pala civile e madje dhe një i pandehur. Përkishtë këtu qëndron diferenca me legjislacionin tonë i cili i përdor thëniet e personave të mesipër si provë por vetë këta persona nuk kanë statusin e dëshmitarit. Nëse do t'u referohemi dispozitave që ka parashikuar vetë kodi për pyetjen e eksperteve apo personave të infiltruar përcaktohet që edhe për ta zbatohen të njëjta rregulla që zbatohen për dëshmitarët, por kodi thekson se do të zbatohen këto dispozita për sa kohë që një gjë e tillë është e mundur. Megjithatë një trajtim të hollësishëm në lidhje me këtë çështje do ta bëjë në vijim të temës. Për sa i përket të pandehurit dhe të paditurit civil në nenin 166 theksohet që i pandehuri dhe i padituri civil pyeten vetëm kur ata e kërkojnë një gjë të tillë ose kur japin pelqimin për një gjë të tillë. Vetë fakti që pyetja e tyre cilësohet

⁸⁹ Po aty

⁹⁰ Pradel Jean, Cortesen Geert, Vermeulen Gert, "E drejta penale europianë", Botimet Papirus, 2010, faqe 384

në kodin tonë procedural si një lloj e veçantë provë, i jep subjekteve të mesiperme një status të ndryshe nga ai i dëshmitarit.

⁹¹**1.5.1 Rasti i dëshmitarëve "të zakonshëm"**

Behel fjale për ata dëshmitarë që i kanë pare faktet dhe pranojnë të deponojnë me kontakt vizual. Keta dëshmitarë do të thirren në seance dhe do të pyeten normalisht. Thirrja dhe marrja në pyetje janë të rëndësishme sepse në rast dyshimi gjyqtari nuk mund të deklaroj fajtor të pandehurin pa degjuar me pare dëshmitarët e tij. Ndjekja e procedurave të tilla para gjykatave kombetare ka bere që shume çështje të drejtohen drejt GJEDNJ, pershëmbull në çështjen Luca vs Italy të dates 27.02.2001 çështja i kaloi gjykatës europiane pasi gjyqtaret kombetare e kishin bazuar denimin në deklaratën e një personi të vetëm që i akuzuari nuk kishte arritur ta pyeste. Në nenin 6/3d të KEDNJ theksohet se në përgjithësi dëshmitarët duhet të deponojnë në seance, nëse kjo nuk atehere i akuzuari duhet të këtë pyetur apo të kate pasur mundesinë të pyeste dëshmitarët gjatë fazës hetimore..

Megjithatë çdo kërkesë për thirrjen e një dëshmitari nuk do të pranohet automatikisht nga gjykata, e cila ka kompetencë të vendosë nëse duhet apo jo të degjohet një dëshmitar, me rezervën që në tërësinë e saj procedura të këtë një karakter të rregullt ligjor. Në raste të jashtezakonshme gjykata pranon që i akuzuari të mos këtë mundesinë të kërkojë të merret në pyetje një dëshmitar i akuzës kryesisht për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarit. Bëhet fjalë për të shmangur perballjen e një dëshmitari me një të akuzuar të të njëjtes familje, për të mos e venë në vështirësi ose për të menaxhuar viktimën e mitur të abuzimeve seksuale. Të akuzuarit do t'i refuzohet e drejta për të pyetur një dëshmitar edhe kur lokalizimi i tij rezulton i pamundur.

1.5.2 Rasti i dëshmitarëve anonime

⁹²Në këtë rast dëshmitari kërkon të deshmojë me kusht që identiteti i tij të mos behet i ditur. Kryesisht një problem i tillë shfaqet në rastin e krimeve të renda, në çështjet e vrasjeve me dashje si dhe të organizatave kriminale.

⁹¹ Pradel Jean, Cortesen Geert, Vermeulen Gert, "E drejta penale europiane", Botimet Papirus, 2010, faqe 384

⁹² Pradel Jean, Cortesen Geert, Vermeulen Gert, "E drejta penale europiane", Botimet Papirus, 2010, faqe 385-389

Dilema që ekziston në keto raste është kjo : të deshrnosh me fytyrë të zbuluar por duke rrezikuar hakmarrjen apo të deshmosh duke ruajtur në një fare mënyrë anonimin duke i shpetuar hakmarrjes por duke cenuar parimin e kontradiktorialitetit. (Sepse në këtë rast mbrojtja nuk mund të pyes këtë dëshmitar). Vendime të shumta janë dhënë nga GJEDNJ në lidhje me këtë lloj dëshmie por vendimi i parë ka qenë ai i vitit 1989 në çështjen Kostovski. Sipas këtij vendimi elementet e provës duhet të sillen para të akuzuarit në seance publike me qëllim debatin kontradiktor. Megjithatë jo gjithmonë deklarata e dëshmitarit do të behet në sallën e gjyqit për të marrë vlerën e dëshmive si provë.

Një kategori të veçantë të dëshmitarëve anonime perbejnë agjentët e infiltruar. Sipas GJEDNJ, thëniet e tyre kanë vlerën e dëshmive, pra janë një lloj i veçantë dëshmie. Në lidhje me këtë çështje ka disa vendime. Çështja e parë që do të përmend është ⁹³saidi vs france 20.09.1993 subjekti i sipërpermendur saidi ishte i njohur si shperndares heroinë nga tre toksimanë me të cilët ai ishte përballur me një xham pasqyre, i interesuari u denua nga drejtësia franceze , nderkohe që kishte kërkuar të përballej me personat që e njohën. Sipas GJEDNJ procedura e cila bazohet vetëm në të tilla deshrni, një vendim i dhënë vetëm mbi baza të një dëshmie anonime nuk është në përputhje me nenin 6 të KEDNJ. Gjykata europianë e të drejtave të njeriut thekson se gjatë marrjes së dëshmive anonime gjyqtari duhet të nderhyjë për të verifikuar besueshmerinë e dëshmitarëve.

Pavaresisht se në një sere vendimesh tendenca e gjykatës ka qenë të menjanojë përdorimin e dëshmive anonime, po të analizojmë në tërësi jurisprudencën e strasburgut do të thojë që përdorimi i teknikes së dëshmive anonime është i ligjshëm me kusht që të respektohen me se miri disa rregulla që i parashikon vendimi Doorson:

- Kushti i parë lidhet me parimin e kontradiktorialitetit , pra i akuzuari të kishte mundësinë një mënyrë apo në një tjetër të pyeste në një moment të dhënë dëshmitarët e akuzës gofite edhe në mënyrë të tillë që të mos këtë kontakt vizual me të
- Në rastin e marrjes së dëshmive nga persona të infiltruar duhet të kemi parasysh faktin që nuk mund të përdoret asnjë mjet që përdoret për marrjen e një provë nëse cenohet neni 8 i Konventës Europianë e të Drejtave të Njeriut.

Por megjithatë infiltrimi bie ndesh me nenin 8 respektimin e jetës private, ajo është një

⁹³ Po aty- faqe 389

teknike e ligjshme sepse vete neni 8 pranon që mund të cenohet intimiteti me kusht që një veprim i tille të parashikohet nga një ligj i brendshëm dhe të behet fjale për mbrojtjen e rendit publik.

Një rast tjetër dëshmie është dëshmia që jep një person për fakte të cilat nuk i ka perceptuar vete ai por është venë në dijeni nga një person i trete. Në këtë rast i pandehuri e ka të pamundur të pyese vete personin që ka perceptuar faktin por mund të pyese vetëm ate që do të paraqitet në seance.

Ashtu sikurse parashikon dhe kodi ynë edhe në jurisprudencen e strasburgut është evidentuar edhe një lloj tjetër dëshmie ajo që jepet nga dëshmitarë që refuzojnë të tregojnë burimin për të ruajtur sekretin profesional pershëmbull rasti i gazetareve që nuk duan të zbulojnë burimet e tyre, edhe nëse keta të fundit po kërkohen nga drejtësia. Në vendimin e dates 27.03.1996 goodein c/Royaume-Uni një gazetar kishte një artikull rob gjendjen e një ndermarjeje e cila nga ana e saj e kishte cuar çështjen në gjykatë ku kërkonte që gazetari të tregonte burimin e informacionit të tij duke qenë se ajo ishte e frikesuar nga pasojat e mevonshme që mund të vinin. Gjykata e denoi gazetarin me gjobe për roosperfillje të gjykatës (duke qenë se ai refuzoi të tregonte burimin e informacionit).

1.6 I mituri si dëshmitar në një proçes penal

Dëshmitari ndosh të jetë personi në moshe madhore por edhe i mituri. Të miturin do ta cilësoja si një dëshmitar "sui genëris" për vete faktin se për marrjen e dëshmise se tij organi procedues duhet të jetë mjaft i kujdesshëm në respektimin e një mori rregullash proçedurale dhe taktike të cilat i kushtohen ekskluzivisht vetëm pyetjes se tij. Në ligjet federale të SHBA-ve cilësohet se ⁹⁴nëse gjykata është e mendimit se i mituri do të pesoj demtime psikologjike dhe emocionale ajo urdheron që dëshmia e tij të merret në mënyrë audiovizive me metoda bashkëkohore apo proçesi cross- examination të zhvillohet në një hapësire tjetër nga ajo e gjykatës por e mbikqyrur nga trupi gjykues. Dëshmitari i mitur duhet të pyetet duke respektuar garancite që njeh ligji për pyetjen e tij.

Garancite që ligji njeh për dëshmitarët do t'i klasifikojë në dy grupe:

⁹⁴ Federal rules of evidence(For united states courts), West publishing company, St Paul 1993, faqe 28

1. garancite që ligji njeh në përgjithësi për dëshmitarët (të cilat janë automatikisht të aplikueshme për dëshmitarët e mitur)
2. garancite që janë sanksionuar në ligj ekskluzivisht për dëshmitarin e mitur.

Në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë përcaktohet se të mitur janë personat nën 18 vjec.⁹⁵ Në nenin 12 të kodit penal të Republikës së Shqipërisë përcaktohet se nuk mund të jenë subjekte të veprës penale personal që nuk kanë mbushur moshe 14 vjec për krime dhe persona që nuk kanë mbushur moshe 6 vjeç për kundershvajtje penale. Pavarësisht kufizimeve që vendos kodi penal sikurse me sipër KPrP nuk i vendos kufizim të miturit për të qenë dëshmitar. Mund të jetë dëshmitar i mituri në çdo moshe për sa kohe ai ka aftësinë të perceptoj, memorizoj dhe riprodhojë dukuri, të cilat janë 3 fazat e formimit të thënies.⁹⁶ Pyetja e të miturve dhe marrja e dëshmive se tyre i nënshtrohet përveç rregullave të përgjithshme për marrjen e dëshmive edhe disa rregullave psikologjike e taktike të veçanta. Ky trajtim i veçantë vjen si pasoje e faktit që të miturit kanë një hapësirë të kufizuar mendimesh mbi botën, ata e kanë me të vështirë t'i perceptojnë faktet e rrethanat e ndryshme. Të miturit mund të jenë dëshmitarë eficientë vetëm nëse drejtohen e trajtohen mirë dhe duke pasur parasysh intelektin dhe psikologjinë e të miturve mund të themi që ata mund të jenë perceptues dhe vëzhgues të mirë të disa fakteve e dukurive e në raste të tjera të mos jenë në gjendje të perceptojnë një dukuri që për një person të rritur është lehtësisht e perceptueshëm. Për rrjedhojë për të miturit zbatohen rregullat e mëposhteme:

1. Duke u nisur nga ajo që sapo evidentova me sipër të miturit mund të pyeten vetëm për fakte që perceptohen nga ata.
2. Të miturin deri në moshën katërmbëdhjetë vjeç (në seance gjyqësore) kryetari nuk e paralajmëron për detyrimin që ka për të thënë të vërtetën.⁹⁷ Ky është një rregull procedural i parashikuar shprehimisht në neni 360 të kodit të procedurës në bazë të të cilit para se të fillojë pyetja, kryetari e paralajmëron dëshmitarin për detyrimin dhe përgjegjësitë ligjore që ka për të thënë të vërtetën, me përjashtim të rasteve kur dëshmitari është i mitur deri katërmbëdhjetë vjeç. Nëse kemi të bëjmë me marrjen e dëshmive në një fazë tjetër të gjyqimit nga organi procedues është e keshillueshme që të

⁹⁵ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2004, neni 12

⁹⁶ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina" Tiranë 2007, faqe 443-445

⁹⁷ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009, neni 360

miturit të mos i behet që në fillim e ditur përgjegjësia ligjore që ai do të mbaje në rast dëshmie të rreme, por njoftimi për këtë të behet në kohën kur është duke u perpiluar procesverballi pasi ka përfunduar procesi i pyetjes.

3. Ndalohen pyetjet që ndikojnë keq në paanësinë e të miturit ose që synojnë në sygjërimin e përgjigjeve .I mituri ndikohet shumë lehtë nga thëniet veprimet apo gjestet e personave të tjere. Një pyetje që i sygjëstionon atij një përgjigje të caktuar mund të ishte fundi për mbarevajtjen e një hetimi të rregullt të bazuar në fakte konkrete e reale.
4. Gjatë marrjes së dëshmi se të miturit është e lejueshme prania e një personi me të cilin i mituri ka një kontakt psikologjik të vazhdueshëm.. Kjo është një dispozite lehtësisht e kuptueshme për faktin se i afermi është një person që e njeh me mirë se kushdo tjetër psikologjinë e të miturit. Ky nuk duhet konsideruar si një rregull që do të veproje në çdo rast organi procedues apo gjykata lejon praninë e një të mituri gjatë seances se manjës se deshrnise kur plotësohen kushtet me poshte:
 - Një veprim i tillë konsiderohet i domosdoshëm duke marrë parasysh moshën e të miturit dhe vecoritë e psikikës së tij
 - Kur prania e personit tjetër nuk ka asnjë ndikim në marrjen e dëshmi (i rrituri nuk sygjëstionon me asnjë veprim të miturit që po merret në pyetje apo po deshmon)
5. ⁹⁸Pyetja e dëshmitarëve të mitur mund të behet nga kryetari, mbikërkesat dhe kundërshtimet e paleve. Kryetari mund të ndihmohet nga një familjar i le miturit ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve.
6. ⁹⁹Duhet pasur parasysh që i mituri nuk mund të rezistojë seancave të gjata të pyetjes apo atyre në orë të vonë .Nëse organi procedues konstaton se dëshmitari ka pësuar një lodhje fizike apo psikologjike ai duhet të ndërprejë pyetjen dhe të vazhdojë në një rast të mëvonshëm.Lidhur me këtë problem është shprehur kodi i procedurës penale në nenin 361/5 Kur cmohet se pyetja e drejtperdrejte e të miturit nuk e demton gjendjen psikologjike të tij,kryetari urdheron që pyetje të vazhdojë sipas dispozitave të paragrafeve 1 dhe 2. Urdhri mund të revokohet gjatë pyetjes.
7. ¹⁰⁰Organi procedues është mirë që ta pyesë të miturin hollësisht dhe vetëm një herë. Ky është një rregull taktik të cilin kodi i procedurës nuk e përmend por ka një rëndësi

⁹⁸ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2004

⁹⁹ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007

¹⁰⁰ Po aty, faqe 446

jashtezakonisht të madhe sepse garanton saktësinë e dëshmive. Nëse dëshmitari i mitur pyetet dy here për të njëjtën rrethanë ai jo vetëm e perserit thënien e mëparshme me pasaktesi por e zbkuron me shume ate duke u bazuar në fantazi.

¹⁰¹Në rastin e vleresimit të deklaratës së dëshmitarit të mitur përveç veçorive psiko-fizike, të cilat pak a shume janë prezente të të gjithë të miturit, duhet pasur parasysh edhe individualitetin e tyre, si dhe ndikimet e mundshme të rrethanës.

1.7 Dëshmitari dhe bashkëpunëtori i drejtesisë, roli i tyre në procesin e marrjes se provës

Dëshmitari dhe bashkëpunëtori i drejtesisë, kanë një rol të madh në luftën kunder krimet. Ata sikurse dëshmitari i thjeshtë japin të dhëna mbi fakte e rrethana që kanë lidhje me veprën penale por vecantia qendron në faktin se ketyre personave iu rrezikohet integriteti fizik dhe jeta si pasoje e ketyre thënieve e për rrjedhoje atyre iu sigurohet nga autoritetet perkatese një mbrojtje specifike. Duke qenë se ata kanë një status të veçantë në krahasim me dëshmitarin e thjeshtë sistemi ynë ligjor nuk është mjaftuar vetëm me dispozitat e parashikuara në kodin e procedurës penale për rregullimin juridik të statusit të tyre por ka bere pjese të vetin edhe një ligj specifik sikurse është ¹⁰²ligji me nr. 9205 datë 15.02.2004 në bazë të nenit 2 të ligjit : " Dëshmitari i drejtesisë është personi ndaj të cilit zbatohen masa të vecanta mbrojtjeje i cili në cilësinë e dëshmitarit apo personit të demtuar bën njoftime apo deshmon për fakte apo rrethana që perbejnë objekt provë në një procedim penal dhe për shkak të ketyre njoftimeve apo thënieve ndodhet në një gjendje rreziku aktual , konkret dhe serioz "Gjykata, kryesisht ose me kërkesen e paleve percakton që pyetja e bashkëpunëtoreve të drejtesisë dhe e dëshmitarëve të mbrojtur zhvillohet nën masa të vecanta për mbrojtjen e tyre. KPrP specifikon një sere masash si me poshte:

1. ¹⁰³Gjykata mund të vendose që marrja në pyetje e tyre të zhvillohet në distance me anë të lidhjes audiovizive, mbrenda ose jashtë vendit, duke respektuar rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitat kodit të procedurës. Personi i autorizuar nga gjykata qëndron në vendin ku ndodhet dëshmitari dhe bën vërtetimin e identitetit

¹⁰¹ Sahiti Ejup "Dëshmia e dëshmitarit si provë në procesin penal" Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, "Rominor", Prishtinë 1993

¹⁰² Ligji nr. 9205 datë 15.02.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtesisë"

¹⁰³ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009, neni 361

të tij, si dhe kujdeset për zhvillimin e rregullt të marrjes në pyetje e për zbatimin e masave të mbrojtjes. Keto veprime ai i pasqyron në procesverbal.(neni 361/7).

2. Kur ndaj personit që do të pyetet është vendosur ndryshimi i identitetit, gjykata urdheron marrjen e masave të pershtatshme për të bërë të mundur që fytyra dhe zeri i personit të mos jenë të dallueshme për palet.(Neni 361/a pika 2)
3. Në rast se është e domosdoshme njohja e identitetit e keqyrja e personit, gjykata urdhëron thirrjen ose shoqërimin e detyrueshëm për permbushjen e këtij veprimi. Në këtë rast gjykata urdhëron marrjen e masave të nevojshme për të mënjeluar pamjen e dallueshme të fytyrës së personit, të cilit i është ndryshuar identiteti.(neni 36 l/a)

2. Pyetja e të pandehurit dhe të paditurit civil

¹⁰⁴Thëniet e të pandehurit në vendin tonë perbenin provën më të plotë më të preferuar dhe më të privilegjuar në shek 12-13.Thënia e të pandehurit konsiderohej si provë edhe më parë madje edhe në kodin e 1953 percaktohet qarte.Në periudhën e feudalizmit nëse i pandehuri në deklaratën e tij pranonte fajesinë atëherë thënia e tij kishte epersi në krahasim me provat e tjera dhe çmohej nga autoritetet pa marrë parasysh ekzistencën e provave të tjera, nëse i pandehuri deklarohej i pafajshëm atëherë thënia e tij çmohej në raport me provat e tjera. Personalisht me duket e arsyeshme ta quaj një sistem të tillë drejtesie "sistem me dy standarte".

Dy janë rastet taksative të cilat parashikohen në KPrP kur mund të pyeten i pandehuri (i cili është person që e fiton këtë status në momentin që i njoftohet akuza)

1. Rasti i parë është në qoftese bejnë kërkesë
2. Kur u kërkohet dhe ata japin pëlqimin

Dy raste të mesiperme vlejné edhe për paditësin civil por për paditesin civil ka një veçanti. Ky i fundit në rast se i plotëson kushtet e kërkuara nga ligji për të qenë dëshmitar pra ka zotesi dhe mundesi për të dëshmuar e nuk është një person që hyn në kategorinë e personave të percaktuar në nenin 156 dhe 158 të kodit të procedurës është i detyruar të japë dëshmi në cilësinë e dëshmitarit pavaresisht vullnëtit të tij. Thëniet e të pandehurit formohen si provë vetëm nëse i pandehuri pranon të përgjigjet para gjykatës.

¹⁰⁴ Gazeli Kosta," Thëniet e të pandehurit si provë në procesin tonë penal", Tiranë 1988

¹⁰⁵Në nenin 370/1 të kodit sanksionohet se thëniet që merren në fazën hetimore nuk përdoren si provë gjyqësore.

¹⁰⁶Në bazë të nenit 167 personat e marrë site pandehur në një procedim të lidhur pyeten me kërkesën e paleve ose dhe kryesisht këta persona e kanë të detyrueshme të plotësojnë detyrimin e tyre për tu paraqitur për pyetje në gjykatë . Nëse nuk e plotësojnë këtë detyrim sikurse edhe në rastin e dëshmitarëve gjykata urdheron shoqërimin e tyre forcerisht .Edhe në këtë rast nuk duhet që të mbahen në pyetje me shume se 24 ore .Në cdo rast këta persona ndihmohen nga një mbrojtës ose që e kanë zgjedhur vete ose që u i është caktuar kryesisht. Të pandehurit në një procedim të lidhur pyeten vec e veç dhe asnjë nuk duhet të jetë i pranishëm në pyetjen e të pandehurit tjetër. ¹⁰⁷Për të pandehurin dhe paditesin civil ekziston një privilegj në krahasim me të drejta që kanë dëshmitarët. Këta të fundit nëse refuzojnë të përgjigjen ndaj tyre gjykata urdheron të merren masa të vecanta. Pikerisht në këtë pikë qendron edhe ndryshimi me pyetjen e të pandehurit, ai ka të drejtë të mos përgjigjet, jo vetëm kaq por ligji shkon edhe me tej duke vendosur si garanci faktin që organi procedues e ka për detyrë pra është detyrim ligjor, t'u beje të ditur këtyre personave që kanë të drejtë të mos përgjigjen. Ky rregull vlen edhe gjatë hetimit paraprak, fakti që i pandehuri nuk dëshiron të përgjigjet duhet të shenohet në procesverbalin që mbahet në fund të procesit të pyetjes. ¹⁰⁸Sikurse dhe dëshmia dhe procesi i marrjes së deklaratës së të pandehurit kalon në tri faza:

- Faza përgatitore
- Tregimi i lirë(¹⁰⁹në sistemin ligjor common law nuk merret dëshmia nëpërmjet tregimit të lirë por që në fillim dëshmitarit i behen pyetje .Ky proces njihet me emrin cross - examination)
- Pyetja e të pandehurit

Në fazën përgatitore organi procedues përcakton rradhën e pyetjes së të pandehurve që ka mjaft rëndësi në rastin e një procedimi të lidhur. ¹¹⁰Radha e pyetjes së tyre është si më poshtë:

¹⁰⁵ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009, neni 370

¹⁰⁶ Po aty, neni 167

¹⁰⁷ Po aty

¹⁰⁸ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 429-433

¹⁰⁹ Federal rules of evidence(For united states courts), West publishing company, St Paul 1993

¹¹⁰ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 431

- Fillimisht pyeten ata të pandehur të cilet e kanë kryer veprën penale për here të pare për rrjedhoje si pasoje e mungeses se pervojes tregojnë me shpejt
- Ata të pandehur në drejtim të të cileve ka prova të cilat nuk mund të kontestohen
- Të pandehurit të cilet kanë një rol "aksesor" në kryerjen e veprës penale

Në fazen e dyte organi procedues i kërkon të pandehurit të tregojë lirisht cdo gje që ai ka perceptuar dhe mendon se do t'i shërbeje atij në procesin e mbrojtjes.

Në rastin e pyetjes se të pandehurit rregullat procedurale që zbatohen të njëjtat rregulla që aplikohen në rastin e pyetjes se dëshmitarit, por pyetja e tij ka dhe disa ndryshime sikurse është fakti i permendur me lartë. Megjithëse në përgjithësi edhe për të aplikohen rregullat për marrjen në pyetje të një dëshmitari, i pandehuri nuk ka statusin e dëshmitarit. Thëniet që ai jep quhen deklarime dhe nuk mund të përdoren për dëshmi. Në shume vende ky parim specifikohet dhe evidentohet në mënyrë me të drejteperdrejte.

¹¹¹Anglia njeh të drejten e të pandehurit për të qenë dëshmitar në çështjen drejtuar atij. Jurisprudenca angleze e cilëson këtë mundësi si një garant për një proces me të drejtë gjyqësor i cili i shërben parimit të shpejtësisë dhe efektivitetit. I pandehuri nën cilësinë e dëshmitarit ndjehet i kercenuar nga sanksioni që i drejtohet atij për dëshmi të rreme kështu që është me i predispozuar të tregojë të vërteten. Për pyetjen e të pandehurit aplikohen një sërë rregullash taktike apo proceduriale. Sa me i perpiktë të jetë organi procedues në zbatimin e dispozitave që ka percaktuar kodi për pyetjen (si lloj i veçantë provë), si dhe të rregullave taktike që parashikon kriminalistika për pyetjen e të pandehurit apo për marrjen e dëshrnise se dëshrnitarit, aq me të vërteta dhe të sakta do të jenë thëniet e tyre dhe aq me e madhe do të jetë vlera provuese e provës si dhe kontributi që ajo jep për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Rregullat që duhet të respektoje organi procedues gjatë marrjes në pyetje të pandehurit janë:

1. I pandehuri merret në pyetje i lire përveç rasteve kur duhen marrë masa për të parandaluar rrezikun e ikjes apo të dhunës
2. Ndaj të pandehurit nuk mund të përdoren metoda e mjete që prekin lirinë e vullnëtit ose aftësinë e kujteses për vleresimin e fakteve si dhe nuk mund ti nënshtrohet tortures, denimit apo trajtimit çnjërezor.

¹¹¹ Sahiti Ejup "Dëshmia e dëshmitarit si provë në procesin penal" Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, "Rominor", Prishtinë 1993

3. ¹¹²Organi procedues gjatë pyetjes se të pandehurit duhet të jetë objektiv .Mosrespektimi i parimit të objektivitetit mund të bente që një provë të shpallej jo e vlefshme. Sipas këtij parimi organi procedues duhet të marrë parasysh gjatë marrjes në pyetje si rrethanat lehtësuese ashtu edhe ato renduese të cilat parashikohen në nenin 49 dhe nenin 50 të kodit të procedurës penale.
4. ¹¹³Në bazë të nenit 38/3 të procedurës penale para se të këtë filluar marrja në pyetje , të pandehurit i spjegohet se ka të drejtë të mos përgjigjet dhe se edhe po të mos përgjigjet procedimi do të vazhdoje .Fakti që i pandehuri refuzon të përgjigjet nuk mund të shërbeje si provë për fajesimin e tij . Do të shenohet në procesverbal fakti që i pandehuri nuk pranon të përgjigjet.
5. Perpara marrjes në pyetje organi procedues duhet të beje verifikimet perkatese në lidhje me moshen e të pandehurit si dhe mbi kushtet personale familjare e shoqerore të tij.
6. Organi procedues e ka detyrim ligjor të njohe të pandehurin me provat dhe burimet e tyre me përjashtim të rastit kur nga një veprim i tille demtohen hetimet
7. Thëniet e të pandehurit kanë të njëjtën vlere provat e tjera, ato i nënshtrohen shqyrtimit njësoj si provat e tjera. ¹¹⁴Në vendimin nr 5 datë 11.11.2003 të kolegjeve të bashkuara të gjykatës se lartë ajo shprehet se akuza në ngarkim të të pandehurve Fation Ndreu e Fatmir Keçi për vjedhje të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal nuk është ngritur vetëm mbi deklaratimet e bera para oficerit të policise gjyqesore nga i pandehuri Fation Ndreu por edhe duke ju referuar deklarimeve të personave të tjere të marra gjatë hetimit paraprak.Gjykata e rrethit në arsyetimin e vendimit për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës për të dy të pandehurit, ju drejtohet vetëm deklarimeve të të pandehurit Fation Ndreu (ndersa i pandehuri Fatmir Keçi nuk ka pranuar të jape shpjegime) pa marrë për bazë shpjegimet e dëshmitarëve të pyetur në seance gjyqesore dhe pa u shprehur fare për faktet e rrethanat që ata kanë shpjeguar Ky qëndrim i mbajtur nga gjykata vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 152/3 të K.Pr.Penale,sipas të cilit deklaratimet e bera nga bashkë i pandehuri në të njëjtën veper penale vleresohen në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

¹¹² Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 426

¹¹³ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009, neni 383

¹¹⁴ Vendimi Nr 5, Datë 11.11.2003 Kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë

8. ¹¹⁵I pandehuri nëse e kërkon vete një gje të tillë pyetet në prani të mbrojtësit. Kjo është një garanci që ligji i njëh të pandehurit, një e drejtë të cilën ai ka diskrecionin ta shfrytëzojë ose jo.
9. I pandehuri mund të pyetet sikurse dhe dëshmitari me lidhje audiovizive. Zakonisht edhe për të pandehurin organi procedues i bën atij ftese të paraqitet në oren vendin dhe ditën e caktuar prej tij për ta marrë në pyetje megjithatë mund të ndodhin edhe situata të tjera sic është rasti kur për një të pandehur që ka nisur një procedim penal në një shtet të caktuar, shteti ku ai ndodhet efektivisht të refuzojë ekstradimin. Në këtë rast ligji për të rregulluar këtë situatë në ¹¹⁶nenin I 67/a sanksionon se i pandehuri mund të pyetet në distance me anë të lidhjeve audiovizive . Por ligji është taksativ dhe i prerë sepse ai e kushtëzon pyetjen e të pandehurit me anë të lidhjeve audiovizive me ekzistencën e dy kushteve:
- Të këtë marrëveshje nderkombetare midis dy vendeve për të përdorur mjete të tilla
 - Shteti i huaj të garantojë pjesmarrjen e mbrojtësit të të pandehurit në vendin ku kryhet marrja në pyetje
10. Në rast se i pandehuri nuk mund të merret në pyetje në vendin e percaktuar në ftese për shkaqe objektive që nuk varen nga vullnëti i tij organi procedues mund të procedojë me marrjen në pyetje në ambiente të tjera në varesi të rrethanave. Në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat që percakton KPrP për pyetjen e tij si dhe të garantohen të drejtat me thelbesorja e të cilave është prania e avokatit.
11. Në bazë të nenit 370 për të kundërshtuar, tërësisht ose pjesërisht, përmbajtjen e deklarimeve të të pandehurit, palet mund të përdorin deklarimet e bera me pare nga ai dhe që ndodhen në fashikullimin e prokurorit, në qofte se ka folur për faktet dhe rrethanat që kundërshtohen.. Gjykata vendos që të lexohen procesverbalet e deklarimeve të bera nga ai gjatë hetimeve paraprake kur:
- I pandehuri është deklaruar në mungesë
 - Nuk është paraqitur
 - Ka refuzuar të përgjigjet
- Në fund të procesit të pyetjes për pyetjen e të pandehurit mbahet procesverbal në të cilin shënohen pyetjet e organit procedues dhe përgjigjet e të pandehurit.

¹¹⁵ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009

¹¹⁶ Po aty

Për të marrë në pyetje të pandehurin organi procedues (prokuroria) i dergon atij një ftese në të cilën percaktohen gjeneralitetet e të pandehurit, vendi data dhe ora e paraqitjes, faktet që i atribuohen, dhe veprimin hetimor për të cilin duhet të paraqitet e që në këtë rast është pyetja, si dhe paralajmerimin për shoqerim të detyrueshëm në rast mosparaqitje(në këtë rast shoqerimi i detyrueshëm nuk mund të behet për marrjen në pyetje të pandehurit pasi ai ka një të drejtë ekskluzive sikurse është ajo për të mos u përgjigjur). Në bazë të nenit 353 të KPrP gjykata mund të urdherojë shoqerimin e detyrueshëm të të pandehurit që nuk është paraqitur apo që është deklaruar në mungesë, në qoftese prania e tij është e detyrueshme për marrjen e një provë por jo për pyetjen e tij . Pasi i pandehuri është marrë në pyetje në fund të procesit organi procedues mban procesverbal.

Në nenin 365 të kodit të procedurës percaktohet se pyetjen e paleve private e fillon ai që e ka kërkuar këtë gje dhe vazhdon me pyetjet e prokurorit, të mbrojtësve, të perfaqësuesve të paleve dhe të pandehurit. Ai që e ka filluar pyetjen mund të beje pyetje edhe pas paleve të tjera. Për të kundërshtuar përmbajtjen e deponimit, mund të shfrytëzohen deklaratimet e bera gjatë hetimeve paraprake nga pala e pyetur dhe që ndodhen në fashikullimin e prokurorit, me kusht që pala të këtë deponuar mbi faktet dhe rethanat që kundërshtohen.

¹¹⁷Duhet të kemi në konsideratë faktin që i pandehuri mund të pohojë fakte të caktuara ose që e ka kryer veprën penale. Pra pohimi i të pandehurit është i plotë në rastin kur ai pranon të gjitha faktet për të cilat akuzohet dhe tregon në detaje mënyrën e kryerjes së veprës dhe motivet që e kanë shtyrë për ta kryer atë. Pohim i pjesshëm kur i pandehuri pranon që e ka kryer veprën penale por jo të gjitha faktet. Pavarësisht llojit të pohimit, pohimi i të pandehurit ka të njëjtën vlerë me provat e tjera, ai do të çmohet nga trupi gjyqësor me të njëjtat rregulla.

3. Pyetja e paleve private

Si provë në procesin penal shërbejnë dhe thëniet e marra nga personat private gjatë pyetjes së të cileve zbatohen dispozitat që ka parashikuar kodi i procedurës penale për

¹¹⁷ Sahiti Ejup "Dëshmia e dëshmitarit si provë në procesin penal", Prishtinë 1993, faqe 228-231

dëshmitarët (për aq sa është e mundur) rregulla të cilat i permenda në trajtimin që i bera dëshmise si provë e të cilat nuk po i permend serish. Paditesi dhe i padituri civil pyeten mbrenda kufirit që ka percaktuar ligjvënësi për dëshminë si provë.

4. Ballafaqimi

Një nga provat e tjera që permendet në mënyrë eksplicite në kodin tonë është ballafaqimi. Rëndësia e kësaj provë qendron të qëllimi që ka ballafaqimi dhe të fakti se ç'perfaqeson ai. Për të kuptuar me tepër nuk po zgjatëm me tej por po i referohem faktit që ballafaqimi ehte një provë që mund të merret vetëm nëse para marrjes se tij personat që do të ballafaqohen janë pyetur për fakte të ndryshme që kanë lidhje me veprën penale dhe kur midis tyre ka mosperputhje për fakte e rrethana të caktuara. Dy janë kushtet që duhet të ekzistojnë që me pas të zhvillohet një proces ballafaqimi:

1. Lejohet vetëm ndërmjet personave që janë pyetur

2. Ndërmjet thënieve të ketyre personave të këtë mosperputhje apo kontradikta

për fakte e rrethana të ndryshme. Arsye që thëniet e personave kanë kontradita do t'i grupoja në dy kategori:

- Arsye subjektive. Në një rast të tille personat me vullnëtin e tyre të plotë deshirojnë për të dhenë deklarime të tilla me qëllim çorientimin e hetimeve
- Arsye objektive. Keto arsye nuk kanë lidhje aspak me vullnëtin e individit por lidhen me aftësinë e mirë apo jo që ka individit për të perceptuar, kujtuar ose riprodhuar.

Ballafaqimi përveçse shërben si provë, shërben edhe si një metode efikase për të kontrolluar vërtetësinë e dëshmise se dëshmitarit apo të thënieve të të pandehurit. Është një metode mjaft praktike që qendron krahas metodave të tjera sikurse janë detajimi i thënieve apo paraqitja e provave.

¹¹⁸Ballafaqimi mund të jetë dy llojesh. Ballafaqim me karakter pozitiv në rastin kur kontraditat sheshohen dhe ballafaqim negativ kur secila pale qendron në deklarimet e bera me pare. Gjatë zhvillimit të procesit të ballafaqimit organi procedues duhet të respektojë rregullat e mëposhteme:

1. ¹¹⁹I kujton deklarimet e mëparshme personave që do të ballafaqohen,

¹¹⁸ Elezi Ferdinand, "Provat penale" Tiranë 2008

¹¹⁹ Imeraj Elizabeta, "Provat në procesin penal", Tiranë 2008

2. ¹²⁰I pyet nëse i konfirmojnë ose i ndryshojnë thëniet e mëparshme, duke i ftuar, kur lind nevoja, për të bere kundërshtimet reciproke.
3. ¹²¹Pasi janë kryer dy veprimet proceduriale të mësipërme pyeten i pari personi thëniet e të cilit organit procedues i duken të drejta.
4. ¹²²Në rast se njëri nga të pyeturit pohon një fakt ndërsa tjetri e mohon , i pari pyetet ai që e pohon faktin.
5. ¹²³Në rast se njëri demaskon tjetrin për kryerjen e veprës penale i pari pyetet ai që demaskon.
6. ¹²⁴Në rast se ballafaqimin e ka kërkuar njëri nga personat ,do të pyetet fillimisht ai person kërkesa e të cilit është në këtë mënyrë : " unë personit x ia them në sy"
7. ¹²⁵Gjatë ballafaqimit organi procedues duhet të jetë i kujdesshëm me venien e kontaktit psikologjik , i cili tanime është me i vështirë për tu vendosur sepse bashkëveprojnë tri
8. ¹²⁶Në fund të procesit organi procedues mban procesverbal. Në procesverbal shenohen pyetjet e bera nga organi procedues, deklaratimet e bera nga personal e ballafaquar dhe gjithcka tjetër që ka ndodhur gjatë ballafaqimit.(neni 170 KPrP)

Për të ilustruar rëndësinë e ballafaqimit po përmend faktin që kolegji penal i gjykatës se lartë me ¹²⁷vendimin nr 32 datë 23.01.2008 e cmoi jo të drejtë vendimin e gjykatës se apelit Vlore për hedhjen poshte të vendimit të gjykatës se shkallës se pare Lushnjë. Nder të tjera argumenti i kolegjit ishte dhe fakti që gjykata e apelit anashkaloi pa përmendur asnjëherë prej provave që kishte venë në themel të vendimit të saj të fajesisë gjykata e shkallës se pare, dhe në kundërshtim me urdherimet e dispozites se nenit 152 të K.Pr.Penale, vec deduksionëve hipotetike që u përmenden, pa i'a nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, nëpërmjet ballafaqimit me të demtuaren K., i dha vlerë të paracaktuar thënieve të dëshmitarit R.Milla.

5. Njohja

¹²⁰ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 448

¹²¹ Po aty

¹²² Po aty

¹²³ Po aty

¹²⁴ Po aty

¹²⁵ Po aty- faqe 449

¹²⁶ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009, neni 170

¹²⁷ Vendimi Nr 32, Datë 23.01.2008 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

Kërkesa për të proceduar me njohjen e një personi sendi, tingulli është një kërkesë që mund të plotësohet vetëm:

1. Nëse personi që do të beje njohjen ka në memorien e tij një perfytyrim të sakte të një prej objekteve të paraqitjes për njohje të cituar me siper
2. Objekti që duhet të njohe personi që bën njohjen, ka lidhje me veprën penale.

Njohja është një provë tepër e rëndësishme pasi nëpërmjet saj behet individualizimi i autorit të veprës, i sendeve, i thënieve të dëshmitarit të demtuarit, të të pandehurit etj... Paraqitja për njohje (që është procesi i njohjes se sendit, në fund të të cilit mbahet procesverbali i njohjes) kalon në dy faza:

1. Pyetja e njohesit mbi shenjat e personit, sendit, zerit, kufomes. Organi procedues fton ate që duhet të beje njohjen që të pershkruaje personin duke treguar të gjitha shenjat që mban mend dhe e pyet nëse ka qenë thirrur me pare për të bere njohjen si dhe për rrethana të tjera që mund të ndikojnë në vërtetësinë e njohjes.

2. Paraqitja e ketij sendi, personit për njohje

Në procesin e paraqitjes për njohje duhet të respektohen rregullat e mëposhtme:

- a) Organi procedues fton të paraqitet personin që duhet të beje njohjen
- b) Siguron praninë e të pakten dy personave sa me të ngjashëm me ate që duhet të njihet(personi që do të njihet duhet të paraqitet në të njëjtat kushte në të cilat ka qenë në momentin që është pare nga ai që do të beje njohjen me të njëjtën veshje) personi që do të njihet e zgjedh vete vendin ku do të qendroje
- c) Procesi i paraqitjes për njohje të zhvillohet në të njëjtat kushte që kanë ekzistuar në momentin e perceptimit të shenjave të objektit.(pershëmbull në të njëjtat kushte ndricimi , në të njëjtat kushte atmosferike apo nga e njëjta distance)
- d) Njohesit nuk duhet t'i tregohet sendi perpara paraqitjes për njohje
- e) Gjykata fton personin që të beje njohjen e pyet nëse njeh ndonjërin nga ata që i paraqiten për njohje dhe, në rast se po, e fton të tregojë se cilin njeh dhe ta saktësojë nëse është i sigurt. Në cdo rast organi procedues duhet të pyesë se mbi y'shenja u bazua personi që beri njohjen për njohjen e personit, sendit,tingullit etj..
- f) Organi procedues urdheron që veprimi të kryhet pa e pare personi që duhet njohur, personin e thirrur për të bere njohjen kur ky i fundit mund të frikesohet ose të ketë ndikime të tjera nga prania e tij.

- g) Në fund të proçesi mbahet një proçesverbal ku shenohen deklaratimet e bera nga personi që bën njohjen, të gjitha veprimet proçedurale të trajtuara me siper, menyra e zhvillirnit të njohjes. Në rast se nuk respektohet ky rregull proçesverbali është i pavlefshëm po kështu edhe njohja. Në këtë rast ajo nuk mund të përdoret si provë.
- h) Kur disa persona thirren për të bere njohjen e të njëjtit person ose të të njëjtit objekt, organi procedues kryen veprime vec e vec duke ndaluar cdo komunikim ndërmjet atij që ka kryer njohjen dhe atyre që duhet bejnë ate me pas (neni 175)
- i) Zhvillimi i njohjes mund të dokumentohet edhe me fotografime ose filmime kur për këtë ka dhenë urdher organi procedues.

Kur duhet proceduar në njohjen e provave materiale ose të sendeve të tjera që lidhen me veprën penale, organi procedues vepron duke respektuar rregullat për njohjen e personave, për aq sa mund të zbatohen. Pasi gjenden, kur është e mundur, të pakten dy objekte të ngjashme me ate që duhet njohur organi procedues e pyet personin e thirrur për njohje nëse njëh ndonjërin prej tyre dhe, në rast se po, e fton të deklaroje se cilin ka njohur dhe ta saktesoje nëse është i sigurt. Në proçesverbal shenohen, me pasojë pavlefshmerie, menyra e zhvillimit të njohjes. (neni 173 i KPrP)

Në bazë të nenit 174 të kodit të proçedurës kur vendos njohjen e zerave, të tingujve ose të cdo gjeje tjeter që mund të jetë objekt perceptimi shqisor, organi procedues vepron duke respektuar dispozitat për njohjen e personave, për aq sa mund të zbatohen.

6. Ekperimenti

Eksperimenti është riprodhimi¹²⁸ për aq sa është e mundur, i gjendjes në të cilën fakti ka ndodhur ose cmohet se ka ndodhur duke perseritur menytrat e zhvillimit të vete faktit. (neni 176 i KPrP) . E thënë ndryshe eksperimenti është krijimi i një suate të njëjtë ose të perafert me ate në të cilën fakti ka ndodhur ose mendohet se ka ndodhur. Eksperimenti lejohet kur është e nevojshme të vërtetohet nëse një fakt ka ndodhur, ose mund të këtë ndodhur ose jo në një mënyrë të caktuar.¹²⁹ Eksperimenti përdoret në praktike si provë e cila percakton vërtetësinë e fuqive provuese të provave për jo nuk duhet interpretuar aspak në kuptimin që është prova mbretereshe. Në të drejten proçedurale vepron parimi se nuk ka provë "regina probatum". Edhe për eksperimentin në kodin e proçedurës penale të Republikës se Shqipërise Parashikohen dispozita që bejnë rregullimin juridik të kësaj provë. Në keto

¹²⁸ Kodi i Proçedurës Penale i Republikës se Shqipërise, Botim i QPZ, Tiranë 2009, neni 176

¹²⁹ Elezi Ferdinand, "Provat penale" Tiranë 2008

dispozita perfshihen rregullat e meposhtme, të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar, në mënyrë që eksperimenti të jetë i vlefshern dhe rezultatet e perftuara nga ai të mund të përdoren si provë.

1. ¹³⁰Se pari percaktohet qëllimi për të cilin zhvillohet eksperimenti(percaktohet fakti që do të vërtetohet)
2. Se dyti eksperimenti mund të zhvillohet vetëm me vendim të organit procedues. Vendim i cili duhet të perfshije një njoftim ku percaktohet objektin i eksperimentit dita, ora dhe të vendi ku do të kryhen veprimet .Në këtë vendirn ose në një tjetër që është leshuar me vonë nga organi procedues caktohet një specialist për kryerjen e veprime të caktuara të nevojshme për realizimin e eksperimentit.
3. Organi procedues merr masa të pershtatshme për të siguruar të gjitha rezultatet e eksperimentit duke i fiksuar ato me anë të fotografive dhe filmimeve.
4. Në eksperiment të perodoren ato sende që janë përdorur në kryerjen e veprës penale. Në rastin kur keto sende rnungojnë atehere zevendesohen me sende që kanë shenja grupore të perbashkëta.
5. Eksperimenti ¹³¹ duhet të zhvillohet në atë vend ku ka ndodhur ai fakt të cilin organi procedues kërkon ta vërtetojë. Ky nuk është një rregull që vepron në cdo rast po për aq kohe sa një gjë e tillë është e rndundur. Në çdo rast tjetër eksperimenti do të kryhet nëkushte laboratorike.
6. ¹³²Koha në të cilën do të zhvillohet eksperimenti duhet t'i afrohet kohës në të cilën ka ndodhur ngjarja. Në këtë rast flasim për një përafërsim të kohës natyrore dhe jo orës zyrtare nuk mund të jetë e njëjtë situata kur vepra ka ndodhur në orën 20.00 në muajin korrik dhe në momentin që dote zhvillohet eksperimenti është muaji nëntor .Ora zyrtare 20.00 e muajit nëntor nuk perkon me orën zyrtare 20.00 të muajit korrik sepse në orën 20.00 në nëntor erresohet totalisht ndërsa në po të njëjtën orë në muajin korrik situata është komplet ndryshe. Në një situatë të tillë personi në muajin nëntor nuk mund të perceptojë njësoj si në korrik të njëjtin tingull apo objekt e për rrjedhojë eksperimenti nuk do të ishte eficient.

¹³⁰ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 372

¹³¹ Po aty

¹³² Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 372

7. ¹³³Ekspperimenti zhvillohet në po ato kushte ose sa me afer atyre kushteve në të cilat ka ndodhur ngjarja që do të vërtetohet. Me kushte të njëjta nënkuptohen kushte të njëjta të forces se eres, ndricimit, zhurmes etj...
8. ¹³⁴Ekspperimenti duhet të perseritet disa here dhe nuk duhet të kenaqemi me zhvillimin e një provë të vetme.
9. Gjatë zhvillimit të ekspperimentit nuk duhet kurrsesi që të cenohet siguria e personave publike apo private ¹³⁵. Nuk duhen kurrsesi të cenohen elementet e meposhtem:
- a) Morali i njeriut
 - b) Shendetit i njeriut
 - c) Jeta e njeriut
 - d) Pasuria shtetërore ose private
10. ¹³⁶Në fund të proçesit të ekspperimentit mbahet proçesverbal i cili ndahet në tri pjese:
- Pjesa hyrese- në këtë pjese pershkruhet se cili është qëllimi i ekspperimentit, pra cili është fakti që kërkohet të vërtetohet dhe cili është synimi që kërkohet të arrihet nëpermjet kryerjes se tij.
 - Pjesa pershkruese, në të cilën saktësohet vendi, data, dita dhe ora e zhvillimit të ekspperimentit, kushtet e ekspperimentit, permbajtja konkrete e veprimeve që do të kryhen, sendet që do të përdoren për zhvillimin e tij, etj...
 - Pjesa perfundimtare në të cilën perfshihen deklarimet e pjesemarrësve në proçesverbal, mosperhapjen e rezultateve, kohën e fillimit dhe të mbarimit të ekspperimentit, rezultati i perftuar nga ekspperimenti si dhe nënshkrimet e paleve.

Në proçesverbal çdo e dhenë duhet të pershkruhet saktësisht. Nuk mund të përdoret termi "afersisht"

7. Ekspertimi, vlera provuese në proçesin penal

Ekspertimi sikurse dhe ekspperimenti është një provë e cila ndryshe nga provat e tjera që bazohen në perceptimin e individit (që formohet si rezultat i kontaktit të fenomenëve të jashtme me qelizat nërvore të trurit), bazohen në të dhëna shkencore. Pikerisht karakteri shkencor i jep kësaj lloji provë një vlere të veçantë. Ai nuk është qëllim në vetvete por

¹³³ Po aty- faqe 373

¹³⁴ Po aty-

¹³⁵ Po aty

¹³⁶ Po aty

kërkese për zbulimin e një provë të re .¹³⁷ Në lidhje me ekspertimin janë hasur polemika të shumta nga autore të ndryshëm nëse është vete mendimi i ekspertit që shërben si provë, apo është fakti që konstatohet nëpërmjet ushtrimit të ekspertimit. Në opinionin tim gjykoj se duke u nisur dhe nga perkufizimi që jep kodi për provat, si provë duhet të shërbejnë faktet që janë evidentuar nga ekspertimi dhe jo vete ekspertimi. Ekspertimi është një provë për marrjen e se cilës autoriteti procedues e ka të pamundur të mos bashkëveproje me një subjekt që zoteron njohuri të posaçme teknike dhe shkencore.

Ekspertimi në vetvete është një dëshmi e një lloji të veçantë, është një dëshmi teknike e bere nga një person i cili zoteron njohuri të posaçme teknike e shkencore.

7.1 Por cili është dallimi i ekspertimit me keqyrjen e vendit të ngjarjes?

Mund të ndodhe që gjatë hetimeve paraprake të marrin pjese në keqyrjen e vendit të ngjarjes eksperte pra persona të cilet kanë njohuri teknike e shkencore specifike, eksperte të cilet mund të japin dhe mendimin e tyre mbi sqarimin e një rrethanë në vendin e ngjarjes. Por a mundet që në këtë rast keto mendime të përdoren si provë në procesin gjyqësor? A mundemi të veme një shenjë barazimi ndërmjet ekspertimit dhe keqyrjes ? Përgjigja është kategorike negative jo.

Ndryshimet ndërmjet tyre janë si me poshte:¹³⁸

- Në rastin e keqyrjes të dhënat konstatohen nga personi nëpërmjet perceptimit drejteperdrejte të tyre ndersa në rastin e ekspertimit të dhënat konstatohen nga eksperti nëpërmjet ekzaminimeve. Eksperti nuk i mbledh vete të dhënat që i duhen për të bere ekzaminimin, ato i dorezohen atij nga organi procedues.
- Ndodh shpesh që gjatë ekspertimit të dhënat shkaterrohen gje që nuk ndodh në procesin e keqyrjes
- Ekspertimi në vetevete është një proces me kompleks se keqyrja po kështu edhe procedural që duhen respektuar për realizimin e tij
- Në procesin e keqyrjes nuk kërkohet domosdoshmerisht që personi që e kryen keqyrjen të këtë njohuri specifike

7.2 A mund të ekuivalentojme termin specialist me termin ekspert?

¹³⁷ Tartale Fatmir, "Ekspertimi në të drejten procedurale penale në R.Sh", Tiranë 1999

¹³⁸ Tartale Fatmir, "Ekspertimi në të drejten procedurale penale në R.Sh", Tiranë 1999

Me siper permenda faktin që njohuri teknike e shkencore zoteron edhe specialisti, por ndërmjet tyre ka diferencime që nuk lejojnë që keto dy terma të jenë të barazvlefshëm.

¹³⁹Se pari specialisti ndihmon organin procedues ose gjykatën bazuar në njohurite që zoteron ose pervojen për zbulimin fiksimit marrjen e provave, por nëse organi procedues ka pervoje në veprimet e mesiperme nuk është i detyruar ta marrë ate për ndihme, ndërsa eksperti thirret domosdoshmerisht për të bere ekspertimin pavaresisht se subjektet me siper mund të kenë njohuri teknike e shkencore.

Ekspertimi është disa llojesh në varesi të fakteve e të problemeve që duhen zgjidhur në çështjet konkrete nga persona që zoterojnë njohuri specifike në ate fushe. Me poshte do të trajtoj shkurtimisht disa lloje ekspertimesh të cilat me gjeresisht i trajton shkenca e kriminalistikes. Nga një analizë (personale) e secilës prej tyre arrij në konkludimin se të gjitha llojet e ekspertimeve kanë kater elemente të perbashkët:

1. Ndihma që japin në zbardhjen e fakteve
2. Bazohen të gjitha në ekzaminimin e gjurmeve të cilat janë specifike për cdo lloj
3. Janë ekspertime të cilat realizohen në qendrat perkatese laboratorike të cilat varen nga ministria e drejtesisë
4. Se katerti procedura për kryerjen e ekspertimit kalon në të gjitha rastet në fazat e meposhteme:
 - a) Marrja e vendimit të organit procedues për caktimin e ekspertit. Eksperti vepron vetëm pasi është bere caktimi i tij me vendim të organit procedues.
 - b) Njohja e të pandehurit me këtë vendim
 - c) Venia e ketij vendimi në zbatim

7.3 Llojet e ekspertimeve

7.3.1 Ekspertimi daktiloskopik

Sot është një nga llojet me të perhapur të ekspertimit, madje është edhe me i preferuar për t'u aplikuar në krahasim me llojet e tjera për faktin e thjeshtë se është i pagabueshëm. Kjo saktesi e tij vjen fale precizitetit individualitetit dhe qendrueshmerise që

¹³⁹ Po aty

kanë gjurmet të cilat perbejnë objekt ekzaminimi e që janë gjurmet daktiloskopike(gjurmet e gishtave të dorës dhe gjurmet e kembeve).¹⁴⁰Fjala "gjurme" ka dy kuptime;

- në kuptimin e gjere ajo perfshin ndryshimet që kanë ndodhur në vendin ku është kryer vepra penale.
- në kuptimin e ngushte fjala "gjurme" perfshin ndryshime në vendin e kryerjes se veprës penale ku pasqyrohet struktura e jashtme e objektit që ka lenë ate.

Qëllimi kryesor i ekspertit në këtë rast është të individualizoj të identifikoj autorin e veprës penale bazuar në ekzaminimin krahasues të gjurmeve papilare që mund të jenë jenë në vendin e ngjarjes me ato që merren nga personi i dyshuar. Fakti që e bën ekspertimin daktiloskopik të pagabueshëm janë cilësite që karakterizojnë figurat papilare.

¹⁴¹Nuk ka figura papilare identike. Figura papilare e cdo gishti është individuale, madje edhe binjaket e vërtete që dallohen me vështiresi kanë figura papilare të ndryshme në gishtat. Është vërtetuar edhe fakti se gishti i gjashtë tek personal që kanë një anomali të tillë është i ndryshëm nga gishti i tjetër. Prandaj aksioma, sipas se cilës “kreshtat papilare” janë të pandryshueshme gjatë gjithë jetës se njeriut dhe individuale qëndron plotësisht e vlefshme sepse natyra nuk pushon kurrë se prodhuari ekzemplare të rinj. Në natyrë ka aq figura papilare të ndryshme nga njëra tjetra sa gishtat kanë njerëzit që jetojnë në tokë.

¹⁴²Figurat papilare nuk ndryshojnë gjatë gjithë jetës se njeriut. Ato formohen që në jetën intrauterinë, në muajin e katërt të femijes dhe vazhdojnë të qëndrojnë të pandryshueshme gjatë gjithë jetës se njeriut' duke përfshirë periudhën pas vdekjes.

¹⁴³Figurat papilare janë të rigjenerueshme. Ato rigjenerohen në rast demtimi. Figurat papilare nuk prishen. Ato rigjenerohen me të gjitha vecoritë posa të jetë zhdukur shkak i demtimit.

¹⁴⁴Gjurmet e gishtave dhe të pellembeve të duarve shfrytëzohen nga eksperti për tri qëllime kryesore:

- Për të identifikuar personin fajtor në bazë të gjurmeve të lena në vendin e ngjarjes.
- Për të vërtetuar se nga i njëjti person janë kryer disa vepra penale.

¹⁴⁰ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007

¹⁴¹ Po aty

¹⁴² Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 127

¹⁴³ Po aty

¹⁴⁴ Po aty- faqe 133

- Për të identifikuar kufomen e një personi të panjohur në rast se ky ka qenë regjistruar me pare penalisht.

Gjurmët e lëna nga duar janë të thelluara dhe të siperfaqshme. Gjurmët e thelluara formohen si rezultat i presionit që ushtron gishti në lende plastike, lende të cilat kanë veti të pasqyrojnë mikrorelievin e vijave papilare dhe ta ruajnë këtë pasqyrim edhe pas shkeputjes se dorës.¹⁴⁵ Gjurmët e siperfaqshme të ngjyrosura (të dukshme) formohen si rezultat i shkeputjes se lendeve të huaja që kanë duart dhe i vendosjes se tyre në objekte që preken nga fajtori. Gjurmët e këmbëve formohen gjatë levizjes se njeriut në ecje, në vrap, në kërcim. Gjurmët e këmbëve ndahen në gjurme të lëna nga këmbe e mbathur dhe gjurme të lëna nga këmbe e zbathur dhe të njëjtat janë statike e dinamike, të thelluara të siperfaqshme.

¹⁴⁶ Materialet që dergohen në ekspertimin daktiloskopik janë: objektet që mbajnë gjurmët e duarve apo të këmbëve ose pjese nga keto objekte, kur nuk është e mundur të dergohen vete objektet, për gjurmët e thelluara dergohen kallepet e gjurmeve me fotografite shkallezuese, për gjurmët e siperfaqshme kopja e gjurmeve të bartura në gjurmekopjues dhe fotografite shkallezuese; shenjat e personit të dyshuar mund të dalin edhe nga studimi i karteles daktiloskopike në qofte se ai ka qenë regjistruar penalisht me pare.

7.3.2 Ekspertimi kriminalistik (ekzaminimi i veglave të thyeries)

Gjurmët e veglave të thyerjes shfrytëzohen në hetimin dhe gjykimin e shume veprave penale, si vjedhje e pasurive e shoqeruar me përdorim dhunë.¹⁴⁷

Shfrytëzimi i ketyre gjurmeve ndihmon për të zgjidhur shume probleme, për të zbuluar mënyrën e ngjarjes, për të dalluar nëse thyerja ka ndodhur me të vërtete nga persona të jashtem apo ka simulim; ¹⁴⁸ për të kuptuar mënyrën e veprimit të fajtorit, mundesite e tij fizike, praktiken profesionale, për të percaktuar raste perseritje veprash penale, nga një person ose grup personash , për të bere identifikimin grupor apo individual të veglave të përdorura për thyerje dhe për të marrë masa profilaktike për sigurimin e pengesave të ndryshme.

Gjurmët që shqyrton eksperti në një rast të tille janë si me poshte:

¹⁴⁵ Po aty, faqe 134-135

¹⁴⁶ Po aty- faqe 145

¹⁴⁷ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 167

¹⁴⁸ Po aty

- Gjurmët e goditjes.
- Gjurmët e shtypjes.
- Gjurmët e ferkimit.
- Gjurmët e prerjes.
- Gjurmët e sharrimit.

7.3.3 Ekspertimi autoteknik

Është një lloj ekspertimi i cili merr një vlerë të madhe në rastet e veprave penale të cilat shkaktohen nga një automjet apo me ndihmën e një automjeti. Objekt ekspertimi në këtë rast janë gjurmët e lena nga pjesët levizëse; gjurmët e lena nga pjesët e tjera të automjetit; gjurmët që merr me vete automjeti nga vendi i ngjarjes. Qëllimi i ekspertimit në këtë rast është:

- Të përcaktoje llojin , tipin ose vete automjetin që mendohet se ka shkaktuar apo ka ndihmuar në realizimin e veprës penale.
- Të përcaktoje drejtimin nga ka ardhur dhe nga është drejtuar për t'u larguar shkuar mjeti.
- Të përcaktoje shpejtësinë me të cilën ka levizur automjeti (nëpërmjet studimit të gjurmëve të frenimit).
- Të përcaktoje se cili ka qenë reagimi i shoferit në momentin në të cilin ka ndodhur aksidenti dhe cka here ky i fundit për ta shmangur atë
- Të saktesojë se cili është pronari i mjetit etj...

Gjurmët më të shpeshta të mjeteve të transportit janë gjurmët e automjeteve

7.3.4 Ekspertimi balistik

Ky lloj ekspertimi studiohet në mënyrë të detajuar nga një degë e shkencës së kriminalistikës sikurse është balistika.

¹⁴⁹Balistika kriminalistike studion metodat e mjetet tekniko-shkencore për zbulimin, fiksimin dhe ekzaminimin e gjurmëve të lena nga armët e zjarrit, nga municionët që përdoren prej tyre, për identifikimin e armës së zjarrit në bazë të gjezhojes së predhës, si dhe

¹⁴⁹ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 192

metodat e mjetet për percaktimin e gjendjes teknike të armës së zjarrit dhe të fenomenëve të qitjes me qëllim që të zgjidhen probleme që lindin në hetimin e gjykimin e çështjes penale. Në ekspertimin balistik eksperti duhet të këtë njohuri të posaçme mbi armët e zjarrit, pjeset perberese të tyre, gjurmet që lenë ato në predhe e gezhoje.

Llojet e armëve të zjarrit të dorës me të perhapura janë: Revolet, pistoletat, automatiket, pushket.

Pjeset e armës që lenë gjurme në gezhoje e predhe janë: tyta, shuli, mekanizmi i shkrepjes, mekanizmi i nxjerrjes së gezhojave dhe kreheri.¹⁵⁰

¹⁵¹Materialet që dergohen për ekspertim, balistik kriminalistik janë: predha ose gezhoja, arma e cila dyshohet se ka bërë qitjen ose disa armëve të një lloji disa fisheke nga ato të vendit të ngjarjes. Për të percaktuar nëse vrima në një send është shkakuar me armë zjarri, nga çfarë armë zjarri, nga ç'largësi për ekspertimin, dergohen vetëm sendet që mbajnë gjurmet e qitjes ose pjeset e tyre perkatese. Eksperti në këtë rast ka si detyrë kryesore të tij identifikimin e armëve të zjarrit në bazë të gezhojave dhe predhave që janë zbuluar në vendin ku është kryer vepra penale, të percaktoje se cili është largësia e këndit apo drejtimi i qitjes, rrethanat e qitjes.

Në ekzaminimin krahasues eksperti krahason shenjat individuale të predhes dhe gëzhojes objekt ekspertimi me predhen apo gezhojen model krahasues. Në këtë ekspertim eksperti kërkon perputhjen e shenjave individuale dhe atyre të përgjithshme sipas madhësisë formës permasave sasisë dhe mikroreleievit të tyre. Ekspertimi balistik shërben edhe për një qëllim të dytë i cili është identifikimi i armës të përdorur për kryerjen e veprës penale duke u bazuar në evidentimin dhe berjen të dukshme të shenjave të cilat ndodhen në sipërfaqen e armës. Në sipërfaqen e armës behen mbishkrime të llojeve të ndryshme sikurse mund të jetë numri i serise së armës dhe të dhëna të tjera të fiksuara në momentin e fabrikimit të saj.

Në një vendim të saj gjykata e Tiranës ka adminstruar si provë aktet e ekspertirnit balistik nga të cilat rezultoi se, 9 (nëntë) gezhojat e gjetura në vend-ngjarje u perkasin fishekeve luftarake model 56, kaliber 7.62 mm që përdoren nga pushke, automatike dhe mitraloze të lehte model 66, kaliber 7.62 si dhe për pushken model 63, kaliber 7.62 mm.

¹⁵⁰ Po aty- faqe 200

¹⁵¹ Po aty- faqe 211

Gezhojat e sekuestruara janë të qitura nga një armë zjarri e vetme, që është automatik model 56, kaliber 7.62 mm.¹⁵²

7.3.5 Ekzaminimi i dokumenteve

Ekspertirni i dokumenteve është dy llojesh:¹⁵³

- Ekspertim teknik ka për detyrë evidentoje falsifikimin dhe të percaktoje rrethanat e plotësimit të dokumentit duke analizuar materialet e dokumentit.
- Ekspertim grafik ka për detyrë të identifikojë personin në bazë të doreshkrimit të tij dhe shkrimi.

Për t'u realizuar ky lloj ekspertimi me rëndësi është të studiohen shenjat dhe gjurmet e shkrimit të cilat ndryshe nga gjurmet balistike dhe traseologjike formohen nga bashkëveprimi i një sere faktoresh sikurse janë faktoret psikologjike e fizilogjike që lidhen me veprimtarinë e lartë nervore, me reflekse të kushtezuara, me stereotipin dinamik dhe me sistemin e sinjaleve të dyta.¹⁵⁴ Sinjalizimi është një proces i cili përfshin në vetvete dy procese sistemi i sinjaleve të para dhe sistemi i sinjaleve të dyta i cili në ndryshim nga sistemi i sinjaleve të para ka si ngacmues gjuhen dhe fjalet. Për sa i përket ekspertimit grafik pra identifikimit të shkrimit në bazë të shenjave eksperti duhet të jetë një njohës mjaft i mirë i shenjave grupore dhe shenjave individuale të shkrimit të cilat janë si me poshte (kuptohet që në këtë punim po i citoj shkurtimisht pa u ndalur gjatë në to por eksperti kriminalist duhet të këtë njohuri të specializuara e të thelluara për secilen prej tyre).

¹⁵⁵ Shenjat grafike të përgjithshme janë:

1. Perpunimi i cili pasqyron shkallën e zoterimit të teknikes se shkrimit. Është një shenjë që ndryshon në varesi të personave, personi që sapo ka filluar të shkruaje ka një shkallë shume të ulet të perpunimit.
2. Madhesia e cila pasqyron lartësinë mesatare të shkronjave. Kur kjo lartësi është me pak se 2mm atehere madhesia është e vogël. Madhesia është një shenjë që varet nga faktore të tjere një prej të cileve është shpejtësia e të shkruarit. Është venë re se me shtimin e shpejtësisë se të shkruarit zvogelohet madhesia e shkronjave. Sigurisht një konkluzion i tille nuk është kategorik pozitiv absolut.

¹⁵² Vendimi Nr 105, Datë 21.02.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁵³ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 230 dhe 234

¹⁵⁴ Po aty

¹⁵⁵ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 230

3. Shtrirja e një shkronjë percaktohet duke marrë si bazë raportin e gjerësisë dhe lartësisë së saj.
4. Pjerresia pasqyron kendin që formohet midis boshtit vertikal të shkrimit dhe rrjeshtit
5. Lidhja pasqyron aftësinë që ka një individ për të shkruar disa shkronja pa hequr mjedin e të shkruarit nga letra
6. Presioni pasqyron forcën cilën shkruesi ka ushtruar në leter gjatë procesit të shkrimit. Vlerë të madhe kanë edhe studimi i shenjave topografike sikurse është :
 - Vendosja topografike e tekstit
 - Vendosja e rreshtave
 - Vendosja e numrave
 - Nënvizimi i fjaleve apo fjaltjeve

Shenjat e veçanta të shkrimit janë ato që e individualizojnë me se shumti personin që e ka shkruar atë. Shenja të veçanta i shërbejnë ekspertit për të bërë ekzaminimin krahasues midis dokumentit objekt ekzaminimi dhe modelit i cili mund të jetë i lirë (në rastin kur është shkruar nga personi para fillimit të çështjes).

¹⁵⁶Model eksperimental të cilat organi procedues i mbledh në formën e diktimit, me kopjim (kur personit që dyshohet për një veprë penale i jepet urdher të kopjojë një tekst të cilin e cakton organi procedues), me shkrim.

Shenja të veçanta të shkrimit janë shenjat e mëposhtme:

- Ndertimi i shkronjave
- Drejtimi i lëvizjes së dorës gjatë ndertimit të grupshkronjave
- Pozicioni i pikës së fillimit dhe mbarimit të lëvizjes
- Menyra e mbarimit dhe fillimit të lëvizjes gjatë plotësimit të shkronjave
- Raportet e pjerresive dhe madhësive ndërmjet shkronjave
- Vecoritë e lidhjes së elementeve në shkronja
- Shkeputjet e dorës gjatë të shkruarit para ose pas shkronjave të caktuara.

Eksperti që cakton organi procedues për ekzaminimin e dokumentit e ka për detyrë të përcaktojë fillimisht se një individ e ka shkruar dokumentin me shkrimin e vet apo të ndryshuar (në rastin e falsifikimit të firmave) , dhe se dyti të përcaktojë se cili është personi që ka përpiluar një dokument të caktuar.

¹⁵⁶ Po aty- faqe 249

Nëse eksperti është caktuar nga organi procedues për të bërë ekspertimin teknik të dokumentit në këtë rast eksperti duhet të përcaktojë nëse në dokument ka elemente në të cilat ndihet prania e fshirjeve kimike apo mekanike, shtesa korrigjime të fjaleve apo fjalive, falsifikime të vulave stampave si dhe se fundi të arrij të bëjë të lexueshme përrnajtjen e një dokumenti të vjetër, të grisur, ose të djegur.¹⁵⁷

7.3.7 Ekspertimi biologjik

Është një lloj ekspertimi që ka vlerë të veçantë në veprat penale të plagosjes apo vrasjes, por jo vetëm. Eksperti në këtë rast ka njohuri të posaçme mjekesore pra zakonisht është një mjek i regjistruar dhe i licencuar për kryerjen e detyrës së ekspertit. Ai vepron me urdher të organit procedues dhe iu jep detyrimisht përgjigje të gjitha pyetjeve, që organi procedues i ka parashtruar për zgjidhje në procesverbalin drejtuar ekspertit. Pyetjet mund të jenë nga më të ndryshmet në varesi të rrethanave konkrete.

Nëse gjurme e gjetura në vendngjarje në ndonjë objekt apo në trupin e një personi janë gjurme gjaku?

Nëse lenda që u gjend në thike është gjak, cili është grupi i gjakut? A perputhet ky grup gjaku me atë të viktimes të veprës?

7.3.7 Ekspertimi mjekoligjor

Është një lloj i veçantë ekspertimi i cili realizohet nga një specialist në fushën e mjekesisë dhe synon të sqarojë rrethanat e mëposhtme:

- Cili janë demtimet e kufomes ?
- Cili është shkaku i vdekjes ?
- Sa kohe ka viktimë që ka nderruar jetë? Përsa i përket faktit se sa kohe ka që viktimë ka nderruar jetë eksperti mund të përdorë të dhëna të tilla si përsëmbull prania e ushqimit në stomak ose e urinës në fshikezen e urinës.
- Në ç'pozicion janë shkaktuar plaget?
- Karakteri dhe menyra e shkaktimit të plageve.

¹⁵⁷ Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina "Tiranë 2007, faqe 249

Po e konkretizoj vlerën e ekspertimit mjekoligjor me një rast konkret nga praktika gjyqesore. Ekspertimi mjekoligjor ishte një provë e domosdoshme për të plotësuar kërkesën e mbrojtjes se të pandehurit për të mos caktuar masën e arrestit me burg ,kështu kur ceshtja kaloi për rekurs në gjykatën e lartë me ¹⁵⁸vendimin me nr 2 datë 11.01.2008 kolegji penal i saj vlereson se fakti që shtetasi Gjini ka qenë e vijon të jetë në trajtim mjekesor për një sere semundjesh, nuk mund të interpretohet apriori si një rrethanë, që pengon caktimin e masës së sigurimit të parashikuar nga neni 232/dh i K.Pr.P. Është e vërtetë se dispozita e nenit 230/2 të K.Pr.P. ndalon vendosjen e masës së sigurimit personal "arrest në burg", nder të tjera, në kushtet kur personi ndodhet në një gjendje veçanërisht të rëndë, porse në rastin konkret sa me lart nuk rezulton të jetë e provuar. Situata shendetësore e individit ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit personal, çertifikohet në rrugë procedurale nga ana e ekspertizës perkatese shendetesore, që duhet të konkludojë në terma të qarte në lidhje me venien në rrezik të shendetit nga zbatimi i masës së sigurimit personal.

¹⁵⁹Në një vendim të gjykatës së rrethit Tiranë është administruar si provë një akt ekspertimi mjeko ligjor i kufomave në bazë të të cilit ka rezultuar se, në kufomen e skeletizuar të shtetasit Guxim Demaj u konstatuan thyerje të vërtebres së pare torakale, të brinjës së shtatë të djathtë dhe ngrenie të brinjës së tete të djathtë. Keto demtime duhet të jenë shkaktuar nga qitja me armë zjarri në trupm e viktimes .Shkaku i vdekjes duhet të këtë genë shoku i rëndë traumatik si pasoje e demtimeve me armë zjarri.

7.3.8 Ekspertimi kimik e toksikologjik

Janë dy kategori të ekspertimit të cilat konsistojnë në percaktimin e substancave kimike që ndodhen në perberje të një produkti në këtë rast kemi të bëjmë me ekspertim kimik i cili gjen përdorim në rastin e helmimeve. Ndërsa ekspertimi toksikologjik vlereson nëse një substance ka në perberje të saj lende narkotike apo toksike, në praktiken gjyqesore mendimi i ekspertit toksikologjik vjen për të percaktuar jo vetëm nëse kemi të bëjmë me substance narkotike por edhe për të vlerësuar nëse sasia e lëndës narkotike është apo jo doze e vogël aq sa i pandehurit të mos jetë ligjerisht përgjegjës për një veper penale.

¹⁵⁸ Vendimi Nr 2 , Datë 11.01.2008 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

¹⁵⁹ Vendimi Nr 473, Datë 29.03.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës se Lartë, me ¹⁶⁰vendimin nr. 1 datë 27.03.2008 kanë arritur në perfundimin se për shkak të njohurive të posaçme që kërkohen në fushën e toksikologjise, gjykata për zgjidhjen e çështjes që lidhet me sasinë e lendes narkotike të nevojshme për përdorim vetjak duhet të therrase në çdo rast specialiste të fushes, si toksikologe apo mjeke terapiste, mendimi shkencor i të cileve do të shërbeje si njëri prej kritereve ku ajo dote mbështetë arsyetimin e vendimit të saj.

Bazuar në sa me sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës se Lartë, çmojnë se:

“Përdoruesi i lendeve narkotike, i cili e mban atë jo për përdorim vetjak, qofte edhe në doza të vogla, kur është shpërndaresh i saj në një nga format që parashikon neni 183/n i K.Penal, ka përgjegjësi penale sipas kësaj dispozite. Çmojnë gjithashtu se, përcaktimi i dozës së vogël të lendes narkotike e psikotrope, për efekt të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të K.Penal, duhet të bëhet me ndihmën e specialistëve të fushës (toksikologe, etj.), të thirrur si eksperte dhe rast pas rasti, jo vetëm sipas llojit të lendes narkotike e psikotrope, por edhe të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së vartesisë nga droga të personit konkret-mbajtes i lendes narkotike dhe psikotrope”

7.4 Ekspertimi i detyrueshëm

Po ta trajtoja këtë pikë në një kuptim të ngushtë do të permendja faktin që për sa kohe organi procedues e sheh të nevojshme për kryerjen e një ekspertimi, kjo provë duhet të merret detyrimisht. Në këtë kuptim cdo ekspertim do të ishte i detyrueshëm.

Në një trajtim më të gjërë të kësaj problematike do të thoja që vërtete kur organi procedues e sheh të nevojshme për kryerjen e një ekspertimi, kjo provë duhet të merret detyrimisht por vetëm në rastet që e çmon ai një ekspertim duhet kryer detyrimisht. Në këtë kuptim jo cdo ekspertim do të ishte i detyrueshëm. Në kodin tonë të procedurës atë aktual nuk ekziston një dispozite ligjore që të përcaktojë se kur organi procedues e ka të detyrueshme të urdherojë kryerjen e ekspertimi. Aktualisht është vetëm doktrina që e evidenton një problematike të tillë.

Megjithatë ¹⁶¹një dispozite të tillë e gjejmë të sanksionuar në K.PrP e 1953 i cili edhe pse ishte kodi i parë që merrej me rregullimin e çështjeve proceduriale duket se në këtë pikë

¹⁶⁰ Vendimi Nr 1, Datë 27.03.2008 Kolegjet e bashkuara të Gjykatës se Lartë

¹⁶¹ Tartale Fatmir, "Ekspertimi në të drejtën procedurale penale në R.Sh", Tiranë 1999

është mjaft koherent .Në nenin 70 të tij percaktohen rastet kur ekspertimi duhet të jetë i detyrueshëm(raste të cila aplikohen edhe sot në të njëjtën mënyrë).

Janë të detyrueshme për tu kryer: ¹⁶²

-Ekspertimi për të percaktuar shkaqet e vdekjes si dhe realizimin e plageve.

Ky lloj ekspertimi njihet ndryshe me emrin autopsi. ¹⁶³Autopsia është e detyrueshme kur ka dyshim se viktima është vrare helmuar e ka pësuar vdekjen jo për shkaqe natyrale.

Mund të ndodhe që personi që është sulmuar nuk ka vdekur por ka pësuar plagë të rënda,edhe në këtë rast ekspertimi është i detyrueshëm. Në praktiken gjyqesore ka raste kur si rezultat i administrimit si provë të aktit të ekspertimit të ndryshoje cilësimi juridik i veprës nga plagosje e rëndë me dashje në vrasje të mbetur në tentative, kështu edhe ¹⁶⁴vendimi nr 11 datë 16.01.2008 i kolegjit penal të gjykatës se lartë. Në dy gjykatat e tjera ate të rrethit Tropoje dhe në gjykatën e apelit Shkoder i pandehuri është shpallur fajtor për veprën plagosje e rëndë me dashje. Prokuroria ka paraqiti rekurs në Gjykatën e Lartë, Prokurori i Apelit Shkoder, ka pretenduar se, ndryshimi i cilësimit ligjor të veprës nga vrasje e mbetur në tentative, në plagosje të rëndë me dashje, është i gabuar, pasi sipas rekursit, vepra penale e vrasjes në dem të të demtueses Dushe ka mbetur në tentative jo për shkaqe të varura nga ai, por për shkak se reagimi i saj në momentin e goditjes ka qenë i menjëhershëm dhe i shpejtë, si dhe për shkak të goditjes se autorit, prej saj, me shqelma, pretendime, të cilat Kolegji Penal i kësaj Gjykate i gjen të bazuara, si në aktet e dosjes, ashtu edhe në ligj. Bazuar në aktin e ekspertimit mjekoligjor duke pare pjesen e trupit në të cilën i gjykuari kishte arritur të godiste me thike (para se ajo të fillonte reagimin kunder tij dhe nderhyrjes se dëshmitarit Greg) të demtuesen dhe gravitetin e plages që ajo mori. Ky Kolegj arriti në perfundimin se, me veprimet e kryera prej tij i gjykuari ka konsumuar elementet e figures se krimit të vrasjes me dashje, mbetur në tentative, parashikuar nga ¹⁶⁵neni 76 i K.Penal, në lidhje me nenin 22 të tij, krim për të cilin ishte edhe kërkesa e prokurorisë paraqitur në gjykatë për gjykimin e tij.

- Ekspertirni që vlen për të percaktuar moshën e vogël të të pandehurit kur një e dhenë e tillë konsiderohet e pamundur për tu evidentuar.

¹⁶² Po ayt

¹⁶³ Ligji nr. 7830 datë 25.06.1994 "Për autopsinë" në R.SH

¹⁶⁴ Vendimi Nr 11, Datë 16.01.2008 Kolegji Penal i Gjykatës se Lartë

¹⁶⁵ Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009

- Ekspertimi që shërben për të përcaktuar gjendjen psikike të të pandehurit kur lindin dyshime për përgjegjësinë e tij.
- Ekspertimi që shërben për të konstatuar pjekurinë seksuale në rastin e krimeve që lidhen me mardheniet seksuale

Jam e mendimit se një dispozite e tillë duhet të përfshihet edhe në kodin aktual të procedurës.

Eksperti është personi që zoteron njohuri në fushën e shkencës artit apo teknikes dhe për marrjen me shkrim të mendimit të tij disponon me urdher prokuroria dhe me vendim gjykatë. Kjo e drejtë i njihet edhe policisë gjyqësore sipas nenit 294/3 të KPrP. 167. Në nenin 181 përcaktohet se organi procedues disponon ekspertimin me vendim të motivuar, i cili përmban caktimin e ekspertit, paraqitjen e përmbledhur e të çështjes, tregimin e dites, të ores dhe të vendit të caktuar për paraqitjen e ekspertit. Organi procedues urdheron thirrjen e ekspertit dhe merr masat e nevojshme për paraqitjen e personave që i nënshtrohen ekspertimit. Vendimin e tij për caktimin e ekspertit organi procedues ua komunikon të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Ky është një detyrim i organit procedues, sepse i pandehuri nuk është i detyruar të pranojë ekspertin që ka zgjedhur organi procedues,¹⁶⁶ i pandehuri ka keto të drejta:

- Të paraqesë përpara organit procedues kërkesa për konstatimin e fakteve që kanë rëndësi për zgjidhjen e drejtë të çështjes
- Ai ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e ekspertit,
- Të propozojë eksperte të tjere,
- Të marrë pjesë vete në ekspertim
- Të parashtrojë pyetje për ekspertin kur është e mundur.
- Të kërkojë caktimin e ekspertit nga grupi i personave që i sheh si të arsyeshëm
- Ka të drejtë që të kërkojë nga eksperti shpjegime (dy pikat e fundit nuk i parashikonte kodi i vitit 1953)

Më sipër theksova se në lloje të ndryshme ekspertimesh kusht për të qenë ekspert është zotërimi i njohurive specifike të fushave perkatese, kodi i procedurës përcakton në një

¹⁶⁶ По аты

mënyrë eksplicite në një dispozite me vete kushtin mospermbushja e të cilit e bën një ekspertim të një eksperti të tille të pavlefshëm.¹⁶⁷ Kushti thellesor që percakton kodi është: Eksperti të zgjidhet ndërmjet personave që janë regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në degen perkatese.

Në lidhje me këtë kusht mund të them se sistemi ynë ligjor është pak vakant.¹⁶⁸ Me i detajuar është kodi francez i cili në nenin 157 sanksionon mënyrën e zgjedhjes së ekspertit. Ekspertet zgjidhen nga listat në të cilat janë percaktuar ernrat e tyre. Në të sanksionohet se caktimi i listave të eksperteve behet nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e shkallës së dytë dhe prokurori. Të njëjtin qëndrim mban edhe kodi ynë i procedurës penale por në ndryshim nga kodi procedural penal francez, legjislacioni ynë nuk ka një dispozite ku të percaktohen kushtet teknike apo profesionale si dhe kualifikimet që duhet të zoterojë një person për t'u përfshirë në kështu listë.

Është e rëndësishme të saktësojmë edhe rrethën e personave të cilët nuk mund të jenë ekspert. Në bazë të nenit 180 të kodit të procedurës penale:

- Nuk mund të kryejë detyrën e ekspertit i mituri,
- Ai që ka ndalim ligjor
- Atij të cilit i është hequr zotesia juridike për të vepruar ose vuan nga një sëmundje mendore
- Ai që është pezulluar, qofte edhe perkohesisht, nga detyrat publike ose nga ushtrimi i një profesioni
- Ai, ndaj të cilit janë marrë masa sigurimi personal
- Ai që nuk mund të pyetet dëshmitar apo të merret perkthyes ose që ka të drejtë të mos bejë dëshmi ose perkthim.

Rrethana të tjera të cilat bejnë që një person të mos marrë persiper rolin e ekspertit ose të përjasohet nëse gabimisht ka kryer një ekspertim janë edhe :

1. Mardheniet e varesisë apo mardhenie zyrtare punë që ky person ka me subjekte të tjera të procedimit penal. Një rrethanë e tilla shërben si rrethanë e papajtueshme me detyrën e ekspertit nisur nga cenimi që i behet parimit të pavarësisë së ekspertit.
2. Kur eksperti është në të njëjtin proces konsult teknik.

¹⁶⁷ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009

¹⁶⁸ Tartale Fatmir, "Ekspertimi në të drejtën procedurale penale në R.Sh", Tiranë 1999

3. Kur eksperti nuk është kompetent për të kryer këtë detyrë.
4. Kur ka rrethana të tjera që tregojnë se eksperti është i interesuar që çështja të këtë një zgjidhje të caktuar.

Ekspertimi nuk mund të jetë absolut pra i lejueshëm për të sqaruar çdo element, ka raste kur ai nuk lejohet.¹⁶⁹ Këto raste përcaktohen në kod (neni i 78) në një dispozite që është shteruese dhe nuk le vend për hapesire interpretimi

Nuk lejohen ekspertimet për të përcaktuar profesionizmin në veprën penale (në lidhje me të mund të vendose vetëm gjykata), prirjet kriminale (eksperti nuk mund të jape mendim mbi këtë element pasi ai nuk mund të jetë i përcaktueshëm në mënyrë precize të pagabueshme), karakterin dhe personalitet e të pandehurit dhe në përgjithësi cilësite psikike që nuk varen nga shkaqet patologjike.¹⁷⁰ Ekspertimi për shkaqe të ndryshme mund të shpallet i pavlefshëm në këtë rast mund të zhvillohet një ekspertim i ri.

Një interes të veçantë paraqesin shkaqet e papajtueshmerise me funksionin e ekspertit, të cilat po i kategorizoj në pese grupe⁻¹⁷¹

- Shkaqe që lidhen me personin e thirrur si ekspert.
- Shkaqe që lidhen me gjendjen gjyqesore të ekspertit.
- Shkaqe që lidhen me profesionin.
- Shkaqe që lidhen me perfitime ligjore.

Kur ekziston një shkak përjashtimi, eksperti është i detyruar ta deklarojë (në momentin që organi procedues e pyet ate nëse ka shkaqe përjashtimi nga detyra e ekspertit) me përjashtim të rastit, kur shkaqet kanë lindur aty për aty ose janë njohur me pas, para se eksperti të këtë dhenë mendimin e tij

7.5. Të drejtat e ekspertit¹⁷²

- Eksperti ka të drejtë të njihet me materialet e çështjes. Eksperti mund të autorizohet nga ligji që të shohe aktet dokumentet dhe gjithcka që përfshihet në fashikullin e prokurorit apo të gjykatës për tui përgjigjur kërkesave të ekspertimit.

¹⁶⁹ Tartale Fatmir, "Ekspertimi në të drejten proçedurale penale në R.Sh", Tiranë 1999

¹⁷⁰ Kodi i Proçedurës Penale i Republikës se Shqipërise, Botim i QPZ, Tiranë 2009

¹⁷¹ Tartale Fatmir, "Ekspertimi në të drejten proçedurale penale në R.Sh", Tiranë 1999

¹⁷² Kodi i Proçedurës Penale i Republikës se Shqipërise, Botim i QPZ, Tiranë 2009

- Eksperti mund të autorizohet edhe të marrë pjese në pyetjen e paleve dhe marrjen e provave. Keto të dhëna që kërkon eksperti nga i pandehuri apo persona të tjere përdoren vetëm për qëllime të ekspertimit.(neni 184 i KPrP)
- Eksperti ka të drejtë të refuzojë dhenien e mendimit. Por në momentin që ai pranon të kryejë ekspertimin ka detyrën të kryejë ekspertimin në praninë e paleve apo konsulentin teknik e këtë detyrë ta kryejë me përgjegjësi

7.6. Struktura dhe forma e mendimit të ekspertit

Kur eksperti kryen ekzaminimin në fund të tij jep mendimin i cili duhet të jetë patjetër me shkrim.¹⁷³ Ketu duhet të veme një theks të madh sepse nëse mendimi nuk jepet me shkrim atehere ai nuk mund të përdoret si provë në një proces penal. Në një vendim të gjykatës së rrethit Elbasan i pandehuri Erion Latja u shpall i pafajshëm për krimin e prodhimit dhe shitjes së narkotikeve të parashikuar nga neni 283/1 i kodit penal vendimin e pafajësisë për të gjykuarit Erion, gjykata e shkallës së parë e bazoi në përjashtimin ligjor që permban dispozita e nenit 283 i K.Penal, sipas të cilit kur substanca narkotike është për përdorim vetjak dhe në doza të vogla, pavaresisht se në kundërshtim me ligjin, nuk perben vepr penale, argument që u përdor edhe nga gjykata e apelit. Si provë për të vërtetuar faktin që përdorimi ishte për konsum personal shërbeu "ekspertiza" shpjegimet e specialistes Bruci të bera para gjykatës, sipas të cilave 12.3; 8.8 dhe 11.3 gr. të kësaj bime shërbejnë për përgatitjen e 6-7 cigareve (sasi kjo, sipas specialistes, e mjaftueshme për konsum ditor nga secili prej tyre), e bazoi në përjashtimin ligjor që permban dispozita e nenit 283 i K.Penal, sipas të cilit kur substanca narkotike është për përdorim vetjak dhe në doza të vogla, pavaresisht se në kundërshtim me ligjin, nuk perben vepr penale, argument që u përdor edhe nga gjykata e apelit. Kjo çështje kaloi për rekurs në gjykatën e shtatë e cila me ¹⁷⁴ vendimin nr.12 datë 16.01.2008 të kolegjit penal konkludoi se vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit janë të pabaza. U arrit në përfundimin e mesipër, pasi sikurse rezulton nga aktet, përfundimi i gjykatave lidhur me kuptimin e rrethanave ligjore të "përdorimit vetjak" dhe atij "në doza të vogla", prania e të cilave pas sjell mungesës së përgjegjësisë penale për personin që, në kundërshtim me ligjin, mban

¹⁷³ Tartale Fatmir, "Ekspertimi në të drejtën procedurale penale në R.Sh", Tiranë 1999

¹⁷⁴ Vendimi Nr 12, Datë 16.01.2008 Kolegji Penal i Gjykatës së Shtatë

substance narkotike, u arrit prej tyre vetëm mbi bazën e konkluzioneve sipërfaqesore të bera në seancën gjyqësore, nëpërmjet shpjegimeve verbale të saj, nga specialistja toksikologe Z.Bruci, për pyetjen e se cilës, megjithëse në procesverbalin gjyqësor (fq.44) figuron në rolin e ekspertes, nuk figuron që të jenë respektuar kërkesat e dispozitave të neneve 179, 185 etj (vendimi i organit procedues për caktimin, mendimi i ekspertit jepet me shkrim, etj.). Pamjaftueshmeria e konkluzioneve të specialistes se permendur behet me evidente po të kihet parasysh fakti që nuk janë permendur prej saj argumente të dokumentuara shkencore që i perkasin fushes se toksikologjise në përgjithësi dhe asaj të efekteve të përdorimit të substancave narkotike nga individët konkrete që janë venë para përgjegjësisë penale në çështjen objekt gjykimi, në veçanti, argumente, të cilat ky Kolegj çmon se duhet t'i referohen jo vetëm karakterizimit të përgjithshëm relativ të fortesisë apo dobësisë, në raport me drogat e tjera të bimes Cannabis Sativa. Kolegji çmon se ato duhet t'i referohen edhe karakteristikave individuale të secilit prej të gjykuarve, si moshes, gjendjes shëndetësore e sociale, kohezgjatjes se "vesit" të përdorimit të substancave të kësaj natyre, momenteve sipas gjendjes shpirtërore kur ata i përdorin ose jo ato etj, për secilin prej tyre, në veçanti, kërkesa keto, të cilat duhet të gjejnë pasqyrim të hollësishëm në pjesën argumentuese, mbi bazën e se cilës arrihet në konkluzionet përfundimtare (kategorike ose jo) që duhet të përmbajë akti i ekspertimit për të patur vlerën e provës në një proces të rregullt penal.

Prandaj, bazuar në sa me sipër, ky Kolegj shtron para gjykatës që do të rigjykojë çështjen, detyrën që ekspertimi për të arritur nëpërfundime sa me të bazuara në aspektin shkencor, duhet të behet nga një grup specialistesh të fushës, të cilet duhet t'u japin përgjigje, me akt të shkruar, pyetjeve të drejtuara, atyre po me akt (vendim për caktimin e ekspertimit) të shkruar nga ana e gjykatës.

¹⁷⁵Kur janë caktuar me shume se një eksperte dhe kanë mendime të ndryshme secili parashtron me akt të veçantë mendimin e tij .(Është fjala për ekspertimet komplekse të cilat si rregull caktohen mbi bazën e një vendimi të vetëm edhe pse formohen nga ekzaminime të vecanta.)

¹⁷⁵ Kodi i Proçedurës Penale i Republikës se Shqipërise, Botim i QPZ, Tiranë 2009

¹⁷⁶Një problem tjetër është shfaqur në lidhje me faktin që mendimi i ekspertit të jetë i përqendruar veten në çështje faktike apo edhe juridike. Në këtë drejtim ka pasur teori nga me të ndryshmet . Ka teorinë që perkrasin mendimin e dytë dhe që synojnë të zgjerojnë fushën e veprimit të ekspertit.

7.7 Mendimi i ekspertit, kategorik apo probabel?

Lidhur me faktin se mendimi i ekspertit duhet të jetë kategorik apo probabel autore të ndryshëm kanë mendime të ndryshme. Shumica e autoreve perkrasin idenë se mendimi i ekspertit duhet të jetë kategorik sipas tyre. ¹⁷⁷Mendimet e eksperteve duhet të shprehen në forme kategorike megjithëse karakteri kategorik i tyre nuk garanton sigurinë dhe vërtetësinë e tyre. Mendimet e e bazuara në probabilitet nuk duhen lejuar pasi janë të demshme dhe nuk kanë asnjë vlerë provuese."

¹⁷⁸Autoret që perkrasin qëndrimin pro ndaj mendimit probabel të ekspertit japin arsyet e mëposhteme pse e perkrasin këtë formë mendimi

- Mendimi mund të jetë probabel për shkak se materialet objekt ekzaminimi mund të mos jenë të mjaftueshëm
- Shkenca mund të mos jetë aq e zhvilluar sa ti japë zgjidhje çdo problem
- Ekspertit nuk i janë parashtruar drejt pyetjet.
- Kualifikimi shkencor i ekspertit nuk është në nivelin e duhur. Mendimi i ekspertit përfshin:
 - a) Të dhëna mbi personin që do të kryejë ekspertimin vendin, ditën, orën, ku do të zhvillohet ekzaminimi.
 - b) Të dhënat mbi të cilat është mbështetur eksperti për realizimin e ekspertimit.
 - c) Rregullat që ka zbatuar eksperti gjatë procesit.
 - d) Konkluzionet mbi rrethanat e faktet për të cilat kërkohej sqarim.

Mendimi me shkrim i ekspertit mund të shoqërohet me fotografi ose materiale të tjera. Kodi i procedurës penale të Republikës së Shqipërisë bën rregullimin ligjor edhe të situatës kur faktet janë komplekse. ¹⁷⁹Kur faktet e janë komplekse dhe eksoertet nuk mund të japin

¹⁷⁶ Sahiti Ejup "Dëshmia e dëshmitarit si provë në procesin penal" , Prishtinë 1993,faqe 276

¹⁷⁷ Tartale Fatmir, "Ekspertimi në të drejten procedurale penale në R.Sh", Tiranë 1999

¹⁷⁸ Po aty

¹⁷⁹ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009

përgjigje menjëhere organi procedues i jep atij një afat jo me të gjatë se 60 dite për të dhënë vlerësimin e tij. Kur ka nevojë për verifikime vecanërisht komplekse ky afat mund të zgjatët edhe me shume se një here për periudha jo me të gjata se tridhjetë dite, por pa kaluar afatin maksimal prej gjashtë muajsh.

Kodi proçedurës ka parashikuar mundësinë e zëvendësimit të ekspertit :

1. Kur eksperti nuk jep mendimin e vet në afatin e caktuar
2. Në rastin kur eksperti nuk jep mendimin e vet në afatin e caktuar kërkon zgjatje të afatit por kërkesa e zgjatjes nuk pranohet
3. Kur eksperti nëglizhon në kryerjen e detyrës
4. Kur pranohet kërkesa për përjashtimin e një eksperti ai atëhere do të zëvendësohet me një tjetër.

Ligji është mjaft korrekt në këtë pike pasi organi procedues e merr vendimin për përjashtimin e ekspertit vetëm pasi është degjuar dhe vete eksperti me pare.¹⁸⁰Eksperti i zëvendësuar mund të denohet me gjobe deri në dhjetërnije leke. Eksperti i zëvendësuar detyrohet të dorëzojë në organin procedues dokumentacionin dhe rezultatet e veprimit të kryer.

8. Provat material dhe dokumentet

¹⁸¹Prova materiale janë sendet që kanë një nga karakteristikat e mëposhteme:

- Sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale.
- Sendet mbi të cilat gjenden gjurme të veprës penale.
- Sendet që kanë qenë objekt i veprimit të të pandehurit.
- Produktet e veprës penale dhe i çdo lloj pasurie që lidhet me të apo që lejohet të konfiskohet.
- Çdo send tjetër që mund të ndihmojë në sqarimin e rrethanave të çështjes dhe zgjidhjen e drejtë të saj.

¹⁸²Përsa i perket dokumenteve që shërbejnë si provë në një proçes penal i klasifikojme si më poshtë:

¹⁸⁰ Po aty

¹⁸¹ Po aty

¹⁸² Elezi Ferdinand, "Provat penale" Tiranë 2008

- Dokumentet që perbajnë në vetvete provë materiale të cilat gjenden nëpërmjet mjeteve të kërkimit të provave sikurse është fotografimit, filmimit, fonografimit ose cdo mjeti tjetër.
- Dokumentet në të cilat pasqyrohet rezultatet e përgjimit të bisedave të cilat do t'i trajtoj hollësisht në vijim të punimi.
- Proçesverbalet dhe aktet proçedurale të çështjeve gjyqesore qofshin keto penale apo civile.
- Dokumentacioni i mbajtur për veprimet të cilat nuk mund të perseriten.
- Cdo dokument në të cilin pasqyrohen rezultatet e fotografimit, filmimit, fonografimit për fakte persona apo sende të caktuara.
- Vendime gjyqesore të formes se prerë.
- Dokumente që lidhen me personalitetin e të pandehurit, të të demtuarit apo të dëshmitarit.

¹⁸³Që dokumentat të përdoren si provë duhet e respektohen rregullat e mëposhtëme:

1. Nëse dokumentat janë në gjuhe të huaj ata duhet të perkthehen.
2. Dokumentat që përdoren si provë nuk mund të jenë anonime (të jetë evidentuar burimi i marrjes se dokumentit). Për sa i perket dokumentave anonime mund të përdoren si provë vetëm nëse perbejnë provë materiale ose janë bere nga i pandehuri.
3. Nuk mund të përdoren si provë dokumenta të falsifikuar.

Për sa i perket provave materiale ato:

- Duhet të pershkruhen hollësisht në proçesverbal
- Kur ekziston mundesia fotografohen ose filmohen dhe me urdher të organit procedues i bashkohen fashikullit gjyqësor.
- Provat materiale nuk mund t'i kthehen personave që iu perkasin keto sende në asnjë rast madje edhe nëse keto sende rrezikojnë të prishen (në një rast të tille keto sende i dorezon enteve të ndryshme për përdorim).

Për konkretizim po permend ¹⁸⁴një vendim të gjykatës se Tiranës e cila administron si provë dokumente si me poshte:

Fajsia e të pandehurit provohet plotësisht me deklarimet e tij, si dhe me provat shkresore

¹⁸³ Kodi i Proçedurës Penale i Republikës se Shqipërise, Botim i QPZ, Tiranë 2009

¹⁸⁴ Vendimi Nr 573 , Datë ! 2.04.201 I Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

- deklarate verbale shitje automjeti datë 08.01.2007;Shkrese nr.7595/1 prot datë 27.11.2008 nga Drejtoria Kunder Krirnit të Organizuar; Shkrese derguar Departamentit për Kufirin dhe Migracionin; Flete e printuar nga sistemi ASF2 i Interpolit për mjetin me nr.shasie WAUZZZ8Z23A028427 datë 13.01.2010; si dhe me prova të tjera të administruara në fashikullin e gjykimit.

8.2 Ç'ndodh me provat materiale pasi çështja perfundon?¹⁸⁵

Për këtë ligji shprehet në mënyrë kategorike në nenin 190 në një dispozite që është shteruese e taksative.

Në vendimin perfundimtar ose në atë të perfundimit të çështjes gjykata ose prokurori caktojnë se cdo të ndodhe me provat materiale duke urdheruar:

- a) Sendet që kanë sherbyer ose që ishin caktuar si mjet për kryerjen e veprës penale dhe sendet që perbejnë perfitimin e nxjerre nga ajo ose shperblimin e dhenë atë premtuar për kryerjen e saj , merren dhe i kalojnë shtetit , përveç rasteve kur keto sende janë të personave që nuk kanë marrë pjese në kryerjen e veprës penale
- b) Sendet mbajtja apo qarkullimi i të cilave është i ndaluar u dorezohen enteve perkatese ose zhduken
- c) Sendet që nuk kanë asnjë vlere zhduken
- d) Sendet e tjera u kthehen personave që iu takojnë dhe kur ka konflikt për pronësinë e tyre ruhen derisa ky konflikt të zgjidhet nga gjykata.provat materiale mund të kthehen personave që iu takojnë edhe para mbarimit të procedimit, nëse nuk demtohet zgjidhja e çështjes.

Kodi ynë i procedurës është mjaft tolerant në përdorimin e dokumentave si prove, ai i jep mundësinë paleve që në rast se e kanë të pamundur të marrin dokumentin origjinal për shkaqe objektive sic është rasti i humbjes zhdukjes apo djegjes se dokumentit të merret kopja e tij . Keto dokumente mund të merren cilidoqofte personi që i ka krijuar apo i mban.

Referuar Vjetarit Statistikor të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Diber,Republika e Shqipërise,rezulton kjo dinamike e eshtjeve penale të gjykuara dhe në proces gjykimi në pese vitet e fundit:

VITI 2009

¹⁸⁵ Kodi i Proçedurës Penale i Republikës se Shqipërise, Botim i QPZ, Tiranë 2009

Çështje të regjistruara gjithsej:	202	Të perfunduara: 160
		Të paperfunduara: 42
Nga keto:		
a)Krime të regjistruara gjithsej:	115	Të perfunduara: 91
		Të paperfunduara: 24
b)Kundravajtje penale të regjistruara gjithsej:	87	Të perfunduara: 69
		Të paperfunduara: 18

VITI 2010

Çështje të regjistruara gjithsej:	206	Të perfunduara: 158
		Të paperfunduara: 48
Nga keto:		
a)Krime të regjistruara gjithsej:	112	Të perfunduara: 85
		Të paperfunduara: 27
b)Kundravajtje penale të regjistruara gjithsej:	94	Të perfunduara: 73
		Të paperfunduara: 21

VITI 2011

Çështje të regjistruara gjithsej:	239	Të perfunduara: 210
		Të paperfunduara: 29
Nga keto:		
a)Krime të regjistruara gjithsej:	119	Të perfunduara: 99
		Të paperfunduara: 20
b)Kundravajtje penale të regjistruara gjithsej:	120	Të perfunduara: 111
		Të paperfunduara: 9

VITI 2012

Çështje të regjistruara gjithsej:	191	Të perfunduara: 169
		Të paperfunduara: 22

Nga keto:		
a)Krime të regjistruara gjithsej:	114	Të perfunduara: 97
		Të paperfunduara: 17
b)Kundravajtje penale të regjistruara gjithsej:	77	Të perfunduara: 72
		Të paperfunduara: 5

VITI 2013

Çështje të regjistruara gjithsej:	174	Të perfunduara:119
		Të paperfunduara: 55
Nga keto:		
a)Krime të regjistruara gjithsej:	88	Të perfunduara: 70
		Të paperfunduara: 18
b)Kundravajtje penale të regjistruara gjithsej:	86	Të perfunduara: 49
		Të paperfunduara: 37

Të dhënat në tabelat e mesiperme pershijnë veprat penale të ndodhura në rrethin Diber dhe rrethin Bulqize, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Diber është riorganizuar në vitin 2007, ku në juridiksionin tokesor i janë shtuar edhe veprat penale që janë kryer në rrethin Bulqize, që me pare ka ekzistuar si gjykatë me vete.

Nisur nga sa me siper mund të themi se duke pasur parasysh numrin e eshtjeve të regjistruara për gjykim pranë kësaj gjykate,rezulton se në vitet 2009, 2010 dhe 2011, ato kanë ardhur në rritje, ndersa në vitin 2012 e me pas 2013, keto kanë ardhur duke renë ,renie e cila është e paperfillshme. Pra duhet thënë se verehet një tendence e njëjtë kriminaliteti në 5 vje arin e fundit.

Gjithashtu nga të dhënat rezulton se kemi tendence rritje të veprave penale në fushën e ekonomise dhe krimet ndaj jetes.

Fenomeni aq i perhapur i gjakmarrjes në Shqipëri, në rrethin Diber nuk është evident,me përjashtime të rralla dhe pa peshe statistikore.

Përqindja e aplikimit të llojeve të ndryshme të provave sipas viteve:

Nr.	Llojet e provave	Perqindja e aplikimit të tyre sipas viteve				
		2009	2010	2011	2012	2013

1	Dëshmia	25%	23%	22%	28%	27%
2	Pyetja e tepandehurit dhe pyetja e paleve private	20%	23%	21%	20%	19%
3	Ballafaqimi	20%	21%	20%	22%	20%
4	Njohja	2%	2%	2%	2%	2%
5	Eksperimenti	1%	1%	1%	2%	2%
6	Ekspertimi	15%	16%	17%	16%	14%
7	Provat materiale	15%	12%	15%	8%	14%
8	Dokumentat	2%	2%	2%	2%	2%

Si rezulton nga të dhënat e hedhura në tabelat e mesipërme, peshën më të madhe në proceset penale të zhvilluara gjatë 5 vje arit të fundit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër e zenë llojet e provave që kanë të bejnë me "dëshminë e të pandehurit", me pas vjen "pyetja e të pandehurit" gjatë procesit penal, "ballafaqimet", "eksperimentet" dhe "provat e tjera materiale" që shoqerojnë materialin kallezues të derguar nga organi i akuzës për të vërtetuar veprën penale dhe provat e tjera që krijohen nga gjykata seance pas seance.

PROVA TË TJERA

1. Vlera provuese e rezultateve të perftuara nga përgjimi dhe regjistrimi i fshehtë i bisedave.

Në kategorinë e provave, përfshihen rezultatet e keqyrjes kontrollimeve, sekuestrimeve dhe përgjimit, që nuk percaktohen në mënyrë eksplicite në kod në kapitullin mbi llojet e provave por që përdoren si prova. Keqyrja, kontrollimi, sekuestrimi dhe përgjimi janë mjete të marrjes së provës pra burim provë, ndërsa rezultatet e tyre shërbejnë në procesin penal si provë. Secili nga veprimet e mësipërme hetimore e gjyqesore ka karakteristikat e veta dhe rezultatet e tyre kanë një rol të rëndësishëm në zbulimin e të vërtetës, por në vijim do të trajtoj gjerësisht përgjimin dhe rezultatet e tij, roli i tyre në procesin provues. Një zgjedhje e tillë vjen së pari për shkak të vecantise që ka përgjimi si mjet provë dhe rezultatet e perftuara nga ai si provë në procesin penal. Së dyti me duket interesant trajtimi i rezultateve të përgjimit si lloj provë për, shkak të debateve të ndryshme që ka pasur mbi lejimin e përdorimit të tyre (konflikti që ka ky përdorim me të drejtën e jetes private dhe të drejtën e fshehtësisë së korrespondencës, të drejta të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.)¹⁸⁶Përgjimi rregullohet gjerësisht nga Kodi i Procedurës Penale, i cili përfshin nën këtë koncept veprimet e mëposhteme:

- Përgjimin e përmbajtjes së komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni me telefon, faks, kompjuter ose me mjete të tjera të çdo lloji,
- Përgjimi i fshehtë me mjete teknike i bisedave në vende private,
- Përgjimi me audio dhe video në vende private
- Regjistrimi i numrave të telefonit, hyres dhe dales, dhe regjistrimi i tyre (në fakt në këtë rast nuk kemi të bëjmë me përgjim në kuptimin juridik sepse ky lloj regjistrimi mund të bëhet nga operatori telefonik për të qenë korrekt me abonentin e këtij operatori telefonik dhe për këtë nuk ka nevojë për vendim gjykatë

¹⁸⁷Bazuar në (neni 221) veprimet e permendura me sipër lejohen vetëm kur procedohet; për krimet e kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo me pak, në maksimum, se shtatë vjet; për kundërvajtjet penale të fyerjes e të kanosjes, të

¹⁸⁶ Islami Halim, Hoxha Artan, Panda Ilir "Procedura penale" Morava, Tiranë 2007, faqe 317

¹⁸⁷ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009, neni 221

kryera me mjete të telekomunikimit. Përgjimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike dhe përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes lejohen vetëm kur procedohet për krime të kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se dy vjet.

¹⁸⁸ **1.1 Cilët janë subjektet nën “shënjestrën” e përgjimit?**

- Të dyshuarit për kryerjen e një veprë penale;
- Personat që dyshohen se merr ose transmeton komunikime nga i dyshuari; personat që marrin pjesë në transaksionë me të dyshuarin;
- Personat, vezhgimi i të cileve mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose të identitetit të të dyshuarit.

1.2 Përdorimi si provë i rezultateve të përgjimit

Kjo është një problematike evidente dhe e pranishme në shoqëritë demokratike në të cilat të drejtat dhe liritë themelore të individit jo vetëm që garantohen nga ligji, por përbejnë shtyllën e zhvillimit të vetë ligjit. Përdorimi i rezultateve të përgjimit si provë ve në rrezik të drejtat themelore të tij sikurse është e drejta për një jetë private apo e drejta e fshehtësisë së korrespondencës. Megjithatë ekziston një rrezik i tillë ligji u jep mundësinë paleve të përdorin të dhënat e perfituara me këtë mënyrë por vetëm brenda kushteve të cilat vete ai i përcakton qartë. Rezultatet e përgjimit nuk mund të përdoren nëse shkelen dispozitat që përcakton kodi mbi kufijtë e lejit të përgjimit dhe përdorimit të rezultateve të përdorimit të tij.¹⁸⁹ Rrjedhimisht rezultatet e përgjimit mund të përdoren si provë vetëm nëse përgjimi është zhvilluar sipas dispozitave të ligjit (në haza të nenit 221 dhe 222 të KPrP si më poshtë):

- a) Për lejimin e përgjimit ka dhënë vendim gjykata pas kërkesës së prokurorit apo të proceduarit. Vendimi për përgjimin tregon mënyrën e kryerjes dhe kohezgjatjen e veprimeve, e cila nuk mund t'i kalojë pesëmbëdhjetë ditët. Ky afat, me kërkesë të prokurorit, mund të zgjatët nga gjykata sa herë është e nevojshme. Vetëm në raste përjashtimore, kur ka arsye të bazuara për të menduar se nga vonësa mund t'i vijë një dëm i rëndë i hetimeve, prokurori vendos përgjimin me akt të motivuar dhe

¹⁸⁸ Po aty

¹⁸⁹ Po aty

njofton gjykatën menjëhere, por jo me vonë se njëzet e kater ore. Gjykata Brenda dyzet e tete oreve nga vendimi i prokurorit bën vleftehimin me vendim të arsyetuar.

- b) Përgjimi është lejuar vetëm për veprat penale të percaktuara në ligj
- c) Përgjimi është realizuar me anë të mjeteve teknike të cilat janë në kontrollin e prokurorit
- d) Përgjimi është zhvilluar për shkak se ai ka qenë i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara dhe kur ka pasur prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës.
- e) Në rastet e përgjimit në vende publike, regjistrimi i numrave të telefonit hyres dhe datës, si dhe përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes të këtë dhenë autorizim prokurori.

Jo të rralla kanë qenë vitet e fundit rastet kur rezultatet e përgjimit janë administruar si provë në një proces gjyqësor. Në ¹⁹⁰vendimin me nr. 1105 dt 07.11.2007 të gjykatës se shkallës se pare të rrethit Tiranë, në dosjen gjyqësore janë administruar transkriptimet e një sere përgjimeve të bisedave telefonike arnbientale, si dhe kopje të dokumentacionit të procedurave tenderuese, të cilat me të drejtë janë vleresuar nga gjykata se provojnë ekzistencen e dyshimit të arsyeshëm se shtetasi Spartak

1.3 Rastet kur rezultatet e përgjimit nuk mund të përdoren si provë

Më sipër theksova se përgjimi është një mjet për marrjen e provës në lejinin e të cilit gjykata tregohet e kujdesshme.(për arsyet e mesiperme). Për pasoje përgjimi lejohet vetëm në raste të caktuara, për vepra të percaktuara dhe ndaj subjekteve të caktuar. Në lidhje me këtë mund të them se në keto raste nuk mund të perftohen fare rezultatet sepse përgjimi nuk është i lejuar kështu që nuk lind fare problematika nëse duhet apo jo të përdoren rezultatet e përgjirnit. Secilen nga keto pika e trajtova në mënyrë specifike. Por mund të ndodhe ge është lejuar me vendim gjykate apo autorizim të prokurorit përgjimi e rrjedhimisht prej tij janë perftuar rezultate, e megjithate jo gjithmonë rezultatet e perftuara nga një përgjim mund të përdoren si provë në një procedim penal. KPrP përcakton shprehimisht rastet kur rezultatet e përgjirnit nuk mund të përdoren si provë.

Raste të cilat do ti grupoja në tre kategori:¹⁹¹

¹⁹⁰ Vendimi Nr 1105, Datë 07.11.2007 i Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁹¹ Kodi i Proedurës Penale i Republikës se Shqipërise, Botim i QPZ, Tiranë 2009, neni 226

- Raste të cilat lidhen me mosrespektimin e ligjit, neni 226 i KPrP percakton qarte se rezultatet e përgjimit nuk mund të përdoren kur janë bere jashte rasteve të lejuara nga ligji ose kur nuk janë respektuar dispozitat e ketij saksioni
- Raste të cilat lidhen me llojin e përgjimit Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si provë(neni 226 i kodit të procedurës)
- Raste të cilat lidhen me subjektet ndaj të cileve është urdheruar përgjimi. Po në të njëjtin nën percaktohet se nuk mund të përdoren përgjimet e bisedave ose të komunikimeve të atyre që janë të detyruar të ruajnë sekretin për shkak të profesionit apo detyrës, me përjashtim të rasteve kur keta persona kanë deponuar mbi të njëjtat fakte ose i kanë perhapur në ndonjë mënyrë tjetër.

Rezultati i përgjimit është i vlefshëm në të githe komunikuesit (neni 226 KPrP)

2. Regjistrimi i fshehtë i bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve, vlera e tyre provuese dhe raporti me përgjimin

Në fillim të temës unë theksova faktin se provat i klasifikonim në kategorite e meposhteme:

- 1. Provat që parashikohen në mënyrë të drejteperdrejte në kod të cilat renditen në kod në seksionë të vecanta si me poshte:**
 - Dëshmia
 - Pyetja e të pandehurit dhe pyetja e paleve private
 - Ballafaqimi
 - Njohja
 - Eksperimenti
 - Ekspertimi
 - Provat materiale
 - Dokumentat
- 2. Provat që nuk kanë një rregullim ligjor po për të cilat gjykata jep autorizimin për marrjen e tyre ¹⁹² - provat atipike (në nenin 15 I të tij se kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj gjykata mund të marrë në qoftese ajo vlen për të vërtetuar faktet dhe**

¹⁹² Islami Halim, Hoxha Artan, Panda Ilir "Procedura penale" Morava, Tiranë 2007, faqe 242

nuk cenon lirinë e vullnëtit të personit). Ku perfshihen fotografimet, filmimet, deklarimet e provokatorit apo të infiltruarit në krimet kunder trafikimit të narkotikeve etj.

Në kategorinë e provave atipike bejnë pjese edhe rezultatet e perfituara nga regjistrimi i fshehtë i bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve.¹⁹³ Në ligjin federal amerikan rregulli 1001 njeh si provë edhe origjinalet e e dokumenteve regjistrimeve, fotografive. Psh origjinali i një fotografie është negativi ose printimi i saj. Njihen si prova edhe videokasetat, letrat, regjistrimet mekanike ose elektronike dhe cdo forme tjeter e njëjtë me to.

2.1 A mund të themi se regjistrimi i bisedes mes të pranishmeve perben përgjim?

Duhet të theksoj se kjo është një pyetje që ka jo vetëm vlere teorike por me tepër ka vlere praktike. Nëse regjistrimi i bisedes mes të pranishmeve do të konsiderohej përgjim atehere do të duhej që për të përdorur rezultatet e ketij lloj regjistrimi, të zbatoheshin dispozitat e kodit të procedurës penale në lidhje me përgjimet nenet 221-e në vijim. Në fakt regjistrimi i bisedes mes të pranishme nuk konsiderohet përgjim.

Dallimet që ekzistojnë ndërmjet tyre janë :¹⁹⁴

Se pari- në rastin e përgjimit kemi të bëjmë me regjistrimin e bisedes pa dijeninë e bashkëbiseduesve ndersa kur kemi të bëjmë me regjistrimin e bisedes nga njëri prej të pranishmeve njëri nga personal është në dijeni të regjistrimit.

Se dyti- përgjimi mund të realizohet vetëm pasi për këtë ka dhenë autorizim gjykata ose prokurori kurse për realizimin e regjistrimit të bisedes nga njëri prej të pranishmeve nuk ka nevojë për një autorizim të tille

Se treti- përgjimi ekzekutohet nga oficeri i policise gjyqesore ndersa regjistrimi ekzekutohet nga një person privat.

Se katerti - përgjimi kryhet me pajisje teknike të instaluar në vende të caktuara .Keto pajisje janë të autorizuar dhe të kontrolluara nga prokurori i rrethit, regjistrimi i fshehtë i bisedimeve dhe komunikimeve kryhet nga personi privat me mjete teknike të cilat i ka siguruar vete dhe që nuk kontrollohen nga prokurori.

¹⁹³ Federal rules of evidence(For united states courts), West publishing company, St Paul 1993, faqe 180

¹⁹⁴ Cano Mirela, "Viera provuese e regjistrimit të fshehtë të bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve", revista nr.2 "Jeta juridike" shkolla e magjistraturës, Tiranë ,dhjetor 2007, faqe 101

Regjistrimi i fshehtë i bisedimeve apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve mund të zhvillohet ose me mjetet teknike të vete personit që bën regjistrimin ose me anë të mjeteve teknike që i ofrohen atij nga persona të trete.

2.2 A mund të merren dhe të përdoren si provë në procesin penal, rregjistrimi i fshehtë i bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve?

Në momentin që trajtova këtë lloj provë me siper theksova se përfshihet në kategorinë e provave atipike. Pra është një provë që nuk parashikohet shprehimisht në kod por për të cilat gjykata jep autorizimin për marrjen e tyre me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhteme:

a) Në qoftese ajo vlen për të vërtetuar faktet

a) Nuk cenon lirinë e vullnëtit të personit

Kodi i procedurës penale e bën rregullimin ligjor të provave atipike në nenin 151/3. Rrjedhimisht regjistrimi i fshehtë i bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve si provë atipike nëse i plotëson keto kushte lejohet të merret dhe të administrohet si provë në seancën gjyqësore por futja e kësaj provë në proces bëhet vetëm në cilësinë e një dokumenti fotografik. Edhe pse është një lloj provë të cilën kodi nuk e parashikon shprehimisht regjistrimi i fshehtë mund të merret si provë, vetëm nëse nuk shkel ndalimet që përcakton ligji për llojet e tjera të provave.

Në lidhje me lejimin e marrjes së kësaj provë duhet të theksoj se kjo është një risi që sjell kodi i 1995 sepse kodet e procedurës penale të mëparshme nuk lejonin marrjen e provave atipike. Për shëmbull në kodin e vitit 1979 parashikoheshin në mënyrë taksative provat që lejoheshin të merreshin dhe nuk ekzistonte një dispozite që lejonte të merreshin prova të parregulluara me ligj. Për më tepër në kodin e 1979 nuk mund të perceptohej si lloj dokumenti fotografia, shirit magnetik apo filmik, kaseta fonografike etj.

Kaseta fonografike, e shoqëruar ose jo me pamje filmike,¹⁹⁵ përfaqëson një fakt ashtu siç ka ndodhur në një moment të caktuar dhe nuk bën gjë tjetër veçse përforcon atë që bashkëbiseduesi e ka fiksuar me anën e shqises së degjimit dhe që mund ta riprodhojë me anën e mekanizmit të kujtesës në formën e dëshmës.

¹⁹⁵ Cano Mirela, "Vlera provuese e regjistrimit të fshehtë të bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve", revista nr.2 "Jeta juridike" shkolla e magistraturës, Tiranë, dhjetor 2007, faqe 103

Pra kemi të bëjmë me një provë të ligjshme e cila nuk cenon aspak ¹⁹⁶nenin 32/2 të kushtetutes as nenin I 51/4 të kodit të procedurës penale sipas të cilit nuk mund të përdoren provat e marra në shkelje të ndalimeve të ligjit. Mjaft që të mos këtë cenuar lirinë e vullnëtit të personit që regjistrohet . Nuk kemi të bëjmë me cenim të lirise se vullnëtit të ketij personi në rastin kur ky i fundit nuk ka dijeni për regjistrimin . Kjo është një provë që cmohet nga gjykata në unitet me provat e tjera.

2.3 Qëndrimi që mban KEDNJ për këtë lloj provë, raporti me nenin 8 të konventes.

Pyetja që i vjen nder mend çdo juristi është: "A kemi cenim të nenit 8 të konventes europiane për të drejtat e njeriut". ¹⁹⁷Neni 8 i KEDNJ. percakton se: "Cdo njëri ka të drejten për respekt për jeten e tij private dhe familjare, 2. Një autoritet publik nuk nderhyn ndaj kushtimit të kësaj të drejtë, përveçse kur kjo është në përputhje me ligjin dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurimit kombëtar, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalimin e çrregullimeve ose krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave" .

Një e drejtë e tillë garantohet edhe në vendin tonë. Legjislacioni ynë i cili e ka adoptuar konventën në vitin 1995 ka harmonizuar ligjet e tij në përputhje me këtë konventë. Madje në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë garantohet në nenin 36 të saj edhe: "Liria dhe fshetësia e korrespondencës ose e cdo mjeti tjetër komunikimi dëshmi. Për me tepër shoqëritë e sotme demokratike e sistemet e tyre ligjore bazohen në parimin e efektit horizontal e vertikal të të drejtave të njeriut, sipas të cilit keto të drejta duhet të respektohen jo vetëm nga autoritet shtetërore por dhe nga individët. Për të gjykuar nëse regjistrimi i fshehtë i bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve si provë atipike përben shkelje të nenit 8 të konventes gjykata se pari duhet të shqyrtojë nëse rrethanat e faktit apo mjedisit ku është realizuar regjistrimi përbejnë apo jo "jetë private". Se dyti nëse arrijnë në konkluzionin që kemi të bëjmë me nocionin jetë private ,gjykata duhet të shqyrtojë nëse ekziston një nga shkaqet që perligjin regjistrimin.

Vete neni 8 i KEDNJ percakton se në rrethana të vecanta autoriteti mund të nderhyjë ndaj kushtimit të kësaj të drejtë

¹⁹⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998, Tiranë 2008, neni 32/2

¹⁹⁷ Cano Mirela, "Vlera provuese e regjistrimit të fshehtë të bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve", revista nr.2 "Jeta juridike" shkolla e magistraturës, Tiranë ,dhjetor 2007, faqe 105

1. Kur kjo është në perputhje me ligjin dhe
2. Kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurimit kombëtar, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalimin e crregullimeve ose krimin, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave.

Dy rrethanat e mesiperme janë kumulative. Pra duhet të ekzistojnë të dyja njëkohësisht në mënyrë që regjistrimi i fshehtë të mos konsiderohet në kundërshtim me neni 8 të konventës.

Për sa i përket qëndrimit që ka mbajtur GJEDNJ mund të themi që ajo nuk është shprehur konkretisht në lidhje me regjistrimin në rrethana të tilla por ajo ka pranuar¹⁹⁸ se përgjimi i bisedës ndërmjet dy ose me shumë personave përben nderhyrje në të drejtën për jetë private dhe është i justifikueshëm vetëm në bazë të nenit 8/2 të konventës. Për sa i përket regjistrimit të bisedës nga një person i pranishëm nuk mund të thuhet apriori apo ekzaktesisht që përben ose jo shkelje të nenit 8. Gjykata duhet të vlerësojë rast pas rasti.

¹⁹⁹Sipas gjykatës së Strasburgut nocioni "jetë private" përben një koncept të gjere dhe përfshin një sferë mbrenda të cilës çdokush mund të ndjeke lirshëm zhvillimin dhe plotësimin e personalitetit të tij. Kjo e drejtë përfshin, në njëfarë shkalle edhe të drejtën për të vendosur marrëdhënie me qeniet e tjera njerëzore. Regjistrimi i bisedës nga njëri prej të pranishmeve, e cila sjell të dhëna të një veprë penale të kryer nga personi i regjistruar, nuk përben aspekt të jetës private të individit. Në këtë rast, nuk regjistrohet një aspekt i jetës private të individit, por një aspekt i jetës së tij publike. Me vullnetin e tij të lire, personi që regjistrohet i ndan faktet e bisedës me personin që kryen regjistrimin dhe ky i fundit nuk bën gjë tjetër, vetse regjistron një bisedë në të cilën është vetë i pranishëm. Personi që regjistrohet duhet ta mendonte që bashkëbiseduesi i tij mund të deshmojë kundër tij për ato që ka degjuar personalisht, ose që mund të bëjë një regjistrim audiofilmik.

²⁰⁰Por tërësisht ndryshe do të dispononte gjykata me vendim për regjistrimin nga personi i pranishëm të bisedave intime që po zhvillonte me një person tjetër, në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të nenit 8 të konventës. Në këtë rast në vendin tonë personi që

¹⁹⁸ Cano Mirela, "Vlera provuese e regjistrimit të fshehtë të bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve", revista nr.2 "Jeta juridike" shkolla e magistraturës, Tiranë, dhjetor 2007, faqe 106

¹⁹⁹ Po aty

²⁰⁰ Cano Mirela, "Vlera provuese e regjistrimit të fshehtë të bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve", revista nr.2 "Jeta juridike" shkolla e magistraturës, Tiranë, dhjetor 2007, faqe 109

kryen regjistrimin do të përgjigjej në perputhje me nenin 121 të kodit penal për veprën penale të "Ndërhyrjes së padrejtë në jetën private".

Regjistrimi i bisedës është i ligjshëm dhe mund të përdoret nga prokuroria për qëllime hetimi, por nuk duhet të publikohet përpara se personi nën hetim të jetë venë në dijeni të permbajtjes së këtij regjistrimi.

Një regjistrimi i fshehtë i bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve është i ligjshëm edhe nëse biseda është e provokuar nga personi që ka bërë regjistrimin.

KAPITULLI I PESTË

ANALIZË KRAHASIMORE ME KODIN E PROÇEDURËS PENALE TË ITALISE

Me mjaft rëndësi me duket trajtimi që i bën kodi i proçedurës penale (italianë) kapitullit të provave. Paraprakisht me duhet të them se diferencat mes kodit tonë dhe atij italian janë pothuajse inëkzistente kjo për vete faktin që kodi ynë i proçedurës penale në gjithë përrnbajtjen e tij është bazuar në kodin italian të proçedurës penale.

KPrP Italian i trajton provat në kapitullin e trete të tij .Fillimisht trajton sikurse dhe kodi ynë dispozita të përgjithshme. Dispozita e pare që lidhet me insitutin e provës është ajo që percakton objektin e provave. Pote bëjmë një krahasim me kodin tonë proçedural do të veme re se kodi ynë jep fillimisht në nenin 149 kuptimin e ketij insituti.²⁰¹Kurse kodi Italian nenin e pare në lidhje me këtë insitut ia dedikon (neni 187) objektit të provave. Në këtë kod trajtimi është identik me nenin 150 të kodit tonë sipas të cilit janë objekt provë faktet që kanë lidhje me akuzën, fajesinë e të pandehurit, caktimin e masave të sigurimit, denimin dhe përgjegjësinë civile, si dhe faktet nga të cilat varet zbatimi i normave proçedurale.

KPrp Italian që në fillim ndryshe nga kodi ynë në pjesën e dispozitave të përgjithshme rithekson një parim të rëndësishëm.²⁰²Në nenin 188 theksohet se nuk mund të përdoren qofte edhe kur palet japin pelqimin metoda e teknika të cilat janë të afta të influencojnë në proçesin e të kujtuarit apo të vleresuarit të fakteve. Ky është një parim mjaft i rëndësishëm garant i një proçesi të rregullt ligjor. Edhe në kodin tonë proçedural ky është një parim që vlen për marrjen e cdo lloj provë por nuk percaktohet qarte në një dispozite me vete. Kodi Italian percakton në pjesën e dispozitave të përgjithshme provat të cilat nuk janë të rregulluara me ligj, në bazë të nenit 189 të kodit proçedural Italian këto prova mund të merren vetëm nëse shërben për të vërtetuar fakte dhe nuk cenon lirinë e vullnëtit të personit. Neni 190 i kodit KPrP Italian sanksionon se, gjykata vendos me urdher duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë haptazi të panevojshme disponimet mbi marrjen e provave mund të revokohen në cdo faze të shqyrtimit gjyqësor. Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren, ku papërdorueshmeria ngrihet edhe kryesisht në cdo gjendje dhe shkalle të procedimit në perputhje me nenin 191 të kodit Italian të proçedurës penale. Në lidhje me nenin 191 të kodit të proçedurës italianë vlen të permendet edhe komentet e dhëna nga autori Italian

²⁰¹ Codice di procedura penale e leggi complementari a cura di Giustino Gatti (magistrato) , Edizioni Simonè 1995, art. 187

²⁰² Po aty, art. 188

²⁰³Conso Grevi sipas të cilit neni 190 thekson se provat merren me kërkesen e paleve. Kjo dispozite thote ai nënvizon një parim të rëndësishëm me karakter të përgjithshëm, i cili merr një vlerë të njëjtë në të gjitha fazat e procedimit. Nga ky parim rrjedh rregulla sipas të cilës gjyqtari nuk mund të marrë prova me iniciativën e tij përveç rastit kur ligji i njeh atij e drejten të marrë prova edhe kryesisht.

Pra kemi të bëjmë me tipare të një sistemi jo inkuizitor. Por sikurse edhe për sistemin tonë ligjor nuk mund të themi se sistemi ligjor Italian është nie sistem ligjor i paster akuzator sepse roli i gjyqtarit nuk është tërësisht pasiv por ai mund në raste specifike të urdherojë marrjen e provave të reja.

Edhe në kodin shqiptar trajtimi mbi arsyet e papërdorshmerise , përjashtimit të provave të paligjshme apo të panevojshme, rastet kur lejohet marrja e provave të cilat nuk rregullohen me ligj apo destinacioni i provave të marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara në ligj, është identik me kodin italian. Ndryshimi qendron vetëm në faktin se është një dispozite e vetme që i specifikon keto raste perkatesisht neni 151 pikat 2,3,4 ndersa kodi italian e trajton secilen nga problematikat me siper në nene të vecanta.

Në pjesen e posaçme të ketij kreu në të dy kodet parashikohen llojet e provave (të cilat janë identike në të dy kodet)

- dëshmia
- pyetja e të pandehurit dhe pyetja e paleve private
- ballafaqimi
- njohja
- eksperimenti
- ekspertimi
- provat materiale
- dokumentat

Kodi italian sikurse dhe kodi ynë e rendit dëshminë të paren në llojet e provave por kjo jo për sa i perket rëndësisë se vleres provuese të saj .Në këtë pike legjislacioni italian është i qarte duke theksuar parimin që provë "regina probatum" nuk ka. Asnjë provë nuk ka vlerë percaktuese(mbizoteruese).

²⁰³ Grevi Conso, Breviaria Iuris commentario breve al nuovo codice di procedura penale, CEDAM, Padova , 1994

Neni 194 i kodit procedural italian perkon me nenin 153 të kodit tonë sipas të cileve²⁰⁴ Dëshmitari pyetet për faktet objekt akuze, për faktet që perbejnë objekt prove. Legjislacioni Italian (behet fjale për kodin e procedurës penale) ashtu sikurse dhe kodi ynë nuk e specifikon se çfarë të dhënash dote perbejnë objekt dëshmie. Doktrina është me specifike në këtë drejtim, në doktrinë theksohet se një bisede telefonike e regjistruar dhe e transkriptuar nuk perben dëshmi të vlefshme gjatë gjykimit por është ligjerisht e vlefshme gjatë fazes se hetimeve paraprake në zbatim të nenit 351 të KPrP italian.

Dëshmitari nuk mund të deshmoj për qëndrimin moral të të pandehurit përveçse kur ceshtja ka të beje me fakte që vlejné për percaktimin e personalitetit të tij në lidhje me veprën penale dhe me rrezikshmerinë shoqerore. Dëshmitari pyetet për mardhenien që ka me të pandehurin apo persona të tjere të permendur gjatë dëshmise. Në bazë të nenit 153 të KPrP pyetja e dëshmitarit mund të shtrihet edhe në mardheniet e farefisnise dhe të interesave që ekzistojné nderrnjët dëshmitarit dhe paleve apo dëshmitarëve të tjere, si dhe mbi rrethanat, vërtetimi i të cilave është i nevojshëm për vleresimin e besueshmerise se tij. Dëshmia mbi faktet që sherbejnë për të percaktuar personalitetin e të demtuarit nga vepra penale pranohet vetëm kur akuza e të pandehurit duhet të cmohet në raport me sjelljen e të demtuarit. Dëshmitari pyetet për fakte të caktuara, ai nuk mund të deshmoje për cka flitet në publik dhe as të shprehe vleresime personale, me përjashtim të rasteve kur ato nuk mund të ndahen nga dëshmia për faktet.

²⁰⁵Të gjitha rregullat e permendura me siper janë kushte që duhet të plotësoje një dëshmi në mënyrë që e konsiderohet e vlefshme. Në komentarin e kodit të procedurës penale të autorit Conso Grevi theksohet se është në pushtetin diskrecional të gjyqtarit e drejta për të

interpretuar dhe vleresuar deshrninë dhe për të zgjedhur nderrnjët tyre, mjaft që interpretimi dhe vleresimi që ai bën të mos bjere në të meta juridike e logjike e në shtremberime si dhe gjyqtari të jetë i kujdesshëm për dhenien e perligjeve të pershtatshme në momentin e vleresimit. Pra i gjithë proçesi i vleresimit është në diskrecionin e gjyqtarit. Por nëse vleresimi i tij nuk është i drejtë atehere ky fakt mund të denoncohet nga gjykata e kasacionit si një e mete në dhenien e vendimit nëse ky vendim është në kundërshtim me

²⁰⁴ Grevi Conso, Breviaria Iuris commentario breve al nuovo codice di procedura penale, CEDAM, Padova, 1994

²⁰⁵ Po aty

kushtet e siperpermendura ose me logjiken. Deponimi i dëshmitarit duhet të ketë koherence të mjaftueshme logjike dhe një perpikmeri të pershtatshme. Vetëm nëse keto kërkesa nuk janë plotësisht të pranishme në një dëshmi, ose kur ato vijnë në kundërshtim me elementet e tjera të provave, apo dëshmite përmbajnë arsye të ndjeshmerise e fyese ndaj të pandehurve , gjyqtari me të drejtë duhet të japë llogari me argumente të perputhshme e pa gabime logjike të zgjedhjes që ka bërë në bazë të besueshmerise që atij i atribuohet.

I njëjtë në të dyja legjislacionët është edhe trajtimi i dëshmise indirekte. Neni 195 i Kodit të procedurës italiane në këtë pikë është identik me nenin 154 të kodit tonë. Sipas neneve të sapo permendura nëse dëshmitari shprehet se faktet i njeh si rezultat i kontaktit që ka pasur me persona të trete atëhere me kërkesë të pales por edhe kryesisht gjykata urdheron që edhe këta të thirren për të dëshmuar. Nëse një kërkesë e tillë nuk respektohet atëhere janë të pavlefshme të gjitha thëniet mbi faktet të cilat ai i ka mesuar nga persona të tjerë . Me përjashtim të rastit kur ata janë të pamundur për t'u pyetur për shkak se kanë vdekur janë të semure rëndë ose nuk gjenden. Në këtë rast dëshmitari nuk mund të pyetet për faktet që i ka mesuar nga persona që janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional apo shtetëror me përjashtim të rastit kur këta persona kanë deklaruar për të njëjti fakt me perpare ose i kanë përhapur ato me ndonjë mënyrë tjetër.

Nuk mund të përdoret dëshmia e atij që refuzon ose që nuk është në gjendje të tregojë personin ose burimin nga të cilet ka marrë dijeni për fakte që pyetet.

Po të shikojmë me kujdes do të veme re se edhe kodi Italian i kushton një rëndësi të veçantë tregimit të burimit të informacionit(një dëshmi është e pavlefshme nëse nuk është evident burimi nga është marrë informacioni) janë tri nene të kodit italian ²⁰⁶nenet 200, 201 dhe 202 që e quajnë të vlefshme edhe këtë lloj dëshmie por vetëm nëse një informacion i tillë ehte i pamundur për tu dhënë për shkak të profesionit apo obligimit për të ruajtur sekretin(kodi ynë i rregullon keto problematika në nenet 159 dhe 160 të tij). ²⁰⁷Neni 200 i kodit të ri italian të procedurës penale ka adoptuar një disiplinë me të rregullt dhe të artikuluar me mirë të sekretit profesional. Në këtë nën janë cilësuar sakte kategorite e profesionëve që nuk mund të tregojnë të dhëna që përbejnë sekret profesional dhe të cilet nuk do të merren parasysh nga neni 351 sikurse janë gazetaret .Neni 200 është një nën që

²⁰⁶ Codice di procedura penale e leggi complementari a cura di Giustino Gatti (magistrato) , Edizioni Simonè 1995

²⁰⁷ Commento al nuovo codice di procedura penale coordinato da Mario Chiavario UTET

shërben si garanci i nenit 2 të kodit të procedurës italiane .Keta persona nuk janë të detyruar të deshmojnë për sa kanë mesuar nga profesioni (permendim ketu rastin e gazetareve të cilet i cili nuk mund të tregojë burimin e informacionit.)Kodi italian është i kujdesshëm edhe për sa i perket percaktimit të kategorise se personave që janë të zote për të deshmuar. Në nenin 196 të tij ai sakteson se këtë zotesi e ka cdo person.²⁰⁸Në komentarin e kodit Italian të procedurës C.Grevi shkruan se aftesia është një kërkesë që është e domosdoshme në rastin e administrimit të pasurise apo për të vlerësuar pasojat e akteve të ndryshme me fuqi juridike. Aftesia është e domosdoshme akoma me shume kur behet fjale për veprime që për të qenë të rrjedhshme kërkojnë ekzistencen e itegritetit fizik apo ate mendor. Doktrina Italianë nuk e konsideron shkak absolut për përjashtim nga aftesia për të deshmuar paaftesinë mendore jo të qendrueshme dhe marrjen e lendeve narkotike nga ana e një personi. Marrja nga ana e paleve e substancave të tilla rruund të vendose palet perpara përgjegjësisë në aspektin disiplinor, po nuk mund kurrësi të ndikojë në mundësinë e tyre për të deshmuar. Singëriteti i një dëshmitari, edhe pse ky i fundit është i shëndetshëm menderisht, nuk përben garanci të besueshmerise se deponimit të dhenë nga ai ,qofte për shkak të një gabimi të mundshëm të bere me mirëbesim , qofte për shkak të ndonjë interësi të mundshëm hipotetik. Pra perfundimiisht është gjithmonë i nevojshëm një vërtetirn objektiv i vërtetesisë se dëshmise.

Kur për vlerësimin e thënieve është i nevojshëm verifikimi i aftesive fizike ose mendore për të bere dëshmi gjykata edhe kryesisht mund të urdherojë verifikimet perkatese. Kodi percakton qarte edhe 2 kategori të tjera subjektesh:

Persona të cilet nuk mund të pyeten si dëshmitarë (nuk duhet të pyeten) këtë kategori dëshmitarësh e trajton në nenin 197 të tij. Ky nën bën një trajtim pothuajse identik me nenin 156 të kodit tonë sipas të cilit nuk mund të pyeten dëshmitarë:

1. Personat që , për shkak të metash fizike apo psikike , nuk janë në gjendje të bejnë dëshmi të rregullt
2. Të pandehurit në një veper penale të perbashkët ose në një procedim të lidhur edhe kur ndaj tyre është dhenë vendimi i mosfillimit të çështjes, i pafajesisë ose denimit me përjashtim të rastit kur vendimi i pafajesisë ka marrë forme të prerë

²⁰⁸ Cadice di procedura penale e leggi complementari a cura di Giustino Gatti (magistrato) , Edizioni Simonë 1995

3. Ata që në të njëjtin procedim kryejnë ose kanë kryer funksionin e gjyqtarit apo prokurorit.

4. I padituri civil

Kodi italian sjell vetëm një ndryshim pikerisht në piken e tretë. Sipas kodit italian²⁰⁹ nuk mund të pyeten dëshmitarë: "Ata që në të njëjtin procedim kryejnë ose kanë kryer funksionin e gjyqtarit apo prokurorit ose atë të ndihmësit të tyre."

²¹⁰Në lidhje me piken e fundit e cila është edhe një risi që sjell kodi Italian në krahasim me atë shqiptar doktrina italiane është shprehur në mënyrë me të detajuar. Neni 197 limiton mundësinë për të dëshmuar personave që kryejnë funksionin e ndihmësit të gjyqtarit në procedimin penal .Ky nën do të aplikohet ekskluzivisht për aktivitetin e kryer nga keta persona vetëm në lidhje me perpilirnin e akteve të parashikuara në nenin 373 të KPrP italian e jo në lidhje me të gjitha aktivitetet që ata kanë perfunduar drejteperdrejte në funksion të parimit të përgjithshëm. Kufizimet që vendos neni 197 duhet të interpretohen në mënyrë shumë strikte e të shtrenguar duke u kufizuar vetëm në limitimin e ndihmësve institucionale të cilet kodi i percakton shumë qarte në mënyrë zyrtare. Kodi i autorizon keta persona të kryejnë funksionin e ndihmësit në rruge alternative e të jashtezakonshme.

Ndërsa në nenin 199 të kodit Italian percaktohet rrethi i subjekteve të cilet nuk janë të detyruar të dëshmojnë. Në këtë rast janë vete personat që do të zgjedhin nëse duan apo jo të dëshmojnë, gjykatësi duhet t'ua beje të ditur ketyre personave që e kanë këtë të drejtë.

²¹¹Doktrina Italianë shprehet se në të gjitha keto raste kemi të bëjmë me përjashtim nga detyrimi për të dëshmuar për shkak të ndjeshmerise për të dëshmuar , ndjeshmeri e cila nuk ka aspak karakter nëgociues por karakter tërësisht personal. Kështu që është vetëm në diskrecionin e vete personit që ka këtë lidhje me të pandehurin të deponoje ose jo në varesi të ndergjegjës morale që e karakterizon atë. Nëse kemi të bëjmë me një të mitur në moshe vullnëti i tij nuk duhet të jetë dhe as të zevendesohet nga vullnëti i të tjerëve.

Në rastet kur dëshmitari nuk është venë në dijeni të të drejtes që ka për të mos dëshmuar ai perfiton nga kauza e pavlefshmerise se dëshmisë.

²⁰⁹ Codice di procedura penale e leggi complementari a cura di Giustino Gatti (magistrato) , Edizioni Simone 1995

²¹⁰ Grevi Conso, Breviaria Iuris commentario breve al nuovo codice di procedura penale, CEDAM, Padova 1994, faqe 282

²¹¹ Po aty, faqe 283

Nuk mund të detyrohen të deshmojnë:

1. Gjinia ose krushqia e afert e të pandehurit sipas përcaktimeve të nenit me përjashtim të rasteve kur kanë bere kallezim apo ankim apo kur njëri nga ata apo një i aferm i tyre janë të demtuar nga vepra penale.
2. Nuk mund të detyrohet të deshmoje bashkëshorti për faktet e mesuara nga i pandehuri gjatë gjithë jetes bashkëshortore
3. Bashkëshorti i ndare nga i pandehuri(me këtë pike kodi italian është me i detajuar duke percaktuar që nuk është i detyruar të deshmoje personi për të cilin ka dale një vendim i anulimit zgjidhjes apo pezullimit të kontrates se martesës me të pandehurin.)
4. Ai që edhe pse nuk është bashkëshort i të pandehurit ka bashkëjetuar apo bashkëjeton me ate
5. Ai që është lidhur me të pandehurin me një mardhenie biresimi

Për sa i përket kësaj provë janë identike me qëndrimin që mban kodi shqiptar edhe rregullimet ligjore që lidhen me çështje të tilla sikurse është detyrimi që ka dëshmitari për tu paraqitur dhe për të treguar të vërtetën të cilat sanksionohen nga neni 198. Në piken 2 të këtij neni theksohet që dëshmitari nuk mund të detyrohet të deponojë mbi fakte nga të cilat mund të lind për të përgjegjësia civile.

Ndryshim tjetër që vihet re në kodin e procedurës Italianë është në nenin që bën fjale për ruajtjen e sekretit shtetëror. Në kodin shqiptar percaktohet se nënpunësit shtetëror ata publike si dhe të ngarkuarit me një shërbim publik kanë detyrimin për të ruajtur faktet që janë sekret shtetëror.

Kur dëshmitari pretendon se fakti perben sekret shtetëror, organi procedues kërkon konfirmimin me shkrim të organit kompetent shtetëror. Kodi italian i procedurës penale në ndryshim nga kodi ynë nuk le të zbehur faktin se kush është organi kompetent por e shpreh në mënyrë eksplicite se në rastin e mesipër dubet të njoftohet kryetari i keshillit të ministrave.(kryeministri). Nëse sekreti konfirmohet të dy kodet parashikojnë 2 raste: Rasti i parë është rasti kur prova nuk është thelbësore për zgjidhjen e çështjes dhe zgjidhja është e thjeshtë dëshmitari nuk pyetet. Në rastin e dytë prova është thelbësore për zgjidhjen e çështjes në këtë rast organi procedues pezullon çështjen derisa të jape përgjigje organi me i lartë i administratës shtetërore e më pas dëshmitari është i detyruar të deshmoje

Kodi ynë i procedurës parashikon një afat procedural prej 30 ditësh nga njoftimi i kërkesës mbrenda të cilit organi kompetent shtetëror duhet të jape konfirmimin që një fakt i

caktuar përben sekret shteteror nëse autoriteti kompetent nuk i permbahet afatit që ka percaktuar ligji atehere dëshmitarit i kërkohet të deshmojë. Ndryshim tjetër që sjell kodi italian është për sa i perket afatit kohor brenda të cilit organi kompetent duhet të jap konfirmimin dhe që është 60 dite.

Në lidhje me mënyrën e marrjes së dëshmive edhe legjislacioni italian sikurse dhe ai shqiptar percakton detyrimin e dëshmitarit për tu paraqitur në vendin ku percakton organi procedues për marrjen e dëshmive. Në rastin e Presidentit të Republikës dëshmia do të merret në vendin ku ai ushtron detyrën në bazë të nenit 205 të Kodit Italian të Proçedurës Penale.

²¹²Pyetja e dëshmitarëve bëhet fillimisht nga prokurori ose nga mbrojtësi a perfaqësuesi që ka kërkuar pyetjen. Me pas pyetja vazhdon nga palet, sipas radhës. Kush ka kërkuar pyetjen mund të bëjë pyetje edhe mbasi mbarojnë palet e tjera.

²¹³Ndalohen pyetje që ndikojnë në paanësinë e dëshmitarit-

Ndalohen pyetjet që synojnë sygjërimin e përgjigjeve, pyetje me karakter sugjestionues të cilat kanë një efekt negativ të dëshmitarit sepse e vënë atë në një pozitive të vështirë emocionale, madje ndikojnë në mënyrë indirekte në psikologjinë e tij. ²¹⁴Për sa i perket pyetjeve që i bëhen dëshmitarit ato nuk duhet të jenë të tilla që ndikojnë në sinqeritetin e përgjigjeve apo që mund të ushtrojnë mbi të presion psikologjik. ²¹⁵Në një çështje gjykata e lartë në Itali ka pranuar rekursin e ngritur nga pala e interesuar për kundërshtim të vendimit të gjykatës së apelit që e ka cmuar të pavlefshme e të papërdorshme dëshminë e një subjekti, dëshmi e cila konfirmonte alibinë e të pandehurit për arsye se pyetjet ishin formuluar në mënyrë sugjestionuese. Pyetjet që i bëhen dëshmitarit nuk mund të jenë në kundërshtim me disa parime konstitucionale sikurse janë parimi i privatesisë apo ai i lirise personale. Neni 207 bën fjalë për rastin kur kemi të bëjmë me një dëshmi kontraditore jo të plotë ose në kundërshtim me provat e grumbulluara deri tani në këtë rast trupi gjykoës duhet të njoftojë prokurorin që të veprojë në përputhje me ligjin. Personi që ka dëshmuar do të përgjigjet jo vetëm për dëshmi të rreme por edhe për

²¹² Codice di procedura penale e leggi complementari a cura di Giustino Gatti (magistrato) , Edizioni Simone 1995, art. 497

²¹³ Cpo aty - art. 499

²¹⁴ Commento al nuovo codice di procedura penale coordinato da Mario Chiavario UTET

²¹⁵ Grevi Conso, Breviaria Iuris commentario breve al nuovo codice di procedura penale, CEDAM, Padova , 1994

cdo lloj veprë tjetër që ka të bëjë me dhenien e dëshmitë së rreme përpara gjyqtarit.

²¹⁶Gjatë pyetjes së dëshmitarit kryetari mund të bëjë pyetje dhe, kur është rasti, nderhyn për të siguruar radhën e pyetjeve, vërtetësinë e përgjigjeve, saktësinë e pyetjeve dhe të kundërshtimeve, si dhe garanton respektimin e personit.

²¹⁷Palët mund të përdorin thëniet e bëra më parë nga dëshmitari para prokurorit ose policisë gjyqësore,

- për të kundërshtuar, tërësisht ose pjesërisht, përmbajtjen e dëshmitë ose
- kur refuzon të dëshmojë

Kushti i vetëm që të përdoren thëniet e mëparëshme në rastet e mesipërme është që në deklaratimet e mëparëshme dëshmitari të këtë deponuar për faktet që kundërshtohen. Thëniet që dëshmitari ka deponuar përpara prokurorit apo oficerit të policisë gjyqësore nuk përbejnë provë në vetvete për faktet që pohohen në to, por ato mund të vlerësohen nga gjykata për të përcaktuar nëse dëshmitari është i besueshëm apo jo.

Organi procedues mund t'i përdorë këto thënie si provë:

- Nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre Kur rezulton se dëshmitari qoftë edhe gjatë pyetjes në seancë i nënshtrohet dhunës, kanosjes, premtimit për t'i dhënë para ose përfitime të tjera, me qëllim që të mos dëshnojë ose të bëjë dëshmi të rreme
- Kur rezultojnë rrethana të tjera që kanë demtuar sinqeritetin e përgjigjeve të tij.

Mund të shërbejnë si provë edhe leximet e deklaratimeve të bëra në fazën e hetimeve paraprake nëse dëshmitari për shkaqe objektive e ka të pamundur të paraqitet.

Për të mos përseritur dispozitat që kam përdorur në këtë punim lidhur me pyetjen e të pandehurit dhe paleve private po e përmbledh duke thënë se dispozitat e kodit italian të procedurës penale lidhur me pyetjen janë identike me ato të kodit shqiptar. E njëjta gjë vlen edhe për trajtimin që i bëhet ballafaqimit. Në lidhje me ballafaqimin me duhet të theksoj se lejohet vetëm ndërmjet personave që janë pyetur kur:

- Ndërmjet thënies të këtyre personave ka mosperputhje apo kontradikta për fakte e rrethana të ndryshme të rëndësishme.

²¹⁶ Codice di procedura penale e leggi complementari a cura di Giustino Gatti (magistrato), Edizioni Simonè 1995, art. 499

²¹⁷ Po aty - art. 500

- Kodi Italian në ndryshim nga kodi shqiptar percakton që faktet e rrethanat për të cilat ka kontradita duhet të jenë të rëndësishme.

Në lidhje me ballafaqimin kodi është tepër konciz dhe nuk ka lenë mundesi interpretimi madje dhe vete komentari i kodit Italian të procedurës penale në lidhje me këtë lloj provë nuk ka shtuar asnjë informacion me shume se sa kodi.

Një tjetër lloj prove që percakton kodi Italian është njohja.²¹⁸ Organi procedues fton ate që duhet të beje njohjen që të pershkruaje personin duke treguar të gjitha shenjat që mban mend dhe e pyet nëse ka qenë thirrur me pare për të bere njohjen si dhe për rrethana të tjera që mund të ndikojnë në vërtetësinë e njohjes.

Në procesin e paraqitjes për njohje duhet të respektohen rregullat e mëposhteme:

- Organi procedues fton të paraqitet personin që duhet të beje njohje
- Siguron praninë e të pakten dy personave sa me të ngjashëm me ate që duhet të njihet (personi që do të njihet duhet të paraqitet në të njëjtat kushte në të cilat ka qenë në momentin që është pare nga ai që do të beje njohjen me të njëjtën veshje) personi që do të njihet e zgjedh vete vendin ku do të qendroje. Proçesi i paraqitjes për njohje të zhvillohet në të njëjtat kushte që kanë ekzistuar në momentin e përceptimit të shenjave të objektit.
- Njohesit nuk duhet t'i tregohet sendi përpara paraqitjes për njohje.
- Gjykata fton personin që dote beje njohjen e pyet nëse njeh ndonjërin nga ata që i paraqiten për njohje dhe, në rast se po, e fton të tregojë se cilin njeh dhe ta saktësojë nëse është i sigurt. Rregullat e mësipërme percaktohen në nenet 213-218 të KPrP Italian.

²¹⁹Në komentarin e kodit të procedurës të autorit C.Grevi i është kushtuar një rëndësi e madhe njohjes që zhvillohet duke respektuar dispozitat e permendura me sipër me njohjen joformale (njohje e drejteperdrejte që realizohet në pritje të personit të demtuar të marrjes se dëshmise dhe ballafaqimit me të pandehurin.). Njohja joformale e realizuar në vijim të marrjes se dëshmise është njohja e drejteperdrejte e të pandehurit si person që ka kryer veprën penale.Në rastin e njohjes joformale nuk zbatohen nenet 213-218 të KPrP. Në këtë rast kemi të bëjmë me një provë e cila nuk mund të vlerësohet si një provë atipike në përputhje me nenin 189 të kodi proçedural penal Italian, por si provë e

²¹⁸ Codice di procedura penale e leggi complementari a cura di Giustino Gatti (magistrato) , Edizioni Simonè 1995

²¹⁹ Grevi Conso, Breviaria Iuris commentario breve al nuovo codice di procedura penale, CEDAM, Padova , 1994

rregulluar me ligj. Ajo që theksohet në lidhje me njohjen joformale është fakti që nuk do të cilësohet si njohje por konsiderohet si "objekt" i dëshmive, si fakt që lidhet me ndeshkueshmerinë e të pandehurit.

Nëse do të konkludoja dote thoja që kemi të bëjmë me një lloj të veçantë njohjeje joformale, pra me njohje tipi sui generis, e cila nuk realizohet në perputhje me dispozitat e kodit nenet 213-218, dhe realizohet si proces në vijim të marrjes së dëshmive. Kjo është arsyeja që kjo lloj provë klasifikohet si objekt i dëshmive. Në lidhje me këtë çështje doktrina jonë nuk ka mbajtur asnjë qëndrim e kodi aq me pak.

Në kodin Italian në kapitullin e provave ze një vend të veçantë eksperimenti dhe ekspertimi. Për sa i përket eksperimentit cdo dispozite është e njëjtë me ato të parashikuara në KPrP të Republikës së Shqipërisë (dhe vete komentari i kodit mjaftohet vetëm me të dhënat e kodit për sa i përket kësaj provë.) ndersa në lidhje me ekspertimin kodi italian i procedurës penale sjell një risi. Kodi Italian percakton rregulla në lidhje me rastet kur duhet emëruar një ekspert mënyrën e emërimit të ekspertit, papajtueshmerinë me detyrën e ekspertit. Të gjitha keto dispozita janë identike me nenet 178-186 të kodit të procedurës penale të Republikës së Shqipërisë. Rrisite që sjell kodi Italian qendrojnë se pari në rastet kur një person nuk mund të kryej detyrën e ekspertit. Nuk mund të kryejë detyrën e ekspertit i mituri,

- ai që ka ndalim ligjor
- atij të cilit i është hequr zotesia juridike për të vepruar ose vuan nga një sëmundje mendore
- ai që është pezulluar, qofte edhe perkohesisht, nga detyrat publike ose nga ushtrimi i një profesioni
- ai, ndaj të cilit janë marrë masa sigurimi personal
- ai që nuk mund të pyetet dëshmitar apo të merret perkthyes ose që ka të drejtë të mos beje dëshmi ose perkthim.

Deri ketu nuk ka asgjë të re sepse keto raste percaktohen edhe në nenin 180 të kodit tonë procedural

Një rast që percakton shprehimisht kodi i procedurës penale është rasti i një personi që në të njëjtën çështje ka qenë konsulent teknik, një rast ky të cilin e percakton vetëm doktrina shqiptare, jo kodi.

Ndryshimi i dyte është që në kodin Italian është parashikuar një nën specifik (neni 233 të kodit Italian) i cili sanksionon se prokurori dhe palet private përveç ekspertit mund të kërkojnë të emerojnë edhe një numer konsulentesh teknike, një numer konsulentesh që s'mund të kalojë numrin e eksperteve. Në kod përcaktohet dhe një nën që përcakton rastet e papajtueshmërisë me detyrën e konsulentit teknik.

²²⁰Në lidhje me ekspertimin komentari i kodit italian mban qëndrime në lidhje me vërtetimet daktiloskopike dhe teknike. Sipas komentarit vërtetimi daktiloskopik synon në një krahasim të të dhënave që ndodhen në kartelen daktiloskopike me gjurmët e lena në sipërfaqen e objektit nga i pandehuri, prandaj ky lloj aktiviteti nuk i jep vend një gjykimi teknik për vetëm vërtetimit të të dhënave objektive. Për këtë arsye vërtetimet daktiloskopike nuk kanë as karakter formal dhe as karakter substancial të ekspertimit.

²²¹Në të njëjtin arsyetim veprimet e policisë gjyqësore për verifikimin e regjistrave të kontabilitetit dhe të dokumentave të tjera për të vërtetuar ndërmjet elementeve evazionin fiskal nuk përbejnë as verifikim teknik të pranueshëm nga ekspertimi për të cilin në përputhje me nenin 223 të kodit italian duhet të aplikohen garancitë për mbrojtjen e vetë ekspertimit (në përputhje me nenin 69/148 të gjykatës kushtetuese.) dhe as akt të paperseritshëm në të cilin mbrojtësi ka të drejtë të jetë i pranishëm në përputhje me nenet 348, 354 dhe 356 të KPrP. Garancitë e mesiperme gjejnë zbatim në rastin kur ekzistojnë manipulime të tilla që modifikojnë situatën objektive paraekzistuese.

Komentari trajton edhe një tjetër problematike sikurse është rasti i veprave që lidhen me përdorimin e lendeve narkotike.²²² Në rastin e veprave të tilla në fund të procesit të provuarit të natyrës së këtyre substancave nuk është i nevojshëm plotësimi i ekspertimit të pershtatshëm në diskrecion të një gjyqtari, me arsyetime të pershtatshme që deduktojnë vetë bindjen nga elemente të tjera të mundshëm, si janë pranimi i të pandehurit, vërtetimet e policisë ose çdo provë tjetër me kuptim të njëjtë. Kjo domosdoshmëri nuk buron as nga ligji as nga praktika.

²²⁰ Grevi Conso, *Breviaria Iuris commentario breve al nuovo codice di procedura penale*, CEDAM, Padova, 1994, faqe 299 pika 2

²²¹ Po aty - pika 3

²²² Po aty- pika 4

²²³Komentari cilëson faktin që ekspertimi është i ndaluar në rastin e veprës që lidhen me dhunimin epshor. Në rastin e një vepre të tillë ndalohej realizimi i ekspertimit mbi femijen e lindur nga raporti incenstual kur një ekspertim i tillë pengon të drejten për rezervim e maturi të femijes nderkaq të adaptuar nga prinder që kanë kundërshtuar realizimin e tij.

Për sa i përket provave materiale dhe dokumentave kodi italian nuk sjell asgjë të re. Pavarësisht ç'ka u tha me sipër me duhet të theksoj edhe njëherë se kodi ynë i procedurës penale është pothuajse identik me kodin italian dhe ndryshimet që vihen re janë të paperfillshme. Ndryshimi i vetëm esencial dhe i vetmi që me bëri mjaft pershtypje është mungesa në kodin italian e një dispozite që përcakton kuptimin e provës dhe kushtet që duhet të përmbushë ajo për të qenë e vlefshme.

²²³ Grevi Conso, *Breviaria Iuris commentario breve al nuovo codice di procedura penale*, CEDAM, Padova, 1994, faqe 299 pika 5

PËRFUNDIME

Provat janë insitut shume i rëndësishëm i proçedurës penale, ato kanë një kontribut esencial në zbulimin e të vërtetes dhe konsiderohen si insitut themelor i të drejtes proçeduriale.

Sipas parimit të prezumimit të pafajesisë dhe atij të ligjshmerise i pandehuri konsiderohet i pafajshëm derisa nuk është vërtetuar fajesia e tij me vendim gjyqësor të formes se prerë, pra çdo person i akuzuar konsiderohet i pafajshëm derisa fajesia e tij të provohet ligjerisht. Provat sherbejnë si kusht i zhvillimit të një proçesi të rregullt ligjor, i cili bazohet në një varg parimesh të cilat kanë të bejnë me:

1. gjykimin në bazë të ligjit dhe provave
2. papërdorshmerinë e provave të marra në kundërshtim me ligjin
3. krijimi i bindjes se brendshme të gjykatës mbi bazën e provave të shqyrtuara në seance.

Fillimi i një procedimi penal behet kur ka dyshim se është kryer vepra penale, pra prova është themeli i vendosjes se një individ i perpara përgjegjesisë për shkeljen e një dispozite ligjore. I gjithë proçesi gjyqësor zhvillohet për të administruar gjatë seances gjyqesore provat që subjektet proçedural, organi i akuzës dhe i pandehuri i kanë siguruar për të ngritur apo për të hedhur poshte akuzat (respektivisht). Në fund të proçesit gjyqësor gjyqtari apo trupi gjykues kur kemi të bëjmë me një të tille merr vendim bazuar vetëm mbi provat e administruara gjatë seances gjyqesore. Kjo tregon edhe njëhere rëndësinë substanciale që kanë provat në një proçes gjyqësor si dhe në dhenien e statusit fajtor ose i pafajshëm të të pandehurit.

Bazuar në neni 149 të kodit proçedural penal provat janë: "njoftime mbi faktet e rrethana që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin proçedural penal, në perputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që sherbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajesinë ose pafajesinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjesisë se tij".Duhet të plotësohen kater kushte që njoftimet mbi faktet e rrethana që lidhen me veprën penale të konsiderohen provë. Vete ligji në perkufizimin që jep për provat kërkon si kusht që faktet e rrethanat që synon autoriteti procedues të evidentojë (nga tërësia e indicjeve dhe njoftimeve)të kenë lidhje me veprën penale.

Tri kushtet e tjera janë:

- njoftimet mbi faktet e provat të merren prej burimeve të parashikuara në kodin procedural penal.
- të merren në perputhje me rregullat e percaktuara prej kodit
- provat të kenë një funksion

Po të beja një interpretim të nenit do të thoja që kushte e mesiperme nuk konkurrojnë por duhet të plotësohen të gjitha në mënyrë absolute që të dhënat të fitojnë vlerën ligjore të provës . Kemi të bëjmë me kushte kumulative.

Përfshihet nga e drejta e provës (që është mundësia që kanë palet në proces për të provuar atë që pretendojnë nëpërmjet elementeve që cilësohen nga kodi si provues).

1. Provat që nuk kanë lidhje me faktet objekt akuze
2. Përfshihetimi i provave të paligjshme. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është sanksionuar se askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.
3. Përfshihetimi i provave të nevojshme po të cilat në fakt i referohen të dhënave të provuara me perpara
4. Nuk mund të përdoren provat që nuk kanë lidhje me ngjarjen

Për sa i përket të drejtës për të marrë prova KPrP saktëson se në fazën e hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të percaktuara në këtë kod (në nenin 151 të tij) por edhe i pandehuri nuk përfshihet në mënyrë absolute nga mundësia e tij për të marrë prova që në këtë fazë, ndërsa në gjykim provat merren me kërkesën e paleve. Duhet të theksojmë se tipike e një sistemi akuzator është se drejta e provës dhe e drejta për të marrë prova, është një e drejtë që ligji ua njeh ekskluzivisht vetëm paleve dhe jo gjykatës. Një qëndrim totalisht të kundërt vë re në sistemin inkuizitor ku gjykata është tepër aktive në procesin marrës se provave duke iu kundërvënë rolit të arbitrit që ajo ka në sistemin akuzator. Duke u nisur nga një analizë e sistemit tonë ligjor jam e mendimit, që është një sistem i cili nuk mund të cilësohet si sistem tërësisht akuzator apo inkuizitor por ka ndërthurje të karakteristikave të të dy sistemeve të përmendura më sipër. Pra le të themi që është një sistem "hibrid". Jam tërësisht e bindur kur shpreh një gjë të tillë për vetë faktin që roli i gjykatës në sistemin tonë ligjor nuk është as tërësisht aktiv si në sistemin inkuizitor por nuk është as një rol tërësisht pasiv si në sistemin akuzator. Në sistemin tonë rolin thelbësor dhe të drejtën ekskluzive në marrjen e provave e kanë palet por

edhe gjykatës i rezervohet një e drejtë e tillë kur një gje e tillë është në dobi të një gjykimi të rregullt dhe të paanshëm. Në këtë pike skeptiket do të shtronin pyetjen se a është kjo një e drejtë që në vetevete cenon imazhin e gjykatës si të paanshme dhe jo paragjyquese. Në opinionin tim përgjigja do të ishte jo, sepse kur lexon këtë frazë të duket sikur gjykata perpiqet të mbledhe prova që synojnë të fajesojnë apo të nxjerrin të pandehurin jo fajtor pra të shkarkojnë atë nga përgjegjësia penale, kur në të vërtetë qëllimi i vetëm i gjykatës është zgjidhja e drejtë e çështjes duke u bazuar në faktet dhe të dhënat e garantuara nga mbledhja e provave, si dhe permisimi i imazhit të sistemit të drejtesisë si një sistem efektiv dhe që funksionon realisht në mënyrë aktive.

Proçesi i të provuarit ka njohur zhvillime të ndryshme si faktor i ndryshimeve që kanë pesuar mardheniet shoqerore kushtet politike apo kushtet ekonomike të vendit tonë. Kam trajtuar në punim zhvillimet që kanë pesuar llojet e provave bazuar në kanunin e Leke Dukagjinit, në periudhën e pushtimit otoman, në periudhën pas pavarësisë, në kohën e mbretënisë shqiptare

Në punim një vend të veçantë zë, analiza krahasuese (për sa i përket llojit të provave) ndërmjet, kodit të proçedurës penale të vitit 1953 me kodin aktual. Ky ishte kodi i parë që trajtonte çështjet e proçedurës penale dhe ishte perfaqësues tipik i sistemit inkuizitor.

Përgjithësisht kodi i 1953 përcakton si prova ato lloje që përcaktohen edhe nga kodi i tanishëm, me përjashtim të ballafaqimit dhe eksperimentit (të cilin nuk e parashikon).

Llojet e provave përcaktohen në nenet 60-85 si provë në bazë të ketyre dispozitave shërbenin: thëniet e dëshmitarit; thëniet e të pandehurit; mendimi i ekspertit; prova materiale e dokumentet me shkrim; proçesverbalet e veprimeve hetimore e gjyqesore

Kodi i 1953 sjell disa risi:

Në ndryshim nga kodi i sotëm dëshmitarit nuk i njëhej mundësia për të mos dëshmuar për shkak të lidhjeve që kishte me të pandehurin ose për shkak të detyrës për të ruajtur sekretet profesionale, lejonte pyetjen e të miturit pa praninë e mbrojtësit, nuk përcakton të drejtën e të pandehurit për të mos u përgjigjur. Sjell risi për sa i përket ekspertimit të detyrueshëm sepse përcaktonte në mënyrë eksplicite rastet kur ekspertimi duhet të jetë i detyrueshëm

Në punim kam trajnuar hollësisht në hapesirë të vecanta provat që përcakton shprehimisht KPrP si: dëshmia; pyetja e të pandehurit dhe pyetja e paleve private; ballafaqimi; njohja; eksperimenti; ekspertimi; provat materiale; dokumentat; regjistrimin e fshehtë të bisedave

apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve si provë atipike (prova që nuk kanë një rregullim ligjor po për të cilat gjykata jep autorizimin për marrjen e tyre).

Gjykoj se do të ishte e pamundur të jepja një ekstrakt për secilin prej tyre sepse cdo gje e trajtuar në kreret perkates është thelbësore e asgjë nuk mund të lihet menjanë.(për këtë ju sygjeroj të lexoni krun perkates)

Në lidhje me çështjen e fundit duhet të theksoj faktin se regjistrimi i fshehtë i bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve si provë atipike nëse i plotëson keto kushte lejohet të merret dhe të administrohet si provë në seancen gjyqesore por futja e kësaj provë në proces behet vetëm në cilësinë e një dokumenti fotografik gjithashtu me duhet të theksoj faktin se nuk mund të këtë barazi midis konceptit të përgjimit me atë të regjistrimit të fshehtë. Si provë në një procedim penal sherbejnë dhe rezultatet e përgjimit, edhe pse përdorimi i rezultateve të përgjimit si provë ve në rrezik të drejtat themelore të tij sikurse është e drejta për një jetë private apo e drejta e fshehtësisë së korrespondences. Ligji u jep mundësinë paleve të përdorin të dhënat e perfituara me këtë mënyrë por vetëm brenda kushteve të cilat vete ai i percakton qarte.

Raste kur rezultatet e përgjimit nuk mund të përdoren si provë, do t'i grupoja në tri kategori:

- Raste të cilat lidhen me mosrespektimin e ligjit neni 226 i KPrP percakton qarte se . rezultatet e përgjimit nuk mund të përdoren kur janë bere jashte rasteve të lejuara nga ligji ose kur nuk janë respektuar dispozitat e ketij saksioni
- Raste të cilat lidhen me llojin e përgjimit Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si provë(neni 226 i kodit të procedurës)
- Raste të cilat lidhen me subjektet ndaj të cileve është urdheruar përgjimi. Po në të njëjtin nën percaktohet se nuk mund të përdoren përgjimet e bisedave ose të komunikimeve të atyre që janë të detyruar të ruajnë sekretin për shkak të profesionit apo detyrës, me përjashtim të rasteve kur keta persona kanë deponuar mbi të njëjtat fakte ose i kanë perhapur në ndonjë mënyrë tjeter.

Në këtë teze diplome nuk mund të mungonte një analizë krahasimore me legjislacionin italian (me kodin e procedurës penale të Italisë) kjo analizë konsiston në mënyrën se si trajtohet kapitulli i provave dhe secila prej tyre në kodin italian por edhe në komentarin e tij dhe se dyti në një krahasim që i behet me dispozitat e kodit tonë për sa i perket provave.Pavaresisht disa ndryshimeve të vogla që trajtohen në kreun perkates askush nuk

mund të mohoje që kodi ynë dhe kodi italian i procedurës janë pothuajse identike në trajtimin e këtij insituti. Ndryshimet që kam permendur në kreun perkates në të shumten e rasteve janë jo të një rëndësie substanciale dhe ndryshimi i vetëm esencial dhe i vetmi që me beri mjaft pershtypje është mungesa në kodin italian e një dispozite që percakton kuptimin e provës dhe kushtet që duhet të permbushë ajo për të qenë e vlefshme.

I gjithë perfundim i kësaj analizë ishte mese i pritshëm pasi është i njohur fakti që legjislatori është bazuar në kodin Italian për hartimin e Kodit tonë të Proçedurës Penale. Edhe pse jo në aje kapitull të veçantë shpeshhere kam bere një permbledhje edhe të mënyrës se si i trajton ligji federal i SHBA-ve provat, megjithëse kemi të bëjmë me një sistem tjetër ligjor thelbi mbetet i njëjtë. Edhe në SHBA njihen si prova dëshmia ekspertimet, provat materiale por nuk flitet për njohjen dhe ballafaqimin.

Se fundi pasi secilen prej provave e kam trajtuar në mënyrë specifike me duhet të theksoj se KPrP nënvizon faktin që asnjëra nga provat nuk ka vlere të paracaktuar por çmohet në unitet me provat e tjera .Provë “regina probatum” nuk ka secila prej provave është e barabarte me tjetren dhe të gjitha bashkë janë mbreteresha të zbulimit të vërtetes. Në lidhje me këtë qëndrim që mbajnë kodi i procedurës dhe doktrina shqiptare me duhet të theksoj se personalisht mendoj se jo të gjitha provat duhet të kenë të njëjtën vlere në një procedim penal. Kjo për faktin e thjeshtë se jo të gjitha provat kanë të njëjtën saktësi dhe garanci për zbardhjen e të vërtetes. E thënë me thjesht gjykoj se një provë me të dhëna shkencore sikurse janë ekspertimet sidomos ato daktiloskopike apo një analizë ADN ku mundësia për të gabuar është 0.2% nuk mund të qendrojë në një procedim penal në të njëjtën hierarki me një dëshmi apo me thënien e personave që kanë dijeni për ngjarjen. Për më tepër mund të them se dhe vete praktika gjyqesore ka shfaqur dyshime në lidhje me marrjen e një vendimi konkret mbi çështjen kur si provë është paraqitur para trupit gjykues vetëm ekzistenca e dëshmive apo thënieve. Nuk ndodh i njëjti shqetesim në rastin kur si provë administrohet në seance një proçesverbal i një ekspertimi daktiloskopik, në një rast të tillë gjykata ka qenë e bindur në marrjen e vendimit pasi kemi të bëjmë me një provë ekzakte e cila nuk jep mundësinë për të gabuar, ndersa në rastin e dëshmive thënia e dëshmitarit kërkon bashkëzistencen e provave të tjera në mënyrë që të vërtetohet që është e sakte. Dëshmitari jo gjithmonë tregon të vërteten, është vete fuqia provuese e ketyre provave që i diferencon ato në shume të fuqishme apo në një shkallë me të ulet provuese.

Shtrohet pyetja se cila do të ishte zgjidhja sipas kodit në një situatë të tillë kur në një procedim penal administrohen një sërë provash të cilat janë kontradiktore me njëra tjetrën dhe nëse do të ecnim sipas logjikës së kodit se secila prej provave ka vlerë të barabartë me tjetrën dhe provë *regina probatum* nuk ka do të ishte e pamundur të arrihej në një konkluzion. Në një situatë të tillë kur gjykata duhet të japë një vendim njëres nga provat do t'i jepet një vlerë provuese me e madhe, megjithatë nga një interpretim *scrito sensu* i kodit mendoj se legjislatori kur ka theksuar faktin se të gjitha provat duhen shqyrtuar në unitet me njëra tjetrën dhe asnjë provë nuk ka vlerë të përcaktuar por janë të barabarta ka nënkuptuar që në një proces gjyqësor do të administrohen të gjitha provat pavarësisht se mund të jetë siguruar një provë që garanton zgjidhjen e çështjes (sikurse mund të jetë një analizë ADN) nuk mund diskriminohen dhe të lihen pa u administruar edhe provat e tjera të cilat kanë të njëjtën fuqi vërtetuese me të, në këtë kuptim jam plotësisht dakort që provë *regina probatum* nuk ka.

BIBLIOGRAFIA

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998 (me ndryshimet perkatese), Tiranë 2008
- Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore ratifikuar me ligjin nr.8137 , datë 31.07. 1996.
- Konventa e Vjenës mbi mardheniet diplomatike 1963
- Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2009.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i QPZ, Tiranë 2004
- Codice di procedura penale e leggi complementari a cura di Giustino Gatti (magistrato) , Edizioni Simonë 1995
- Commento al nuovo codice di procedura penale coordinato da Mario Chiavario UTET
- Grevi Conso, Breviaria iuris commentario breve al nuovo codice di procedura penale, CEDAM, Padova , 1994
- Ligji nr. 9205 datë 15.02.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë"
- Ligji nr. 8750 datë 26.01.2001 "Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të lendeve narkotike".
- Ligji nr. 7830 datë 25.06.1994 "Për autopsinë" në R.SH
- Begeja Skender, "Kriminalistika", "Perlat Voshtina ", Tiranë 2007,
- Halili Ragip, Kriminologjia, "Universiteti i Prishtinës" Fakulteti Juridik, Prishtinë , 2002
- Pradel Jean, Cortesen Geert, Vermeulen Gert, " E drejta penale europiane", Botimet Papirus, 2010
- Puto Arben, "E drejta ndërkombetare publike", Botimet Dudaj, Tiranë 2010
- Imeraj Elizabeta, "Provat në proçesin penal", Tiranë 2008
- Elezi Ferdinand, "Provat penale" Tiranë 2008
- Sahiti Ejup "Dëshmia e dëshmitarit si provë në proçesin penal" Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, "Rominor", Prishtinë 1993
- Sahiti Ejup "Argumentimi në proçeduren penale" Universiteti i Prishtinës, "AZA-sesoft" Fakulteti Juridik, Prishtinë 1999
- Sahiti Ejup & Zejneli Ismail “ E drejta e Proçedurës Penale e Republikës së Maqedonisë”, Shkup, 2017
- Tartale Fatmir, "Eksptimi në të drejten proçedurale penale në R.Sh", Tiranë 1999

- Gazeli Kosta," Thëniet e të pandehurit si provë në proçesin tonë penal", Tiranë 1988
- Bianku Ledi "Jurisprudenca e gjykatës se Strasburgut" Edlora, Tiranë 2005
- Islami Halim, Hoxha Artan, Panda Ilir "Proçedura penale" Morava, Tiranë 2007, faqe 317
- Cano Mirela, "Viera provuese e regjistrimit të fshehtë të bisedave apo komunikimeve telefonike nga njëri prej të pranishmeve", revista nr.2 "Jeta juridike" shkolla e magjistraturës, Tiranë ,dhjetor 2007
- Ibi Sokol, "Për provat", Revista nr.64 "Tribuna juridike" Fondacioni për kulture juridike, Tiranë 2007
- Federal rules of evidence(For united states courts), West publishing company,St Paul 1993
- Vendimi Nr 1, Datë 27.03.2008 Kolegjet e bashkuara të Gjykatës se Lartë
- Vendimi Nr 5, Datë 11.11.2003 Kolegjet e bashkuara të Gjykatës se Lartë
- Vendimi Nr 9, Datë 16.01.2008 Kolegji Penal i Gjykatës se Lartë
- Vendimi Nr 12, Datë 16.01.2008 Kolegji Penal i Gjykatës se Lartë
- Vendimi Nr 11, Datë 16.01.2008 Kolegji Penal i Gjykatës se Lartë
- Vendimi Nr 2 , Datë 11.01.2008 Kolegji Penal i Gjykatës se Lartë
- Vendimi Nr 777, Datë 20.12.2006 Kolegji Penal i Gjykatës se Lartë
- Vendimi Nr 32, Datë 23.01.2008 Kolegji Penal i Gjykatës se Lartë
- Vendimi Nr 62, Datë 14.02.07 Kolegji Penal i Gjykatës se Lartë
- Vendimi Nr 52, Datë 25.01.2006 Kolegji Penal i Gjykatës se Lartë
- Vendimi Nr 1105, Datë 07.11.2007 i Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Vendimi Nr 473, Datë 29.03.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Vendimi Nr 105, Datë 21.02.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Vendimi Nr 573 , Datë ! 2.04.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë